

**Fatos  
Arapi**

**DETI  
NE  
MES**

**roman**

BIBLIOTEKA E

B.M-31

A 73

SHFETIT

GJIROKASTER



Redaktor

SHPETIM KARAI

Fotos  
A73

87487418  
A73

DETI  
NË  
MES

42392

YOMOR

SHETËRIA  
BOTËSË  
-NAIM  
FRASHËRI

... e shprehur me fjalë të mëdha, por  
... e shprehur me fjalë të mëdha, por  
... e shprehur me fjalë të mëdha, por  
... e shprehur me fjalë të mëdha, por  
... e shprehur me fjalë të mëdha, por  
... e shprehur me fjalë të mëdha, por  
... e shprehur me fjalë të mëdha, por  
... e shprehur me fjalë të mëdha, por  
... e shprehur me fjalë të mëdha, por  
... e shprehur me fjalë të mëdha, por

... e shprehur me fjalë të mëdha, por  
... e shprehur me fjalë të mëdha, por  
... e shprehur me fjalë të mëdha, por  
... e shprehur me fjalë të mëdha, por  
... e shprehur me fjalë të mëdha, por  
... e shprehur me fjalë të mëdha, por  
... e shprehur me fjalë të mëdha, por  
... e shprehur me fjalë të mëdha, por  
... e shprehur me fjalë të mëdha, por  
... e shprehur me fjalë të mëdha, por

Një grumbull ushtarësh bisedonin në këmbë. Kishin rrethuar të vdekurin të asme zëra të mbytur, jepnin e merrnin midis tyre. Jashtë po agonte. Shiu s'kishte të pushuar. Vetëm prej dritares së vogël hynte pakëz dritë. Dera e drunj-të e kishës ishte mbyllur.

Duhet varrosur.

— Në këtë shi?

— Pse shpejtoni, djema? — Domenico Barba u tërhoq prapa, hapi krahët e bëri kryqin mbi të vdekurin. Pastaj u kthye e shkoi nga ikonostasi.

Oficeri e ndoqi atë një copë here me sy. Sapo Barba kaloi mesin e kishës, ai u ngrit nga shtroja dhe i doli përpara.

— Mirëmëngjesi.

— Mirëmëngjesi.

Një natë më parë, kur e pati dëgjuar at-

je te varri i sapohapur, tek falej me atë zërin e lehtë e të kthjellët, oficerit i qe dukur i afërt ky ushtar.

— Vdiq edhe një tjetër... — tha Domeniko Barba duke lëvizur krahët e gjatë. Pastaj bashkoi e fërkoj shuplakat e mëdha e të bardha. Ai kishte ftohtë.

Oficeri pa i heshtur sytë pufkë të ushtarit. Një mjegull e ftohtë lodhjeje e harrimf dyndej në gropat e tyre. Oficeri mendoi se Barba e shihte botën përtej cipës së asaj mjegulle.

— Vdiq...

Barba u largua disa çape, përshkënditi me gishtërinj kandilin para ikonës, u përkul e bëri kryq. Oficeri përsëri e ndoqi me sy. Pastaj menjëherë u kthye dhe shkoi tek i vdekuri.

Të tjerët ishin larguar. Tani vetëm ushtari i vdekur kishte mbetur si një natë më parë: mbështetur te muri, shpatullat mbështjellë me kapotë. Oficeri iu afrua pranë, opingat e llashtikta i çikënonë këpucët e të vdekurit. Iu bë se dëgjoi fjalët e mbrëmshme: «Ndihmomë... ndihmómë të jetoj...».

Oficeri ngriti kapotën. Kryet e të vdekurit ishte këputur mbi kraharror. Ai dukej sikur po flinte.

— Ashtu si mbrëmë, — murmuriti oficeri.  
— Sa i ri ishte...

Dhe pa kuptuar as vetë nisi të kërkonte në atë fytyrë tipare, që i kishte parë diku. Sa më shumë hetonte, aq më tepër i afroheshin ato mise të dashura femërore e i valëzonin ata flokë të verdhë. Oficerit iu kujtua e shoqja, Anxhela.

Hodhi mbi të vdekurin kapotën që mbante në duar. E mbuloi dhe u largua anash. Një gavitë uji u rrokullis nëpër këmbë.

— Të mjerët ne. — tha dikush prapa tij.



Duke fërkuar sytë, Agostini shihte dritën e paktë të dritares, që fekste mbi të. S'po arrinte të kuptonte dot asgjë. I bëhej sikur po jetonte mes avujsh e shëmbëllyrash, të cilat, sapo i aviteshin pranë, largoheshin prej tij. Gjithçka i ishte shpëlarë në kujtesë, ashtu si blerimi i tokës nga një reshje e rrëmbyeshme dhe e papritur. Tani, pas shpërthimit të mbrëmshëm, Agostini shihte brenda vetes gërryerjen, ndiente humbëtirën që po ia përpinte gjithë qenien. Nuk donte të besonte se gjendej prapë mes ushtarëve të braktisur. Vetëm një gjë kishte mbetur si edhe më parë në sytë e tij: deti.

Ditët e fundit ai kishte ecur vetëm drejt detit. Hidhte shikimin e trullësor përreth: mure të vogla të gurta, njerëz që lëvrinin brenda tyre. Ushtari u ngrit në këmbë. Iu morën mendtë e desh ra. Zgjati dorën që të mbahëj te muri. Atëherë pa përsipër vetes ikonostasin.

— Perëndia ime, — murmuriti e ra në gjunjë.

Brenda ikonës fytyra e shenjtit ishte e qetë dhe fare e vogël. Gjunjazi Agostini iu afrua pranë. Dontë ta shihte nga afër atë shenjt, që i shëmbëlente aq pak me ata të kishave të Venecies së tij. Por prapë ishte një shenjt.

Oficeri kaloi andej. U ndal dhe ndoqi mesy, i menduar, faljen përgjëruese të atij ushtari. Pastaj edhe vetë përkuli gjurin para ikonës...

Jashtë shkrepri e pastaj bubulloi. Barba nuk i shqiti sytë prej radhoit që mbante në duar. Mbështetur te dera e ajodhimës oficeri priti një copë herë. Ai shikonte i druajtur atë kthinë gati të errët, me një dritare katrore të vockël nga lindja. Nuk i kishte takuar kurrë të kapërcente pragun e një altari të tillë. Fryma e dritës së dritares përshkonte gati gjithë ajodhimën e binte në rrezë përposh. I heshtur, i vetëm ushtari diçka po lëciste në atë dritë. Me gjysmë zëri ai i shqiptonte fjalët sikur të bisedonte me vete. Gjithë duke nënëritur u kthye e pa oficerin.

— Ju, kërkoni gjësendi?

Oficeri nuk u përgjigj. Atëherë Barba shkoi vetë, kapërceu pragun e derëzës dhe e kapi për krahu.

— E çuditshme, — tha duke i treguar tjetrit radhuan e vjetër.

Fletorja ishte mbështjellë me një mbulesë të trashë, në një të zezë të lëbyrtë si ajo e ungjijve. Barba e shpuri oficerin pranë dritës së kandilit të kishës.

— Në seminar ne kemi bërë greqishte të vjetër dhe unë mund të zërbërë diçka nga të shkruarat e këtyre murgjve orientale.

Ai ndau me gisht fletoren e nisi të lëciste. Oficeri dëgjonte, por nuk arrinte dot të kuptonte asnjë fjalë të asaj gjuhe fare të ftohtë për të.

— Këtë kishë e paska themeluar një kallogre: Aleksandra. Vajza paska qënë nga këto anë dhe të fejuarin ia paska mbytur një natë stuhia në liqen. Asaj i qenkësh fanensur dikush në ëndërr dhe i paskësh thënë se duhej të ngrinte këtu kishën me emrin e shën Triadhës.

Barba ngriti kryet e pa i menduar rreth e përqark. Shikimi i tij rrëshqiti mbi mure, në kupolën e kishës, pastaj shkoi e qëndroi tek ikonostasi.

— Shën Triadha... — tha ai me vete.

Oficeri mendoi se Barba ishte shumë i lodhur. Kur fliste, thepi i mollës së Adamit i ngjitej në qafën e gjatë deri rrëzë gurmazit e me zor shkiste poshtë.

— Vetëm s'po kuptoj dot diçka... — tha Barba duke bredhur shikimin nëpër kishë. — Këto mure e ky ndërtime fare i thjeshtë e i varfër... Ndërsa këtu është shkruar 1634. Kjo datë shquhet mirë.

Oficeri e kuptoi se ky ish-seminarist donte të fliste për kishën. Po ai nuk mund t'i duronte më gjatë ekskursionet historike të këtij seminaristi. Fjalët e Barbës i qenë dukur oficerit si ca gaforre të vockla që ecnin mbrapsht nëpër truallin e përbaltur të asaj kishë shqiptare.

Ushtari i gjatë u përkul i tëri dhe e pa oficerin në sy. Përpigëj të kujtohej e në shikimin e tij, midis mjegullave të lodhjes e harrimit, diçka u ndez. Driteza feksi ashtu vetëm një grimë e përsëri mori të fikej.

Oficeri e ndjeu se ushtarin po e përpinte humnera e harrësës.

— 1634... — murmuriti Barba duke parë drejt në sy oficerin. — Sigurisht që në këtë fletore është hedhur edhe ndonjë kodik i huaj i ndonjë kishë më të vjetër. Gjëra që ndodhin.

Ai mbylli fletoren e nisi të shihte përsëri nëpër kishë. Shikimi i tij, sapo binte mbi një send, fluturonte te tjetri.

— Kështu janë shartuar perënditë.

Oficeri u drodh. Për herë të parë i shkrepri në kokë mendimi se Barba mund të mos ishte

i tëri i plotë. Gjithçka në fytyrën e ushtarit ishte shumë e lodhur: edhe balli i gjerë e i bardhëllëmë, edhe sytë e fryrë pufkë, edhe hunda e lëshuar poshtë. Oficeri mendoi të largonej prej tij, po midis ushtarëve të tjerë ky njeri ishte i vetmi me të cilin tani mund të bisedonte.

— Kur do ta varrosim atë? — pyeti oficeri.

— Cilin?

— Atë... — murmuriti oficeri.

— Ai është në shtëpinë e Krishtit. Pse shpejtoheni?

Seminaristi pa nga dritarja e kishës.

— Bie shumë shi, — tha pastaj.

— Ju mos jeni gjë e sëmurë?

— Ndoshta. Po ju duhet të harroni... ju nuk harroni dot?

Më tepër se pyetja oficerin e hutoi ai tingull i lehtë e i kthjellët i zërit të atij njeriu, i njëllojshëm edhe kur falej, edhe kur pyeste.

— Ju nuk harroni dot?

Oficeri vërtet nuk mund të harronte dot asgjë. Gjatë atyre ditëve, ai sikur e kishte detyruar trurin e vet të nguliste me imtësi gjithçka që ndodhte. Herë pas here kujtonte fytyrat e njerëzve, ndodhitë, udhët. Kujtonte ditën e 8 shtatorit, lajmin e kapitullimit të Italisë, fytyrat e hutuara të oficerëve e të ushtarëve, rropamën e triçikleve gjermane rreth e qark kazermës... Mbase do t'i nevojiteshin ndonjëherë. Po tani, në atë kishë, më në fund edhe ai dëshironte të harronte. Të harronte natën e mbrëmshme, kur ushtari i «Peruxhias» u ishte qepur prapa. Ata udhëtonin të vetëm bregut të detit e ai pas tyre. E pandehën ushtar gjerman dhe u tmerruan. Pastaj ato hi-

je njerëzore që papritur u dolën përpara duke lëvritur nëpër terr, një pëshpërimë e lodhur, e sfilatur e asaj toke të huaj. Donte të harronte se si më në fund ata vendosën të shkonin drejt atyre zërave,

— Shën Mëri... — oficeri bëri përsëri kryqin.

Dora e panjohur preku bukën që Agostini e kishte mbështjellë në shamë dhe e kishte lidhur te brezi. Ushtari po falej para ikonës, kur ai tjetri me zë të dridhur thirri: «Bukë!»

Një grumbull u mblodhën sakaq aty. Agostini shihte sytë e zgurdulluar, duart e uritura që drejtoheshin nga ai.

— Zoti im, — thirri. — Largohuni, është imja... — dhe e rroku bukën në gji.

E kapën. Duart të frikshme që e mbërthenin njëra pas tjetrës. Ushtari deshi të thërriste i tmerruar, kur mbi ta kumboi zëri i oficerit.

— Largohuni! Unë jam oficeri Xhino Roveli i batalionit të 3-të, regjimenti 128, të divizionit «Parma».

Sapo dëgjuan fjalën «oficer», ata u platitën.

— Largohuni...

Instinktivisht duart po e lëshonin Agostinin. Oficeri mori frymë thellë. Pastaj ai mori bukën nga duart e ushtarit.

— Sa veta jeni? — pyeti.

— Zoti oficer, — tha njëri, — ajo bukë nuk mjafton për të gjithë. Na e jep neve.

Njeriu që fliste mend po binte përtokë.

— Kemi tri ditë që s'kemi vënë kothere në gojë. Disa të tjerë kanë fshehurazi natën...

dorën mbi hejbenë varur te zogëza e samarit të mushkës. Me dy litra raki kishte shkëmbyer tek ushtarët italianë një xhakëtë e dy palë çorape të leshta. Një i njohur i kishte dhënë fjalën se do t'i dërgonte një palë këpucë me qafa për Mihalín, të vëllanë partizan.

Atyre ditëve fshatarët e Kodërdetit sillnin nga qyteti plaçka e rraqe, që i blinin nga ushtarët e braktisur. Në trastat e hedhura krahëve, apo në hejbetë e ngarkuara në vithe të kafshëve, ata kishin futur kush një fanellë, kush një batanije, kush një palë këpucë. Të shumtët i blinin nga matrapazët e Vlorës. Dimri po vinte. Fshatarët ishin njerëz të varfër dhe qeveritë e luftërat vetëm se i kishin rrjepur e zhveshur. Tani edhe ata po zhvatnin diçka prej luftës.

Lefter Pavli shkellej zbatshur mbi rërën e ngjeshur. Rëndonte me gjithë peshën e trupit dhe gishti i madh i këmbës së gjerë linte pas një vijë si ajo e brumbullit. Dy bishtakët e mustaqeve i kishte përdredhur si dy kokë akrepi.

— Do të të urojë plaka për fanellën, — tha xha Llambroja që ecte pranë tij.

— Pse të mos më urojë? Lavdi zotit, deri më sot, 80 kilogramë mish i gjallë jam. Plaka nuk është qarë ndonjëherë prej meje.

— Koka e zbrazët, merr qiellin, — tha tjetri.

— Ajër bota! Uh, — psherëtiu thellë Lefter Pavli dhe i ra me pëllëmbë ballit. — Hej, botë e halleve, — tha ai pastaj. Dhe nuk foli më.

Mushka çile me zilkë ishte e Dimo Vllahut. Dafina e kishte marrë kafshën me qira, sa për të bluar ato 50 kg misër që tani i kishte ngarkuar



në një anë të samarit. Në tjetrën kishte hipur vetë. Me këmbët në lak gruaja dëgjonte bisedit e fshatarëve, që, kush mbi kalë, kush mbi gomar, më të shumtët më këmbë e zbatthur, po ktheheshin në fshat.

Para mushkës së Dimo Vllahut shkonte Ziushi, gomari i kryeplakut. Ai ishte i vetmi gomar në Kodërdet, që kishte emër, që ushqej me tërshërë e mbajej në fre. Ishte i lartë si ndonjë at dhe samarin e kishte të mbuluar me qilim leshi të butë. Ziushi, ishte i patredhur. Kur fshatarët donin që gomaricat t'u pillnin pulishta race, i hiqnin ato me gomarin e zotit Milo.

Kryeplaku gjithë udhën po e bënte vetëm. Pa u ndalur, përshëndeste me kokë fshatarët dhe shkonte përpara. Ai ishte një plak i vogël eshtak, me xhakëtë e poture të kadifenjta të zeza, me një takije të bardhë në kokën e rreshkur. Për kokën e zotit Milo, Lefter Pavli thoshte se ishte si ato dardhat gomare që janë pjekur prej kohe, por s'duan të bien.

«Kësaj kohe nuk i zihet besë, — mendonte kryeplaku me vete. — Italianët, mbaruan. Gjermanët erdhën... po ku janë?»

Ai ndjeu prapa çapitjen e një kafshe. Ktheu kryet e pa mushkën e Dimo Vllahut.

— Mirëmbërëma, — përshëndeti Dafinën.

— Mirëmbërëma, zoti Milo.

— E bluve misrin?

Ziushi mori reyan e mushka e Dimo Vllahut shpejtoi çapin pas tij.

— Hyyyi! Dreq... aty e ke torbën tënde, — tha më shumë me vete kryeplaku. — Nuk ikën fshati, aty është...

Zoti Milo tërhoqi frerin dhe koka të ndërkyer e gomarit u lakua. Mushka u afrua fare pranë tij.

— Po ti, moj çupë, se si çupën time të kam, kur ke ndonjë hall përse nuk na thua fare? Pse të ngrihesh vetë e të shkosh deri në çytet për një karroqe berëqet? Ne jemi njerëzit tanë e për njëri-tjetrin jemi. Dhe kemi, do zoti, edhe kafshë edhe njerëz. Sa të të rritet djali, se pastaj shkon vetë ai, si trim.

— Faleminderit, zoti Milo, Po s'ka gjë...

— Zëri i kryeplakut ishte fare i përvuajtur. Dukej që kishte frikë. Dhe Dafinës, tek e shihte tani të tulatur mbi gomar, i kujtohej se si përpara tri javësh Milo Ndreu, së bashku me dy pleq të parisë, kishte shkuar asaj drejt e në shtëpi.

— Dil pak jashtë, — e kishin thirrur që përtej gardhit.

— Urdhëroni brenda, — ishte përgjigjur grua-ja.

— Jo, dil ti jashtë.

Dhe ajo kishte dalë. Të tre burrat, të akullt, rrinin në këmbë para saj. Kryeplaku i kishte thënë:

— Italianët që kanë marrë vesh të gjitha dhe mua dhe më thirrën në postëkomandë. Këtëj e tutje, po mbajte në shtëpi partizanë, ne si pari e fshatit, po ta themi troç, që nuk do të rrimë kënd e kënd në Kodërdetin për kënd e kënd tënd.

— Këto fjalë, zotrote, mos m'i thuaj mua! Thuaja të zotit të punës.

— Ja që ti mbete këtu. Kë ta gjej unë tët shoq? Pon Duka vjen e ikën si era, në fshat s'duket, gjëkund.

— Poni atë punë ka! Dhe me të do mbajë shtëpinë. Kurse këto fjalë ua thoni atyre!..

— Kujt, moj?

— Partizanëve. Unë një copë grua jam. Dy të tjerët kishin luajtur prej vendit. Fy-

tyra e kryeplakut ishte nxirë dhe sytë e vegjël i  
ishin bërë akull.

— Në emër të parisë e të fshatit të them që  
të mos sjellësh më këtu partizanë, përndryshe më  
qafë paç veten. Unë kaq pata.

Dhe ata të tre ishin larguar pa përsënde-  
tur. Sonte zoti Milo thoshte:

— Çfarëdo halli që të kesh dërgoje djalin tek  
unë, si te babai yt. Njeriu për njeriun është,  
moj bijë.

Dafina ishte vajzë fshati. Ajo dhe Mihali ki-  
shin lindur atje në Kodërdet. Jetimë nga nëna  
qysh në fëmijëri, për ta u kujdes i ati, një  
bujk që punonte me të tretë tokat e kishës.  
Babai e pajtoi djalin e vogël çirak te një bakall  
në Vlorë. Duke punuar në dyqan, duke i ndih-  
muar zonjës në punët e shtëpisë, çunaku mësoi  
vjedhurazi edhe shkollën. Ai u rrit në qytet,  
por nga fshati nuk u nda kurrë. Nuk mund të  
ndahej nga vetvetja. Atje kishte të motrën që,  
pas vdekjes së babait, e martoi me Pon Dukën.  
Ky punonte në mol në Durrës, dhe rrallëhe-  
rë vinte në fshat, sepse «puna e mban të lidhur  
njeriun, si zinxhiri qenin». Ndërsa Mihali, bën-  
te, ç'bënte, edhe pse partizan, gjithnjë e hidh-  
te nga një hap deri aty. «Lufta është luftë. — I  
thoshte së motrës, — Sot këtu, nesër atje...»

Fshatarët morën frymë thellë. Udhë e ngu-  
shtë bënte bërri në të majtë e shkonte rrëzë

kodrés së madhe, të futur si hundë qefulli brenda në liqen. Aty, nën ullinjë, shtrihej fshati. Dega tjetër e tragës shkonte gjithnjë bregut e gjithnjë drejt veriut, nga tretej hapësira e pafund e kënetishtës. Ca kodra, shkëmbore, njëra pas tjetrës, e ndanin ultësirën e mbuluar me zhukë e çeplaz<sup>1)</sup>, me marinë<sup>2)</sup> e kallam të egër, prej detit. Ajo udhë të çonte në Shën-Triadhë.

Grumbulli i fshatarëve fironte para çdo dere. Ata vinin përpara gjënë e gjallë e fëmijët që dilnin në rrugë t'i prisnin, u thërrisnin me zë të lartë të afërmve dhe hynin nëpër shtëpi. Në ato ditë lufte kushdo e mbante në fshat lopën e vogël shtatligë, që zakonisht kulloste e pillete larg ndanë detit. Tani kafshët, të ngjacuara,<sup>3)</sup> i kullosnin fëmija arave, hendeqeve e gardhiqeve të fshatit.

Dafina mbeti vetëm. Mushka e Dimo Vllahut, e lodhur, çapitej udhës së kalldrëmtë. Kafsha ndërte qafën e djersitur përpara, hidhte këmbët ngadalë e, duke zgjedhur vendin, ngulte thundrën mbi gurë. Një nga një fshatarët u futën nëpër shtëpitë e ulëta. Fshatin e mbështolli bryma e lagësht e asaj mbrëmjeje. Lehjet e qenve, blegërimat e deleve, zërat e heshtur të njerëzve mbe-

1) bar kënetash, me fletë të gjata, të ngushta dhe të mprehta si thikë.

2) bimë me fletë të holla që rritet nëpër ranishte ose anës lumenjve.

3) Lidh me litar kalin, lopën etj., në një lëndinë a shesh, që të kullogë.

Dafina u ngrit nga shtroja, veshi polkën<sup>1)</sup>, hodhi mbi kokë thesin dhe doli jashtë. Qeni iu fut nëpër këmbë. Zbathur, nëpër shi, gruaja kaloi hendekun dhe hyri në luadhin e vogël ku kishte ngjacular mushkën e Dimo Vllahut. Kafsha, e lagur, ishte mbledhur e tëra dhe dridhej prej të ftohtit.

— Eh, se shi vjeshte është, — tha Dafina.  
— Nuk të gjen gjë... jo.

Zgjidhi litarin dhe e tërhoqi prej kapistalli. Tej shkrepit dhe hapësira e gjerë kënetore ndriti. Dafina ngriti kryet nga qielli i rënduar me re. E çoi mushkën në kasolle e i hodhi bar të thatë. Dhe doli jashtë.

Qeni e ndiqte pas. Ai përgëzohej e hungëronte nëpër këmbët e së zonjës. Rrallë ndodhte që Dafina të zgjohej ashtu menatë. Gruaja u nis për në shtëpi, por ndjeu diçka që e pengonte. Qëndroi mëdyshas në mesin e udhës. Nga lindja një vetull e bardhë qielli po ndriste. Po zgjoheshin kodrat, ullinjtë, koriya e dafinave në varrezën e fshatit aty pranë. Asaj iu kujtua varri i të atit. Mbrëmë, kur ishte kthyer nga qyteti, ajo nuk ishte ndalur fare atje. Dhe tani i vinte sikur i kishte bërë një padrejtësi babait.

### 3.

Oficerin e përmendi kazma që goditi tokën gati te këmbët e tij. Ai ktheu shikimin aty e pa këmishëziun: i shkurtër, qafëtrashë, ishte

1) Bluzë grash me mëngë të gjata, me jakë të vogël të rrumbullakët e me tri-katër kopsa në gjoks.

49347



gërmuqur i gjithi mbi gropë. Kazma goditi duke lëshuar një gjënim të mbytur, të njëllotë me ofshamën e ushtarit.

Ushtari me gjoksin e ngushtë iu afrua oficerit.

— Ah, Luixh, si ndihesh sot?

— Zoti oficer...

— Çfarë?

Ushtari, i tretur e i zbehtë, tregoi me kokë këpucët e të vdekurit. Pastaj u hodhi një shikim të gjatë këmbëve të veta. Këpucët që kishte mbathur ishin bërë trokë, gjysmat e shojeve ishin ngrënë fare.

— Nuk ka kuptim, — i tha Luixhi oficerit.

Ky heshti. Sytë i mbetën te këpucët e reja të ushtarit të vdekur. Qëndroi ashtu një copëherë, kur dëgjoji përsëri Luixhin që po i thoshte:

— Nuk ka kuptim, zoti oficer.

— Jo!

Dhe hodhi shikimin e vet nëpër tufshakët në ngjyrë të pjekur të çelazit kënetor, pastaj më tutje, andej nga s'ishihej asgjë. Luixhin më shumë e habiti sesa e trembi ai zë i akullt, i prerë i atij oficeri.

— Merr lopatën!

Këmishëziu u tërhoq mënjanë e Luixhi nisi të nxirrte plisa prej gropës. Duke punuar, ai mendonte se toka ishte po ajo, e butë, e shkrifët, njësoj si toka në fshatin e tij në Itali. Toka ishte njësoj. Ushtari nxirrte dheun me ngulm. Shiu e diersa i rridhnin e i lëpiheshin në fytyrë. Varri nën të thellohej gjithnjë e më tepër.

Oficeri vështronte nga lindja, ku s'dukej gjë tjetër vec tymit e mjegullës së dendur të vjeshtës.

— Mbaruam, — tha këmishëziu.



Oficeri hodhi sytë poshtë. Dhe atëherë dëgjoj Luixhin që foli përsëri!

— Zoti oficer... Po nuk ka kuptim...  
— Mos O —

— Në pastë edhe për ne një perëndi, deti është, vetëm deti.

Nëpër shi, ata po i ngjiteshin së përpjetës kodrinore. Gjembat e ferrave u shponin këmbët dhe oficeri shau disa herë. Ai qëndroi e po kruante pulpat.

— Të shpoj në si mushkonja të këqija...

U nisën prapë. Ai dëshironte vetëm të ecte, të bënte diçka.

— Ne rrimë e presim në atë kishë... Po ç'presim ashtu? Vdekjen tonë?

— Njësoj është, — u përgjigj kësaj radhe Barba që vinte pas tij.

— Gjermanët, partizanët, uria...

— Njësoj është, njësoj...

Oficeri e kuptoi se me ato fjalë Barba donte t'i thoshte atij se tani, ngado që të ktheheshin, jeta për ta kishte vetëm një fytyrë: atë të vdekjes.

Kudo njësoj. Në mos sot, nesër. Po derisa vdekja nuk e mbërtheu atë, togër Xhino Rovelin, as pardje, as dje, ajo mund të mos e kapte as sot e as nesër.

Hapësira e pafundme u lëkund e tëra para tij. Valët e egra shkumëzuese vinin sërë-sërë dhe humbnin nën kodër. Ngadalë oficeri u afrua te buza, atje ku kodra pritej poshtë si me thikë. Humnera thellohej prej majës e deri poshtë te shkëmbinjtë, që nxinin midis valëve.

— Ja ku qenkemi..

Njeriu nuk dëgjo dot as fjalët e as zërin e vet. Tingujt ia përthau në buzë era e kripur. Sytë vetiu i shkuan drejt ishullit. Sa më shumë zhbironte nëpër atë mot të keq, aq më tepër ishulli afrohej, i egër e kanosës. Pastaj deti i gjerë që shtrihej pa fund.

— O zot! Dhe të mendosh se atje përtej është Italia!



— Ia polli e shoqja, Leni, kështu të rritur...  
Është italian. E sheh si e ka bërë?

Italianit i kishin veshur një palë poture ka-  
difeje me arna në gjunjë dhe një rrotullame  
të madhe të zezë prapa; një triko leshi me vija,  
pa grykë; çorape me lidhëse në lakëzën e këmbës  
dhe një palë opinga llastiku; i kishin hedhur në  
qafë një shami të kuqe me flutura të mëdha që  
të fshinte djersën; në kokë i kishin rrasur një  
qylaf, të bardhë borë, të ngrirë e me një bisht  
labi përpjetë.

— Po ky duket fare si dordolec!

— Qylafin ia kanë blerë të ri, në Vlorë. Të  
mos e njohin fare.

Fshatarët mbushën duart me rrush, i thanë  
edhe italianit të pushonte e, së bashku, shkuan  
e u mbështetën te bytha e fikut të gjerë.

— Plaka ime, atë timin, së lë fare të dalë  
prej shtëpisë, t'ia tha Piloja. — E mban pas si  
cupë të madhe. Në dhomë ajo, në dhomë ai, në  
kuzhinë ajo, në kuzhinë ai. Ai i fshin, ai i ndez  
zjarrin. Nuk duroj dot, thotë gruaja, ta shoh të  
vrarë nga gjermanët. Dhe mua po më del gjumi  
natën. Nga Parma qenka. Mbetën keq rrugëve  
këta...

Piloja i hodhi një sy italianit që po hante  
rrush. I pa sytë e mëdhenjë të kaltër nën qyla-  
fin e bardhë...

— Padre? Ke padre?

— Padre.

— Mama?

— Mama.

— Po fratelli, orë, a... ke?

— Due.

— Andej? — dhe Piloja fregoi me dorë de-  
tin.

— Due. Italian.

— Shyqyr paska të paktën edhe vëllezër të tjerë, nuk qenka i vetëm...

Piloja e hoqi shikimin nga italiani. Nuk donte që ky ta kuptonte se atij po i vinte keq për të.

— Gjermani me këta s'ë bëka të gjatë, — tha. — Po të pikasi që je italian: plumb! Dhe është si qeni: e ndjeka erën e këtyre që atje tutje. S'di si dhe ku t'i fshehësh.

— Thonë se dhe këtu në Kodërdet do të vijnë gjermanët, — tha Zoi.

— Do vijnë, ç'do bëjnë? Iken italianët, vijnë gjermanët. Atë i thashë guas mbremë. Italianin tonë do ta dërgoj partizan. Të luftojë edhe ai në male. Si të tjerët. Atje është më i ruajtur. Edhe po u vra, e paguan veten më mirë. Me pushkë në dorë është. Se, po erdhën gjermanët këtu, kush e mban kryeplakun tonë. Të vdekurit nga varri ka për të nxjerre.

— Po sikur ta nisje në Itali?

— Me se? — u habit Piloja. — Dy varka që patëm ua dhame fshatarëve të Breglumit e ata i nisën plot me italianë të mbetur udhëve. Ata breglumasit, të gjorët ata e dinë se ç'hoqën. Varkat ishin të vjetra, fshatarët i ndreqën, i lyen mirë me serë e u qepën velat. Pastaj poqën furnët me bukë. Me kokën në trastë iu përvodhën rojave gjermane, i nxorën në breg dhe i nisën. A arritën dot? Një zot e di... Ama varka të tjera nuk ka, jo vetëm në Kodërdet, po gjëkundi në Vlorë. Lundrat tona, që i shtyjme me fush-tagë, mezi lundrojnë në kënetë e jo më në det të hapët. E kanë të kotë këta, që vijnë e mblidhen andej nga Shën-Triadha... E ç'do të gjejnë andej?

Italiani qëndronte i heshtur pranë tyre. Ai e kuptonte që ata të dy po flisnin për të, por nuk i merrte vesh.

— Djali i madh i Kolës... Eh! — buzëqeshi Piloja. — Ç'helaq qeveri që kishin! — tha ai përnjëherësh. — Të qelbur! U kam thënë atyre nga Shën-Triadha: Ç'më rrini këtu, more?! Veç kur t'ju vijne ndonjë ditë gjermanët...

— Pandehnin se këndej janë më afër Italisë dhe mund ta hëdhin detin më lehtë.

— Pandehin, — murmuriti i trishtuar Piloja. — Ashtu pandehin. .. Ç'të bësh!... Atdheu... I tërheq toka... — Fshatari qëlloi me shuplakë plisin e vreshtit: — Tokë, fat njeriu... — tha ai pastaj.

Lefter Pavli mbushi me vaj kandilin para ikonës së shën Triadhës, i vuri fitil të ri dhe e ndezi.

Rreth tij u mblodhën ushtarët. Ata rrinin të heshtur, si hiqe pa shpirt. Toger Xhino Roveli iu afrua përbri:

— Varkë? Italia...

— Italia... — tha Lefter Pavli duke i hedhur një shikim nga koka deri te këmbët. — Aty është Italia... Nuk ikën... E di edhe unë, aty është...

— Varkë... mëre<sup>1)</sup> — dhe toger Xhino Roveli rremonte me duar në ajër.

— Nuk ka varkë... nuk kaaa... Po të kishte, ne ju nisnim vetë. Po nuk kaaa...

Lefter Pavli mori trastën që kishte lënë te këmbët, nxori copën e bukës së misërt, një grusht ullinj të kripur dhe një kokërr qepë.

— Na, — ia zgjati njërit. — Merrini këto që ka vënë pfaka për mua, por mos shpresoni gjë.

1) (ital.) — deti



këndeje. Nuk ka varkë. Na jepni ju varka dhe ne ju hedhim matanë. Po ju'na i morët edhe tonat... Kot ë keni që vërtiteni këndeje. Edhe po t'u shpëtoni gjermanëve, do t'ju hanë çakejtë.

Ata dëgjonin të heshtur, të trishtuar, të humbur.

— Fshatarët, të zinjte, duan t'ju ndihmojnë, se edhe ju fshatarë jeni, po s'kanë me se... Eh, thoni ju, si t'ju ndihmojmë? Që të mos ju vrasin gjermanët de... Fundja, njerëz jeni edhe ju, po ç'të bëjmë?... Në Drashovicë po bëhet luftë e madhe, po luftojnë partizanët. Ikni që këndeje se do ngordhni për të ngrënë. Mirë Duçja që ju la, po ku e keni atë Badolion<sup>1)</sup> tuaj?

— Duçe?

Italianët lëvizën dhe iu afruan më pranë. Çfarë thoshte ashtu ky fshatar i huaj:

— Badolio?!

Leftër Pavli pa se si në sytë e tyre shkrepën xixa dritash. Italianët u gjallëruan.

— Eh, gjepura! — dhe fshatari ngriti në ajër e pastaj e lëshoi poshtë pëlëmbën e tij. — Duçe... Badolio... gjepura! Mendoni, ore, për veten tuaj. Keni nënë? Keni. Grua keni? Keni. Fëmijë keni? Unë s'kam fëmijë, po thonë që fëmija është shumë i dhembshur. Thonë... E derisa thonë, ashtu duhet të jetë. Ti, a ke fëmijë? — pyeti përnjëherësh Leftër Pavli ushtarin korrozi, të palarë e të parruar, që i rrinte përpara. — Fili, fili... a ke? Kaza fili?

1) Badolio — mareshal i ushtrisë fashiste italiane. Në korrik të vitit 1943, pas arrestimit të Musolinis, mareshali Badolio, u emërua nga Viktor Emanueli në postin e kryetarit të qeverisë italiane.

2) (ital.) — shtëpi fëmijë

... — Due, — otha tjetri. —  
... — Due, — dhe fshatari ngriti në ajër dy gi-  
shtërinjtë e dorës së tij të djathtë. — Të të rroj-  
në. Due... I paç, me jetë, Mos ki frikë, ata do  
rriten, po ti do bësh mirë t'u ruash babanë aty-  
re. Jetojmë kohë të liga. Asnjëri nuk e di se ku  
e ka kokën. Po ju mendoni për kokën tuaj, se  
detit me këmbë nuk i bihet.

Dafina e kishte mbushur kanistrën me grurë  
të zier, me arra, meshë, qefull të skuqur, djat-  
htë e ullinj. Ishte e diel. Heshtjen e trishtuar të  
fshatit e thyente kambana e vetme e kishës së  
shën Mërisë. Gruaja, me kanistrën nën sgetull,  
doli nga shtëpia dhe shkeli kalldrëmin e udhës.  
Kisha e gurtë dhe e bardhë, me varrezën e vogël  
përreth, ishte aty pranë shtëpisë së Pon Du-  
kës. Sado që ishte mesuar me atë tingull të  
trishtë të asaj kambane, Dafina përsëri ndien-  
te një sëmbim të thellë në kraharor. Sot bënte  
përsëpirjen e të atit. Dafina humbi midis grave  
të tjera, edhe ato të heshtura e gojëkuçura, me  
kanistra në sgetull apo në kokë, shkolin në kishë,  
Ashtu, grumbuj-grumbuj, gratë kalonin pragun e  
hajatit, hynin brenda dhe vendosnin secila kanis-  
trën e vet midis të tjerave. Kur hyri Dafina, gra-  
të diçka murmuritën; tufa e tyre, e veshur me të  
zeza, luajti dhe i hapi vend. Prifti i fshatit, atë  
Thanasi, po falte kishën. Shumica e atyre që po e  
dëgjonin ishin gra e fëmijë. Burra kishte fare pak.  
Pranë psaltit, me takijen e bardhë në dorë, qën-  
dronte kryeplaku, Milo Ndreu, dhe, libri i tij,  
Lefter Pavli.

Dafina bëri kryq e marmuriçi emrin e të atit. Sot ajo ishte më e vetme dhe më e trishtuar. I ati nuk kishte ndonjë përvjetor e as ndonjë ditë emri. Por mbrëmë gruas sesi i kishte ardhur: i shoqi ishte gati gjithnjë larg me punë, ai vinte rrallë, aty; i vëllai ishte maleve partizan. Që kur kishte rënë Italia, thoshin se partizanët po luftonin kundër gjermanëve në Drashovicë. Dafina ndjeu një frikë të egër dhe një dhimbje për Mihalin, të vëllanë. Ata ishin të vetëm, vëlla e motër. Kurse, Leka, djali i saj, ishte ende i vogël. Të atin, Dafina mend e kishte harruar, kaq kohë...

Kisha e shën Mërisë-ju duk e heshtur dhe fare e ftohtë. Ajo shkoi e mori tre qirinj, i ndezi, dhe i nguli mbi grurin në kanistër.

— Shpirti i babait...

Në të vërtetë të atin, edhe pse e kishte Aveshë me duart e saj e me duart e saj e kishte vendosur në arkivol, nuk e mendonte dot (asnjëherë) të vdekur, Thupvogël, me sytë gati të fikur, që binin gjithnjë të shqetësuar mbi të bijën ai i dilte përpara edhe tani i gjallë. Dafina i shih-te ata sy të plakur e pëshpëriste me vete:

— Baba... më fal... Më fal, babairë! —

Zëri i atë Thanasit kumbonte në kishë. Drita e ofrinjve luhatej mbi vkanistër, ku Dafina po shihte fytyrën e vuajtur të të atit. Falmë... të kam harruar kaq kohë... të kam lënë të vetëm... Dhe mendja i shkoi gjithnjë te dialekt. Një zë brenda saj i thoshte se i ati mund të falte në qoftë se e harronte për Lekën, të nipin. Atëherë po... «Të kam harruar, baba...»

Dafinën e përmendi qetësia e thellë që ra në kishë. Gratë lëvizën dhe secila shkoi të merrte kanistrën e vet. Kisha ishte falur. Pa kuptuar.

asgjë, Dafina nisi të bënte po ato lëvizje, si shoqet e veta. Me kanistrën në dorë ajo shkoi nga ajodhima, i dha atë Thanasit meshën e i puthi dorën. Tek kthehej, në mes të kishës, atë e priste Lefter Pavli.

— Të kam në vendin e babait, — tha Dafina.

— Më ke.

Gruaja shpërtheu në lot. Qante me ngashërim aty, në mesin e kishës. Edhe një grua tjetër nisi të qante. Dafina mori nga kanistra qe-fullin më të mirë dhe ia dha Lefter Pavlit.

— Për shpirtin e babait, — tha. — Sikur ha ai...

— Një zot e di, Dafinë. Po ti mos qaj. Yt atë fku i lumtur. Pa shiko: ja, ç'po bën ti për atë. Më thuaj mua të ziut, cillin kam unë?

— Më ke mua.

Atëherë edhe Lefter Pavli nisi të lotonte. Ai mori në duar kokën e asaj gruaje dhe e puthi në ballë. Dhe qante.

— Më lumturëve. Të faleminderit, moj bijë.

Të dy dolën në hajatin e kishës. Dafina u shpërndau përshpirtje edhe kryeplakut, psaltit e kishtarit që rrinin jashtë në këmbë.

— I përjetshëm kujtimi!

Pastaj Dafina shkoi më tej e u dha përshpirtje një nja katër italianëve që qëndronin të heshtur para kishës. Ushtarët merrnin çfarë u jepnin ato gra. Ata shihnin duart e tyre që mbusheshin me ushqime dhe hanin të heshtur, të hutuar e të gëzuar.

— Për shpirt të Ndre Davidit.

Dafina e Lefter Pavli kaluan derën e vockël të varrezës së kishës. Varre fshatarësh, pranë e pranë njëri-tjetrit, ca mbuluar me bar e vithisur në tokë, ea me nga një kryq guri mbi

krye. Të tjera varre, të mëdha, prej guri të bardhë e me pllaka të rënda përsipër. Rrallë ndonjë varr i mermertë. Varreza ishte e rrethuar me qiparisa të mëdhenj hijerëndë. Te cepi, nga ana e liqenit, një dafinë e dendur binte mbi varrin e Ndre Davidit. Ai ishte një varr i madh i gurtë, me një pllakë të gjerë e të bardhë përsipër. Atë pllakë të latuar e kishte sjellë nga Vlora, për varrin e vjehrrit, Pon Duka. Për këtë Dafina i ishte mirënjohëse gjithë jetën të shoqit. Ajo kishte mbjellë aty, të kryet e babait, atë dafinë që ishte rritur aq shpejt. Varri i Ndre Davidit humbiste mes gjelbërimit të qiparisave dhe të dafinës. Përreth kishin çelur trëndafilat e bardhë të shtatorit dhe kundërmontë borziloku. Dafina e Lefter Pavli shkuan atje. Dafina ndezi një qiri, e vuri mbi pllakën e bardhë dhe lëshoi përreth tij ushqimet e kanistrës.

Pastaj nisi të qante.

Qante me zë të dhembshur e të ulët.

I numëronte të atit të gjitha vuajtjet e tij. Nga fëmijëria deri në pleqëri. Gjithë jeta e atij njeriu kishte qenë vetëm vuajtje e dhimbje.

— Popull, i shkretë, — psherëtiu Lefter Pavli.

Vajtimit e Dafinës e shpoi zëri therës i një gruaje aty pranë. Mariës së Kristo Bualit i kishte vdekur nga plëviti çupa 15-vjeçare, e vetme. Dhe ajo qante tani. Dafina u ngriti e shkoi te shoqja. Të dyja gratë nisën të qanin mbi atë varr fare të ri.

... Duke kaluar gati mbi majë të këmbëve, di-  
kush shkoi e u përgjunj para ikonostasit. Ofi-  
ceri e kundroi atë me vëmendje. Deri atëherë  
as që ia kishte zënë syri njeriun shkurtabiq, me  
këmbë merimange, me qafë cipal, që nisi të  
falej para ikonës si në jerm. Oficeri mendoi  
se ky njeri që papritur i qe shfaqur para sy-  
ve, nuk kishte asgjë prej ushtari. Çi duhej  
ky luftës?  
Në gjunjë, ushtari kishte puqur të dyja du-  
art te buzët e po falej.  
— Ç'tip! — tha oficeri me vete.  
— Thonë se ka qenë në Libi, kur luftonte  
Romeli,<sup>1)</sup> — tha rreshteri i këmishëzinjve.

1) Në vitin 1941 gjenerali Romel komandonte trupat gjermane në Frontin e Afrikës Veriore.



— Oh!

Oficieri dëgjonte pëshpërimën e buzëve të ushtarit, por nuk arrinte dot të kapte fjalet e tij.

— Tregon gjë për Romelin ai?

— Dje po tregonte.

Nga fundi i kishës u dëgjuan të gërthiturat e sëmura, historike, të dikujt. Klithmat vinin andej nga gjysmëterri.

— I lexhionari<sup>1)</sup>... i lexhionari...

I sëmuri tha edhe diçka tjetër, po oficeri nuk arriti dot ta kuptonte.

— Zoti oficer, e dëgjon? E dëgjon? Edhe tani ai e kujton Musolinin...

Këmishëziu e kishte mbërthyer prej krahu Xhino Rovelin dhe po ia shtrengonte si ndonjë darë. Oficerit i dhembti.

— Nuk kemi vdekur, — tha Ugoja. — Ende nuk kemi vdekur... Edhe të këta njerëz, fashizmi nuk ka vdekur i tëri...

I sëmuri ishte ngritur përgjysmë. Hidhte sytë rreth e rrotull e shikimi i tij i çakërdisur sikur kërkonte të shponte errësirën e ngjyer në dritën e zbehtë të kandilit të kishës.

— Qetësohu... — Barba u përkul mbi Marion e i mori dorën. — Jezui është me në, në këtë mynxyrë...

— Nuk të besohet? Ti më sheh që ha bukë, bisedoj me ty dhe nuk të besohet, se unë edhe ta

1) (ital.) — Kështu quheshin në Romën e vjetër ushtarët e këmbësorisë: termi u përdor edhe nga fashistët italianë për të emërtuar disa reparte të milicisë etj...

ni, me sytë hapur, shoh ëndrrën e mbrëmshme? Unë tani jam në Bolonjë, eci udhës dhe e di që në shtëpi më pret Ana, me të dy çupat. Më presin. Unë po shkoj rrugës sonë... Ja shtëpia e zotit Karlo, ja edhe tregtorja e vogël e zotit Maurini. Tani duhet të shohi furrën, po më ikën rruga... Dhe prapë shkoj ndanë shtëpisë së zotit Karlo... ja dhe ballkoni ku zoti Maurini bën banjë dielli... po udha ikën... edhe unë iki...

— Ti ke shumë ethe, Mario, — erdhi zëri i rëndë i Pietros.

Agostini, prej vendit të vet, përgjonte i ngrirë bisedën e atyre dy ushtarëve. Nuk i besonte dot vetes. «Ai shikuaka ëndërr me sy hapur... Tani unë jam në Bolonjë...». Sikur t'ia shkruaja këtë babait, do të çuditej e do të dëshpërohej shumë. Nëna do të qante...

I sëmuri u ngrit me zor. Mbështeti shpatullat te muri i kishës e nisi të përtyppte edhe ai kotheren e bukës.

— Unë i mora erë, më parë se ta haja, — tha Pietroja, i shtrirë bri tij.

— Ashtu?

— Po... Dhe më erdhi për të qarë. E harruam erën e bukës, Mario... e harruam.

— Nuk është ndonjë çudi, Pietro.

— Çfarë?

— Nuk është çudi ta harrosh.

Sytë e bardhë të zmadhuar të Marios ishin ngulur në dritën e zbehtë të kandilit, që luhatej tek ikonostasi. Cipa e syrit i ishte pjekur prej etheve.

— Nuk qenka vështirë të harrosh erën e bukës, — murmuriti ai. — Eh, ne po harrojmë veten tonë...

— Si erdhe ti këtu? — pyeti oficeri Ugon.  
— Unë?

— Pse nuk qëndrove me gjermanët, kemi-  
shëzinjtë ata nuk i vrasin.

— Nuk më besuan.

— Si, nuk të besuan?

— Ashtu, nuk më besuan, — tha kemishëziu  
duke ndjekur me sy pikën e shiut që pikonte  
mbi truallin e përbaltur të kishës. — Nuk më be-  
suan... zagaret, — tha pastaj nëpër dhembë. —  
Bijtë e bushtravë!

— Po pse nuk të besuan? — pyeti zëri i ftoh-  
të i oficerit.

— Pse? — Fashisti zgjati drejt tij kokën e  
madhe gjithë leshra të zeza të përdredhura. Fy-  
tyra iu bymye. — Më vunë përpara me ata të  
tjerët, — tha me zë të mekur.

Tani njeriu ishte fashitur si flaka në një dru  
që është djegur prej kohë përbrenda.

— Duhej të të besonin, — tha oficeri.

Ushtarët nazistë e kishin rrethuar papritur  
sheshin e qytetit. Të armatosur deri në dhembë  
ata nisën të ndalonin e të mbanin çdo udhëtar që  
kalonte atëje. Brenda disa minutave një grup  
bull i madh shqiptarësh e italianësh u rrethuan  
nga ushtarët nazistë.

Pijeshitësi e mbylli qepenin. Klientët që u  
ndodhën brenda në pijetore shihnin të shtan-  
gur se ç'po ngjiste jashtë, te sheshi. Nga mesi  
i ushtarëve gjermanë doli njëri. Dhe foli ita-  
lisht. Ugoja e kishite dëgjuar vetë atë, kur ki-  
shte thirrur:

— Italiani, da una parte, melio per voi...<sup>1)</sup>  
Fryma e njerëzve varej në ajër.

— Melio per voi, italiani... — thirri përsëri  
me zë të lartë gjermani

Dhe atëherë italianët nisën të dilnin një e  
nga një. Ugoja ndjeu një frikë të akullt që ia ngriu  
gjymtyrët. Sytë iu terratisën e nofulla e poshtme  
i u shtrembërua. Ai shihte nazistët se si po i rrih-  
nin dhe po i ngarkonin në kamionë ushtarët itali-  
anë të çarmatosur.

Nazistët ikën nga kishin ardhur. Sheshi i qy-  
tëtit, i hështur, u shtri me i gjerë se kurrë. Një  
burrë i moshuar u ngrit prej tryeze, shkoi e hapi  
derën e tregtores e u kthye te banaku.

— Tani ata i pushkatojnë.

— I pushkatojnë?

— Të gjithë.

Këmishëziju zgurdulloi sytë i tmerruar. E pa  
vëten fare të vefëm e të pambrojtur midis atyre  
njerëzve të huaj. Hodhi sytë mbi pijeshitësin, kur  
burri pranë tij tha:

— Po ju, pëse i kenë ato armë? Puh! — Dhe  
ai pështyu në tokë. — Turp për vdekjen tuaj!

Shikimet e gjithë atyre njerëzve u ngulën mbi  
këmishëziju.

— Ua dorëzoni armët gjermanëve, që ata pas-  
taj të na vrasin ne, siç na vratë edhe ju... Turp  
për vdekjen tuaj!

---

1) (ital.) — Italianë, dilni mënjandë, është më mirë  
për ju.

Unë, rob i perëndisë, atë Vasili, i biri i Ngjellit të Niko Gropës, po hedh këto djallë në radhua, që t'i dini ju që vini pas nesh. Unë, atë Vasili, me vullnetin e zotit tonë Jezu Krishtit, bari i kopësë, njerëzore të katundit Kodërdet, po ju them juve se mbrëmë erdhën turqit. Turqit e palë kërkuan djemtë e vegjël, pesë vjeç e sipër. Do t'i bëjnë fëmijë të sulltanit të madh; jeniçerë. Unë, rob i përvuajtur i zotit tim Jezu, shihja gratë e fëmijët si qanin e lebetitëshin, më keq se shqërrat kur i thurin sepse bagëzia e ndien erën e gjakut. O perëndi, që i shiban të gjallë zogjtë e qiellit, pse e bërë kaq të rëndë jetën e njeriut mbi dhë! Kristo Driza nuk donte që i biri të bëhej jeniçer dhe, duke qarë, mbërtheu kërcellin e këmbës së njomë të djallit e ia theu me duart e veta. Sepse, që ta dini ju që vini pas nesh, sakatët e plokët nuk i hynë në punë sulltanit. O zot i madh, je apo s'je.

Barbës iu duk sikur po kridhej në një hon të thellë e të shurdhër. Mjegullat e dendura iu mbloodhën në bebëzat e syve. Vetiu ai mbylli qepallat.

— O zot i madh! Përse na i tregon tani ato vjetersira të mykura? — thirri oficeri aty pranë tij.

Barba zgjati përpara fytyrën e habitur si një qukapik që s'dinte ku të sqeponte.

Përse na i tregon tani të gjitha këto? — zëri i oficerit ishte lutesë i përvuajtur.

— Siç duket, ju keni fëmijë. Ahi! — Barba zgjati dorën dhe e zuri oficerin nga supi. — Ju keni fëmijë. Po s'të bëjmë? Unë ju thashë të harroni.

Nga fundi i kishës lëmshe-lëmshe nxinin ushtarë! Ata i largoheshin ikonostasit e instinktivisht kërkonin errësirën, sikur atje të ishin më të qetë e më të sigurt. Edhe vetë oficerin dëkta e largonte prej tyre. Ndoshta se që oficerin e fati i tij duhej të ishte pak më i ndryshëm se i të tjerëve, ndoshta se tani ata njerëz ishin të shurdhër e mospërfillës ndaj kujtdo, qoftë ky edhe oficeri. Xhinë Roveli i'u afrua dy ushtarëve. Ata kishin shtruar nën vetë barëra e gjethe fieri të thatë! Ishin të veshur me rröba prej doku! «Sigurisht që ngrijnë nga të ftohtët, — mendoj oficeri, duke i përpirë me sytë e lodhur. — Kam vetëm nënën, — tha ushtari. — Plakë: Ja, — dhe nxori fotografinë.

— Kush është kjo shën Mëri? —  
— Nëna. Më dërgon letrat që ia shkruan postieri i fshatit. Lopën e paskësh shitur se, nuk e mbante dot.

— Ti s'je i martuar? — pyeti tjetri.

— Jo.

— Duhej të ishe martuar.

Ushtari këputi kryet sikur t'i kishin rënë me shuplakë.

— Ishte njëra, — tha ai... — Monika... E shoh gjithmonë në ëndërr.

Oficeri ecte përpara me hap të zvergur por që i gjithi pas, atje ku bisedonin ata të dy.

— Nënë sheh në ëndërr?

— Jo. Dua të shoh nënën dhe mbyll sytë me pahir... Po aherë më mbijn përpara Monika...

— Duhej të ishe martuar, — tha përsëri ai tjetri.

— Atje kishte ç'të doje, verë, stafidhe, femra...

Fjalët u ngatërruan në veshët e oficerit dhe ai hodhi sytë mbi ushtarët e tjerë, që ishin përpara, shtrirë në tokë. Ata ishin tre. Njëri në mes, përmbys, diç po u tregonte. Dy të tjerët, me shpatullat në dhe, kishin vënë duart nën krye e po dëgjonin.

— Kemi rrojtur edhe në dicka. S'je harroj kur u kthyem nga Etiopia në Sigilit.

— Dëgjomëni mua, sa të hidhemi andejopa përsëri.

— Në Sjailli, thashë, për një gjysmë gavete makarona, — e ndërpreu i pari, — dhe gruaja vinte së bashku me vajzën 14 vjeçe. I ishte vrarë i shoqi në front, kishte dy djem të vegjël për të ushqyer. Për të rritur fëmijët, çfarë nuk bënte. Rreshteri e punonte përmatë.

Ushtarët as që e vunë re oficerin. Ai u largua më tej. Me opingat e llastikta shkeltë i menduar truallin e kishës duke kaluar si në revistë ushtarët. «Ja, ai i sëmuri, që fliste përçart. Fani po fle...» Oficeri u ndal dhe e nguli shikimin mbi fytyrën e shkrehur të ushtarit. Ajo fytyrë ishte mbuluar nga një cipë që piquej më shumë nën dritën e kandilit.

— Po fle? — pyeti Pietron pranë.

— Sikur e zuri gjumi.

Ai ushtar i rraskapitur, ajo qenie njerëzore e gjymtuar, u krudh e tëra brenda shikimit të oficerit. Dhe Xhino Roveli nuk shqitëj dot nga kjo pamje. I dukëj sikur një forcë e pabesueshme e kishte marrë atë ushtar dhe e kishte përplasur në këtë tokë të huaj. Dhe pjesët e njeriut ishin ishin shpërbërë, sikur të ishin pjesë të një makine të copëtuar.

— Ka shumë ditë kështu?

Unë kështu e gjeta.

— Ti i kujt je?

— I «Arexos» këtu? Kur kë ardhur?

— Kam tri dite.

Shikimet e tyre u kryqëzuan, të rënda e të menduara. Thua sikur të dy ata njerëz mendonin po një gjë. Dhe s'kishin nevojë për njëri-tjetrin. Diku, në thellësi të tyre ata dy burra e urrenin shoqi-shoqin. Pietroja, i shtrirë poshtë, pranë shokut të sëmurë, shihte qesëndisës oficerin, sikur donte të thoshte: «Edhe këtu ti na qenke oficer? Edhe tani...»

— Pse nuk ngrihesh?

— Më dhemb ngofja.)

Zëri që u përgjigj ishte i akullt. Ai zë sikur e shtyu oficerin prej vendit.

— A ka qenë e vërtetë?

— Çfarë?

— A ka qenë e vërtetë që kemi qenë aq të lumtur?

— Po flisnin përsëri ata të dy nga pas.

— Unë... gruaja... çupa... — thoshte ai tjetri. — Ti as që mund ta mendosh tani se ç'gëzim ka qenë për ty ajo llopë e vëtmë! Vërtet kemi qenë aq të lumtur?

Zëri sikur pyeste heshtjen e akullt të asaj kishe. Dhe muret, ikonat, njerëzit ishin të shurdhër. Pa veshë, pa gojë, E ushtari, si i lajthitur, nuk besonte; ai gërhiste në marramenthin e vetë «Vërtet, a kemi qenë aq të lumtur?»

Një tjetër flinte. Ishte mbështjellë kular përreth çantës. Oficeri u ndal pranë tij. S'po arrinte dot të kuptonte se si e kishë pushtuar

1) eshtrat e prapanicës së njëriut...





dicka të madhe, edhe kujtesën time.» Sigurisht, mendoi oficeri me vete. Po përse Barba thoshte «duhet të ketë qenë e tmerrshme», a mund të kishte ditë tjetër më të lemerishme se ajo? Nëse mund të kishte, si do të ishte ajo ditë?

- Ai kujtua pastaj se si Barba i kishte thënë: «Ngjarjet bëhen të frikshme vetëm pasi kalon njerëri kohe... Sepse vetëm atëherë njerëzit ua njohin fytyrën e vërtetë ngjarjeve që kanë jetuar.» «Po, — mendoi oficeri me vete, — sepse atëherë njerëzit i shohin ato prej lartësisë së ditëve të tjera: Të jetë vallë lartësi?» — pëshpëriti i përhumbur. Ai mbajti vesh. Askush s'pipërinte. Në kishë kishte pllakosur heshtja, e rëndë, ngjethëse.

Sërish në kokë i buisën fytyrat e kolegëve oficerë, pastaj trupat e tyre tek përpëliteshin të shpuar nga «Parabelët» gjermanë. Ai u përpoq ta shkëpuste mendjen prej andej dhe kujtoi ushtarin, që e kishin varrosur në kodër. Iu kujtua ajo fytyrë e verdhë, ajo mjekër si e blertë dhe fjalët e rëndit të tij: «Ndhimomë... Ndhimomë të jetoj...» I kishte dëgjuar vërtet ato fjalë? Kishin pëshpëritur ato buzë të vdekurës? Dhe Xhino Royeli i bënte sikur i dëgjonte edhe tani: «Ndhimomë... ndhimomë të jetoj...»

Ai ushtar i ngjante tmerrsisht Anxhelas... Befas në përfytyrimin e tij gëloi Luixhi. «Zoti oficer, — thoshte ai, duke treguar me kokë këpuçet e reja të të vdekurit... Ushtari zgjaste përpara këmbën e vet: — Nuk ka kuptim...»

Xhino Royeli u zgjua. Hapi sytë, u çua dhe i mbështolli të dy gjunjët me krahe. Nën dritën e zbehtë të kandilit, shikimi i tij ra mbi trupat e ushtarëve që flinin përtokë. Ç'e lidhte me këta njerëz? Fati i pënbashkët? Po, përse kishin ardhur deri këtu? I kishte sjellë deti... Mjaftonte që

të kujtonin detin dhe të shpitesonin me gjithë shpirt se mund të ktheheshin në Itali.

Oficeri mendonte se natën ata mund të dilnin në bregdet dhe të jepnin shenja me anë zjarresh. Anijet që mund të lundronin ardej patjetër që do t'i shihnin... Po ishulli? Atje tani duhej të ishin gjermanët... Me siguri e kishin pushtuar (se u bënte punë ai ishull i vetëm që zinte hyrjen e gjirit të detit. Po të ndiznit zjarre, këtu më parë do të vinin nazistët...)

Më mirë të vazhdonin udhën drejt veriut. Nga lindja nuk kishte asnjë kuptim. Po të shkonin drejt lindjes, do t'i largoheshin detit, që ishte e vetmja shpresë shpëtimi. Pastaj ai ligen i vërtetë kënetor, që shtrihej ardej, nuk mund të kapërcehej dot. Do të mbyteshin, s'do mend, se s'njihnin asnjë pëllembe të këtyre viseve.

Oficeri u ngrit. Te dera e ajodhimes kishte rënë përmbys Barba, i mbështjellë me kapotë. Kur oficeri iu afrua, Barba nisi të gërhiste. Gërhimja u përhap në gjithë kishën. Oficeri mendoi ta zgjonte, por nuk guxoi.

Jashtë shtu kishte pushtuar. Tani mbi catinë e ulët vrunduj-vrunduj kishte era. Juga, mendoi Xhino Roveli me vetë. Nisi juga. Ai u kthye te shtroja e vet. Atëherë pa së edhe këmishëziu ishte zgjuar.

Mua gjithnjë më del gjumi shpejt, pëshpëriti Ugoja duke u shtridur.

Bën shumë ftohtë.

Këtu nuk rihet më... tha Ugoja.

Oficeri ra prapë në shtrojën e vet.

Këtu nuk rihet më.

Këmishëziu u ngrit, ngulir bërrylin e majtë mbi tokë dhe ndenii në brinjë.

Zoti oficer... Unë e ti nuk duhet të vde-

sim këtuz. Këta të tjerët këtu do të ngordhin. E di unë. E dimë. Prandaj nuk i duroj dot. (Shikoji sinjanë bënë) si kafshë. Kafshë këmbë e kokës. U ka hyrë imëria. Fundërrinat... Gjithnjë kështu kanë qenë këta. Të cofur... Kurse unë e rridha. Ne... me jemi tjetër!...  
— Oficerin djeun pranë frymëmarrjen e shpeshtë të rreshterit që përzihet me murmurimën e ethshme të fjalëve të tij.

— Ne jemi tjetër, — thoshte Ugoja. — Këta, edhe sikur të kthehen, kufoma janë... E ç'i duhen Italisë këta? Që të ndotin edhe të tjerët atëj? Sa qindra e mijera kufoma të tilla enden sonte në këto ane? Mjerë ne, po u kthyen të tërë në token tonë! Po do të bëjmë me ta?

Oficerit nisen t'i kërcishin dhembët prej të ftohtit. Ai s'po i mbante dot më nofullat.

Dreq, — hungëroi, — sa ftohtë. — Dhe nuk po e kuptonte pse ato fiale të Ugos i kuituan të atin, kapitenin e bersalierëve, Xhankarlo Rovelin. Ky ishte një burrë truplartë me shoatulla të gjera, eshtake. Pati lindur në Romë e gjithë jetën kishte shërbyer në ushtri. Xhankarloja kishte dashur që edhe i biri të ndiqte karrierën ushtarake. «Xhino, — i thoshte shpesh Xhankarloja, — si oficer mund të bësh më shumë për madhështinë e shtetit italian...» Tani Ugo Bensi po e pyeste: «Përse i duhen Italisë këta?» — Dreq, — hungëroi përsëri Xhino Roveli, — sa ftohtë!...

— Që kur ju pashë, ju njoha: ne jemi tjetër. Ne kemi rënë, por nuk jemi shembur: kemi humbur, por nuk jemi mundur. Në fund të fundit, gjithçka mund të ndodhë, apo jo?

— Mund të ndodhë, — pëshpëriti me vete oficeri.

— Mund të ndodhë, — tha këmishëziu. —

Edhe xhaxhai im kështu thoshte. C'është e vërteta, më në diçka ndodhi... Po në nuk jemi mundur. Une e di... Kurë nuk do la besoj se fashizmi është mundur. As Italia fashiste, kemi rënë vërtet, po duhet të ngrihemi prapë. Më qejtoni, zoti oficer... duhet të ngrihemi.

Gjatë atyre ditëve Xhino Roveli kishte parë ushtarë që qanin, të tjerë që grindeshin, të tjerë që shaheshin. Por nuk kishte degjuar as një që të fuste kështu, si Ugoja. Mendoi ta pyeste se ç'ishte «xhaxhai» i tij, po pastaj ndërroi mendim. Të tjerët flinin dhe ai kishte shumë ftohtë. U ngrit e nisi të ecte lart e poshtë nëpër kishë. Me opinga llastiky në këmbë shkelte ndanë ushtarëve që flinin përtoqë. Tek capitej ashtu, iu kujtua dita e parë e zbarkimit të tyre në Shqipëri. *Motocikleta, makina, topa, dhe ushtarë... Ushtarë e oficerë. Një orzek i gjelbër helmetash e uniformash hynte në skelën e qytetit të Vlorës, e pastaj derdhej nëpër udhë e ngushta. Dukej sikur ato udhë do të përcisnin nga dyndja e asaj ushtrie poteremadhe.*

— E vlen, — i kishte thënë ai majorit, që ecte bri tij në kryesitë kolonës.

— E vlen...

*Majori kishte qeshur.*

Oficeri pa trupat e njerëzve, që kapërtheshin si hije në tokë. Ato hije sikur donin të futeshin thellë në dhë, të hynin diku nën të, po toka s'po i pranonte. I vetëm, Xhino Roveli ecte lart e poshtë dhe opingat i lllapashiteshin në pellgun me baltë.

Nga vendi i tij këmishëziu ndiqte me sy atë njeri që shkante para, mbrapa, djathtas, majtas... Dhe përsëri para, mbrapa... Dikush lëvizin. Ish-të Pietroja, ushtari që kishte vrarë ngofjen. Ofi-

ceri mendoi se ndoshta qe zgjuar, po Pietroja flinte. Fytyra mezi i shquhej ne gjysmeterrin e shen Triadhes. Oficeri e kundroi gjate, duke menduar se edhe ky ushtar mund te kishte qene diten e pare te zbakimit te tyre ne Shqipëri. E pse jo edhe ky ushtar... Ndërsa rreshteri i kemishëzinjve thoshte se «jemi tjetër ne...» Trupi i dridhej nga te ftohtet. Eci edhe një copë here lart e poshte neper kishë, kur papritur u gjend para ikonës. Sakaq ra ne gjunjë.

— Jezu... Perëndi... Ndhimona... Ndhimona... Kemi mbetur vetem... Fare vetem... Kurse atdheu, ja ku eshte... Ne qofte se je... — ai ia nguli syte syve te zbehte te shenjtit oriental qe qendronte mbi te. — Ne qofte se je... sot duhet te na ndihmosh. Si, ne qofte se je? O perëndi, kaq gjak i derdhun prej ushtarëve te tu, ende s'ke krijuar? Po edhe te mos kesh qene kurre, ti duhej te ishe ngjizur tani prej kaq dhimbjesh njerëzore. Tani ne jemi vetem. Ne dhe vdekja. Vdekja dhe ti. Te kemi ngjizur me gjakun tone, me luftërat tone, me vdekjen tone. Ndhimona tani, o perëndi!

Oficeri u ngriti. Ngadalë shkoi ne vendin e vet.

— Nesër do te nise mi, — i tha Ugos.

Kemishëziu sikur u clirua nga vetvetja.

— Me ne fund, — tha ai. — Zoti oficer, une ta thashe, ne s'jemi si keta, jemi tjetër ne...

4.

Duke ecur lart e poshte, oficeri u ndal ne një hop mbi Pietroni. Iu duk sikur ushtari po bente një gjumë te thelle te rende. Ai pa trupin e madh

shtrirë në tokë, xhaketën e zhubrosur, kapën pa shenjëza në krye. Ushtari u kthye menjëherë dhe oficeri u largua prej andej. — Në atë kohë Pietroja shihte endërr. — Ai sapo ishte kthyer në shtëpi prej asaj kishte vogël në të braktisur. Me moba të ndotura, me mjekër të parruar, këllirë në të, ai shkoi drejt e në kuzhinë ku e shoqja po lante të birin. Gruaja thirri nga habia dhe iu var te tëra në qafë të shoqit. Burri e përqafoi e i tha shkurt «lajë fëmijën» dhe shkoi e u ul në karrige. Pietroja kishte stre vjetër që kishte parë djalin. Kur ishte nisur në luftë kishte lënë motakë gjysmë. Tani fëmija ishte rritur, kishte hedhur shtat, shpatullat i qenë mbushur, flokët trezëzë të dendur i shndritnin. Ushtari nuk ia ndante sytë e përmalluar dhe gruaja, pa e fshirë mirë, ia lëshoi në prehër

— Është rritur, apo jo? — pyeti gruaja duke iu avitur pranë.

— Poo.

Ushtari shkoi dorën mbi kryet e butë e të njomë të fëmijës, i përkëdheli qafën e hollë, shpatullat, poshtë, më poshtë, ai diçka po kërkonte nëpër atë trupth të njomë.

— Dëgjo, — i thoshte Pietroja gjithë dhimbje së shoqes, — dëgjo.. — Atij po i merrej fryma, balli po i mbulohej me djersë. — Dëgjo, — thoshte zemërdredhur ai... — Këtë e di vetëm unë e askush tjetër. Osmanët nuk i marrin fëmijët e gjymtuar. Ushtari i allahut duhet të jetë i shëndetshëm e i fuqishëm. Ai duhet të pushtojë për sulltanin shtete e popuj, duhet të nënshtrojë njerëz. Këtë mua ma ka thënë në fshehtësi një bujk shqiptar...

— Lëre foshnjën!

Gruaja u lëshua mbijtë shoqin, por ajo ishte fare e vogël, (e pafuqishme, para atij mashkulli të huaj e të egërsuar.

— Ai shqiptari, — thoshtë Pietroja, — gjeti se ku mund të thyhet fosknjës këmba dhe ia theu...

Pietroja u dha me fuqi të dy duarve. Foshnja piskati. Ishte klithma e një qenieje që ndiente mbarimin (e) vet. Pastaj asgjë s'u dëgjua më.

Sytë e skërfitur të gruas hyninë mbijtë shoqin.

— Më mirë kështu, — i tha Pietroja asaj, duke mbajtur në duar foshnjën e gatit pa jetë.

Ushtarim e kishin mbuluar djersët dhe për ai merrej frymë. Gulçi po e mbyste. Më dorën e vet ai shtrëngonte ngofjen e varës.

— Fëmijë, — thoshtë Pietroja, —

— Fëmijë, — thoshtë Pietroja, —

— Fëmijë, — thoshtë Pietroja, —

— Fëmijë, — thoshtë Pietroja, —

— Fëmijë, — thoshtë Pietroja, —

— Fëmijë, — thoshtë Pietroja, —

— Fëmijë, — thoshtë Pietroja, —

— Fëmijë, — thoshtë Pietroja, —

— Fëmijë, — thoshtë Pietroja, —

— Fëmijë, — thoshtë Pietroja, —





— Po unë a jam Evropi? — pyeti sërish ai zëri i parë.

— Ti?

— Po... unë...

— Çfarë?

— A jam Evropi unë?

Ra një heshtje e thellë. Po mendohej ajo gjysmënatë. Dafina dallonte nëpër qiell siluetën e zezë të hijes së qiparisit mbi varrin e të atit.

— Nuk e di, — tha rëndë zëri tjetër, — po mund të jesh edhe ti... Evropi...

— Unë jam Drashovica.

— Oh, nënë, duro...

«Lefter Pavli, — murmuriti me vete Dafina.

— Ai është Lefter Pavli.»

— Duro, moj nënë Drashovicë, — u dëgjua përsëri zëri nëpër errësirë.

— Ka ardhur nencja nga ana e anës, po nuk po shpon dot lart. Partizanët luftojnë. Tetë ditë sot, luftë...

— Nga fshatrat e tjera po shkojnë vullnetarë në Drashovicë. Edhe nga Porua. Në ç'bëjmë?

— Ç'të bëjmë? — pyeti dikush.

— Atë që kemi bërë...

Dhe biseda u shua. Errësira sikur u dend. Diku, në një cep të qiellit, vetëtiu; bota u hap e tutje, pafundësia u drodhi. Dafina u çua...

— Ngrëhu, — i tha Lekës. — Shkojmë të flemë, ose nesër do të ngrihemi shpejt.

Në Drashovicë luftonte edhe Mihali. Çuçuriti zogu i natës. Ishte një zë i dhimbjes.

— Unë jam Drashovica, — erdhi sërish nga errësira zëri i Lefter Pavlit.

2. Kur u largua oficeri, Domeniko Barba e ndjeu veten të vetmuar. Pak nga pak e pushtoi zymtia ndjellazezë e shën Triadhës, lu kujtua gjerba e shiut që pikonte pa pushim në kishë dhe iu bë sikur edhe brenda tij po binte ai shi shtatori.

Barba nuk shpresonte që oficeri dhe ata të tjerët do të gjenin andej nga Veriu ndonjë shteg shpëtim. Ai nuk kishte më shpresë dhe disa herë matej t'juja thoshte edhe ushtarëve. «Po, shpresa është zoti,» dhe ai heshte. Ata le të shpresonin... Ndërsa oficeri i dhimbsej. Kishte bërë mirë oficeri që ishte larguar prej këndeje... Një shtëllungë ere fryu e qiparisi i vetëm që ngrihej në lëndinën e vogël kërciti gjatë. Barba ngriti kryet lart dhe pa nga qielli. Iu duk sikur ajo kërcitje gjerbonte nga gjithë trangu i atij qiparisi të moçëm. Barba e dëgjonte, e dëgjonte dhe vetiu shikimi i shkrihej në hapësirën e qiellit të ulët, të mbushur me re. Duke parë ashtu, atij papritmas iu kujtua qiparisi i seminarit... me atë zgavrën e thellë në trung. Kur binte shi, nëpër zgavër kulonin rrëkerat.

Atëherë sapo kishte mbushur 11 vjeç. E ëma i kishte vdekur nga zemra dhe i ati, një fshatar i varfër nga Leçja, ishte martuar me një grua tjetër. Njerka nuk e donte djalin e gjetur. Në bebëzat e fikura të Barbës diçka shndriti. Diku ai po e lidhte fillin e këputur atë ditë «Kur diçka e madhe duhej të kishte ngjarë.» I ati i kishte thënë: «Shko në seminar të sigurosh jetën.» Dhe ai kishte shkuar. Ashtu e mbante mend të atin, të kërrusur mdis qiparisave, tek e shpinte në seminar. Dhe nuk e kishte parë më.

Dy vjet më vonë kishte marrë një telegram nga njerka: «Babai vdiq.» Vetëm kaq. Seminarin e kishte mbaruar, por prift nuk ishte bërë. Nuk e shpjegonte dot as vetë përse. Kur e kishin pyetur vitin e fundit nëse dëshironte të bëhej prift, ai u ishte përgjigjur thjesht: «Jo.» E kishte kuptuar që zotë ishte futur i tëri brenda tij, por prift nuk dëshironte të bëhej. Arsimitar, ndoshta, po...

Kërr... Kërr... kërciti qiparisi mbi të. Me shpë-tullat m'pështetur tek ai trëng i vjetër, Barba ndiqte në qiell lëkundjen e majës së blertë. Një re fluturonte lart. Era e shtynte nga lindja. Barba e ndoqi me syllatë re, derisa li humbi prej shikimit. Kërr... kërr... gjerboi përsëri nga trëngu i qiparisit. Befas atij iu kujtua: «Kur vdiq ka-llogre Aleksandra, fshatarët i mbollën të kryet një qiparis të njomë. Kështu shkruhej në fle-toren e shën Triadhës... Ky duhet të jetë...»

Barba luajti prej vendit, eci disa hapja në përsheshin e vogël të mbuluar me bar e lë-myshkë e pastaj u ndal. Prej andej kundronte me vëmendje lëndinën, por nuk dalloi gjurmë varri.

Sigurisht që për këtë qiparis bëhet fjalë.

Mbi tokën e butë e gjysmëranorë të lëndinës, aty-këtu shiheshin rrëniët e mëdha, të ftohtëme e të mocme të qiparisit. Vende-vende gungat kafe në të zezë dilnin mbi tokë dhe pastaj fiteshin më thellë dheut. Ishte një dru i stërnla-kur. Vdekja e kallogresë duhet të ishte mosha e tij.

Ngjarjet që përshkruheshin në atë fletore ishin shumë të vjetra, por Barba e kuptonte së mur-giit orientale u jepnin atyre një petk më të mo-cëm nga ç'ishin në të vërtetë. Në seminar lai ki-shte vënë re se, sa më të lashtë bëheshin priftë-

rinjtë në të ecur, në të folur, në të menduar, aq më mistikë dukeshin në sytë e besnikëve të vet. Ai u kthye nga veriu e kërkoi me sy oficerin dhe dy ushtarët që ishin nisur për udhë. Ata nuk dukeshin më. Duke soditur horizontin e zbrazët, atij i erdhi në kokë mendimi se tani oficeri ishte për të shumë më i largët se ky qiparis i mbjellë te kryet e kallogresë së vdekur. U përpoq ta ndiqte me mend oficerin, por ai vetëm largohej, ndërsa ajo, kallogreja, i dëgjonte përpara e i afrohej përherë e më pranë.

Kërr... Kërr... kërciti qiparisi mbi të. Atë kërcitje Barba e ndiente nëpër gjithë qenien e vet, teksa oficeri e ushtarët që ishin nisur nga veriu largoheshin e largoheshin tutje. Dhe ai e kapi atë largim. Nëpër mjegullinë e arsyes së tij të troshitur Barba e kuptonte se dita që po jetonte, ishte më e largët e më pak e vërtetë, se ato ditë të lashta që kishte jetuar ajo, kallogre Aleksandra. Ky ishte i pari mendim që ai, më në fund, mundi të lidhte me ato fije gjykimi të këputura diku thellë tij.

— O Zot! Më në fund e lamë skëterrën. Oficeri e mori me mend se këmishëziu, që i vinte pas, e kishte fjalën për kishën. Edhe ai vetë ndihej i lehtësuar që u largua prej andej. Imde i dukej sikur era e lagësht e vajit dhe e qirinjve e ndiqte mbrapa. Nga deti fryu jugu i ngroh-të; dhe oficeri mori frymë thellë, por prapë i erdhi një sikundërmim qiriri e vaji.

Ishtë i uritur. S'kishte vënë gjë në gojë, veç asaj nafore, që e ndau me gjithë ushtarët. Oficeri ndjeu pas shpine hapat e Ugos, që rëndte.

— Mos bridh ashtu, — i tha pa e kthyer kryet. — Sot kemi për të ecur shumë.

— S'ka gjë, zoti oficer.

— Ndoshta do të udhëtojmë gjithë ditën.

— Mos u shqetëso, zoti oficer. Gjatë gjithë këtyre vjetëve, vetëm kam marshuar.

Oficeri deshi të kthehej pas e të shihte preshterin, po sakaq e ndjeu se ky i kishte ardhur përmbri.

— Ne do të arrijmë.

— Ku? —  
— Atje. — Ugoja qëndroi në vend, ngriti dorën e shënoi nga perëndimi. — Atje, — tha ai duke treguar hapësirën.

Oficeri u kthye nga ai. Këmishëzui po fliste për bregun tjetër të detit, sikur ta kishte aty, një çap larg. Ugoja gati sa nuk po i thoshte: «Oficeri im, besomëni mua, ne do ta kapërcejmë këtë hendek.» Oficeri qeshi.

— Ne do të kalojmë, zoti oficer.

— Patjetër.

Oficeri u kujtua se gjatë gjithë atyre ditëve nuk kishte qeshur.

— Jezu, — murmuriti, — të paktën nuk pas-  
kam harruar të qesh.

Luixhi vinte i lodhur pas tyre. Në mëngjes, kur oficeri i urdhëroi: «Nisemi!», ai deshi t'i përgjigjej: «Unë nuk vij dot, shkoni ju...» Dhe mendoi se për të, ndoshta, do të ishte më mirë të qëndronte atje në kishë, me ushtarët e tjerë. Le të ndodhte ç'të ndodhte. Le të ishte edhe fati i tij si fati i të tjerëve. Në atë kishë ushtarët vinin iknin dhe ndoshta ndonjë shpëtim kishte edhe atje. Po oficeri e urdhëroi: «Nisemi!» dhe ai u nis.

Tani po habitej tek i shikite ata të dy që bisedonin e qeshnin me gjithë shpirt. Duke u çapitur pas tyre, Luixhi po mendonte se ç'ë lidhte me atë oficer. Vërtet ishin të dy të regjimentit «Parma», por ata as ishin parë etas ishin njohur gjekundi. Qenë takuar rastësisht në atë peshqejllimin e luftës partizane, që ende vazhdonte në Drashovicë. Partizanët u thoshin Italianëve të çliruar të bashkoheshin me ta e të luftonin nazizmin. Kujt nuk kishte pallto i jepnin ato që kishin, atyre që ishin zbathur u dhanë nga opingat e veta. Edhe Xhino Rovelit i dhanë opinga bregase. Por natën shumë Italianë ishin larguar vjedhurazi nga radhët e partizanëve. Luixhi kishte shkuar pas oficerit, si edhe tani. Fytyra e gdhendur e Xhino Rovelit i ngjante një guri në fund të detit, që ruan gjurmët e valëve. Dukej sikur në atë fytyrë ishin ngurosur edhe ato ditë të përçjakshme që po jetonin.

Shpejto, — thirri oficeri.  
 Zeri i tij nuk kishte ndryshuar dhe ushtari e kuptoi se nuk mund t'i kundërshtonte dot.  
 — Nuk mundem, — tha, — nuk mundem.  
 Më dhëmbin këmbët.

Oficeri hodhi shikimin mbi këmbët gjysmë të zbathura të ushtarit. Traga fare e ngushtë gjarpëronte nëpër kallamishten e dendur. Sapo hidhnin dhjetë hapa, u dilte përpara një kthesë e, me të kaluar atë, një tjetër. Udhë rrëshqiste përpara si një zvarranik dhe Luixhi me këmbë të shembura, mezi shkelte mbi kurrizin e saj. Mishrat po i gjakoseshin. Ushtari futi dorën në xhepin e xhaketes. Gishtërinjtë i prekën cigaren e vetme. I dridheshin duart. Ishte ciganja e fundit. Tani nuk mund të duronte më. U ul ndanë udhës dhe e ndezi. Thithi tymin e duhanit dhe

nuk dëshironte ta nxirrte jashtë. Nuk donte. Ndihej si i babëzitur për atë tym.

— Ohe... eja! — dëgjoj zërin e Ugos, që e thirri.

Luixhi sakaq e fshehu nën pëllëmbë cigaren e ndezur.

— Ohe... po vjen, apo jo?

— Po vij...

Ai e thithi cigaren edhe një herë. Po nuk luajti prej vendit. Tymi i asaj cigareje po ia trazonte rropullitë. Pas pak iu bë sikur midis kyçeve të këmbëve e të duarve, nëpër mushkëritë dhe nën kafkë, po i nderej diçka çlodhëse prej qielli, prej deti dhe ato gjymtyrë, të kapitura sikur po i çliroheshin nga njëra-tjetra. Gjithçka bëhej e lehtë në trupin e Luixhit. Ai u ngrit.

— Ohe... thirri duke vënë duart hinkë rreth gojës.

Zëri ishte fare i shuar. Duke dëgjuar zërin e vet, ai mendoi se aty përreth kurrkush s'do ta dëgjonte dot, por u shtang kur ndjeu këmishëziun t'i përgjigjej. Luixhi përshkoi kthesën dhe i pa ata të dy që ishin ndalur në mes të udhës. Ushitari mendoi se mos shokët po e prisnin dhe u shkoi pranë. Te këmbët e tyre ai pa me ullahtarë mbeturinat e një njeriu.

— Çakejtë...

— Çakejtë? — pyeti i tmerruar Luixhi.

— Çakejtë.

Luixhi s'mund ta shihte dot atë pamje të neveritshme e megjithatë sytë i shkolin gjithnjë atje. Vende-vende eshtrat ishin ende të mbuluar me pejza mishi të shprishur. Përhapej një grahmë mbytëse. Pa e kuptuar Luixhi po sillej rreth skeletit, kur i pa në qafë një medalion.

— Ushtar, — tha me një fije zëri, — ushtar si ne...



E mori medaljonin në dorë. «Xhirolamo Alberto, 41, artileria, Firenze». Të tjerët nuk po luanin prej vendit.

— Ky ka udhëtuar natën, — tha Ugoja. — Ka qenë vetëm.

— Ndoshta... vetëm... — tha oficeri.

— Dhe natën, — përsëdyti këmishëzuiu.

— Ndoshta.

Oficeri e kuptoi që rreshteri donte të vazhonte udhëtimin. Edhe ai vetë nuk dëshironte të ktheheshin mbrapa. Shën Triadha nuk premtonte asgjë të mirë për ata ushtarë të humbur. Po para syve i kishte mbire një cofinë njeriu e shqyer nga bishpat.

— Më mirë në kishë, të paktën atje jemi midis nesh, — tha Luixhi.

Ugoja pa oficerin në sy.

— Zoti oficer — tha ai, — ne, të dy...

Xhino Roveli si shqiste dot sytë nga ato eshtra njerëzore të shkapërdërdhura përtokë. Ndërkohë ai dëgjonte dy ushtarët që bisedonin.

— Nuk ka kuptim...

— Hesht, idiot!

— Hëm...

— Po të duash, eja me ne, po të duash, kthehu.

— Unë kam ardhur me oficerin.

— Në djall të vesh! Surratpatate. Të zuri tmerri ty? Ç'e pandehe ti, fushë me lule? Fshatar-gdhel.

— Ohe... fashist!

— T'i theva turinjtë! — iu kanos Ugoja ushtarit.

— Nisemi...

Ai që një vendim i atypëratyshëm e askush s'pati kohë të mendonte. Ushtarët u nisën. Gjithnjë përpara, drejt veriut. Traga e ngushtë e

përdredhur, i çonte thellë asaj kallamishteje të shkretë e të pënjohur. Luixhi ecte: i fundit dhe prapë grindej me vete: përse drejtin nuk e kundërshtonte dot Xhino Rovelin.

Ugoja u këthye nga ai:  
— Luaji, — thirri gjithë zemërim, — luaji ato këmbë të thara.

Luixhi mbante në dorë medalionin e gjetur. Lexoi edhe një herë: «Xhirolamo Alberto...». Vetiu pastaj kërkoi e preku në qafë medalionin e vet. Ai do t'i çonte në Itali, edhe medalionin e vet edhe atë të ushtarit të prerë prej bishavé në atë shkretëtirë. Sepse e dinte: për të afërmit e shtëpisë, tu çojë këtë medalion, ishte njëloj sikur t'u kishte shpënë trupin e të vdekurit...

— Po në qoftë se... — i regëtiu në kokë mendimi, — ... po në qoftë se edhe unë...

Ushtari ecte nëpër kallamishte dhe ndiente nën këmbë tokën që po qullej gjithnjë e më shumë.

— Me dy medalione? Dy medalione... Aherë, mua, të vdekur, për cilin mund të më marrin?

Luixhi u këthye dhe nisi të fugonte nëpër lathë udhë, nga kishte ardhur deri aty. Shputat e këmbëve i përplaseshin mbi gunga e rrënjë kallamash. Po ato udhë shtërëngonte në grushte medalionin dhe gulçonte duke u larguar gjithnjë e më shumë prej atyre të dyve që vazhdonin të udhëtonin drejt veriut.

— Gabove, zoti oficer... — dhe aty për aty shtoi: — Gabova. Dy medalione...

Më në fund, u gjend sërish një çap lang atij skeleti të shkapërderdhur, për tokë. Luixhi e flakë ku medalionin që kishte në dorë. Një hop mendoi të kthehej pas, por menjëherë u ul në nis të gërryente dheun. Hapi një gropë të vogël dhe e mbuloi aty medalionin.

\*

• •

Oficeri e këmishëziu nuk shiheshin gjëkund. Luixhi thirri disa herë, por kurrkush nuk iu përgjigj. Atëherë nisi përsëri të futojë. Vëshillima e erës shkrihej me zhurmen e trupit të tij që shkiste nëpër kallamishte. Gjethja shpatuke e kallamit i ra fytyrës. Ushitari shau nëpër dhembë.

— Ohe, zoti oficer, ohe.

Pëmpara u nde hapësira kënetore me atë ngjyrën e pjekur, të ngjëlber e mavin. Ajo shkrihej prej këmbëve të tij e derisa hante syrin e njeriut. Toka ishte e mbuluar me të mëmshkë të butë, e të kripur. Ushitari kishte humbur udhën. E prapë vazhonte të ecte. Këmbët iu krodhën në baltë. Zemra po ia shkallomonte kraharorin e ngushtë, iu morën mendtë. Mendoi të ulej e të çlodhej, po nuk kishte se ku. Gjithkund ishte kënetë.

— Zoti togeeer... zooti togeeer.

Asnjë përgjigje.

Disa pika të mëdha shiu, i ranë me fytyrë. Luixhi po çante kënetën duke ndehur përparë kraharorin e ngushtë. U lëkund, këmbët iu zhytën në baltë. Bëri disa hapa mëtej dhe ra. Trupi iu përplas në çelaz, e me duart nëpër llucë, u zuri të ngrihej. Nuk mundte. Duke u përpëlitur ashtu dora diç i kapi një send të vogël, të lëvizshëm. E mbërtheu. Ai sendi donte t'i rrëshqiste, po u shë

tari nuk e lëshonte. Duke u llapashitur, u ngrit në këmbë. Lau dorën në syprinën e ujit.

O zot, — murmuriti, — o zot..

I vetëm, në mes të kënetës, nisi të kapërdinte bretkosën e vogël.

#### 4.

«Që ta dini ju që vini pas dhe të tjerët që do të vijnë pas jush, unë shërbëtori i perëndisë, atë Nikodhimi, i biri i Kristo Gurit nga katundi i Grykëpishës, me ndihmën e zotit tonë Jezu Krishit, po hedh këto fjalë këtu që të mbeten dhe qoftë mallkuar ai që i shkretton këto fjalë. Erdhën osmanët në fshatin tonë e i prenë gjithë ullinjët, hardhitë i prenë e i shkulën nga rrënjët e dukej sikur tokën e perëndisë e kishin kafshuar lubitë e skëterrës. Gratë duke qarë i merrnin në duar rrënjët e hardhive, si të ishin koka të prera fëmijesh dhe, që ta dini ju, ajo bishë që pëgëri dheun tonë në vitin 1610, quhej Kara-Melçq-Derëber-pasha. I humbte shpirtit»

Faqja tjetër nuk lexohej dot, Barba mbylli fletoren e vjetër, fërkoj sytë e lidhur e pa nga dritarja e ajodhimës hapësirën e gjerë kënetore që humbte nëpër mjegullën e dendur vjeshitake. «Të harrosh, murmuriti ai duke kërkuar me sy, tej mjegullës, hijen e maleve përkundrejt. Dhe ai po harronte. Dalëngadalë e ndiente se si po iktë e shkrihej ai vetë me atë mjegull, me ato male që treteshin tej në horizontin e paarrtshëm. Dorë-dorës po harronte kishën e vogël, ushtarët, oficerin, edhe qiparisin, edhe radhuan e vjetër të kodikut kishtar. Po harronte vetën.

5. Asaj nate kryeplaku i fshatit Kodërdet nuk mbylli dot sy. Nuk e zinte që nuk e zinte gjumi. Piu çaj mali, piu edhe rignon të zier. Syri i ishte bërë filxhan. Në kokë i ngriheshin e i përplasheshin mendime të errëta. Lufta e kishte ndihmuar zotin Milo që të shtonte kamjen. Tani ai kishte mbi 400 rrënjë ullinj, 4 vreshta e 37 dynymë arë buke. Megjithëse fshati nuk kishte shumë vend për kullotë, kopeja e dhenve i kishin kaluar 150 krerët. Edhe lopët i qenë shtuar. Qenë shtuar edhe këndesët prej floriri që zoti Milo i hiqte mënjanë. E shoqja kishte pasur bark të mbare. Ajo i kishte bërë atij 3 djem të shëndetshëm e dy vajza «si djem». Të madhen, Lolën, e kishte martuar në qytet. Ai mendonte që në qytet të hapte edhe një tregtorë ku të shiste verë, raki e vaj ulliri.

Ç'e sjell ora, s'e sjell moti.  
Musolini ia bëri mirë atij kopukut, Ahmet Zogut, që i vuri dorën dhe e përzuri nga Shqipëria. Ai malok e kishte për fis të shiste vetëm bozë e salep dhe nuk ishte për të qeverisur vendin. Kurse Musolini hapte për shqiptarët Evropën. Dhe Evropa blinte ç'të kishë: edhe mishin, edhe lëshin, edhe lëkurën. Ushtarët e Musolinit qenë si mizat e dheut. Nga një sapllak verë të pinin dhe qesja mbushesh. Verën mund ta pagëzoje gjysmëpërgjysmë me ujë, italianët e gjojnë e pinin e nuk bënin zë. Ata ngordhnin për një kokërr vezë. Shtëpi më shtëpi trokisnin e kërkonin «uova». Po një vezë ishte gjysmë leku. Pula pillte para e jo vezë. E ç'iu desh Duçe kokëmadhit që e nisi luftën me inglizin? Këtë zoti Milo Ndreu nuk mund t'ia

falte kurrë buzëtrashit të Romës. Ehu, Çibuku<sup>1)</sup>... Dhelpra plakë! Për Milo Ndreun që jetonte në brigjet lindore të Adriatikut, «Çibuku» ishte një hap matanë Duçes, hop e mu në det! Po Çibuku i luante fatet e botës si tespihe. Ç'është e vërtetë, tani i luan edhe Mustaqja<sup>2)</sup>... Phuuu!

Kryeplakun sikur e shkundi një dorë e huaj. Ai u ngrit nga dysheku dhe shkoi e hapi dritarën. Jashtë binte shi.

— Derdh, o perëndi, bëje tënden...

Ai bëri kryq, megjithëse ishte tërë mllef edhe kundër perëndisë. Me sa dukej edhe perëndia ishte kurdisur keq kundër tij. Ndezi cigaren, hodhi pallton e kadifenjtë krahëve dhe u mbështet të pezuli i dritarës.

Punë e madhe se ra ai buzëviçi i Italisë, Mussolini, po të mos kishte rënë vetë Italia, të paktën. Të mos kishte rënë Italia. Tani Miloja, e shokët e tij mbetën mes katër udhëve e s'dinin nga t'ia mbanin. Fshatarët ishin zberthyer e s'donin të dëgjonin më njeri. Qeveri nuk kishte. Gjermanët vërtet kishin ardhur, ata edhe po luftonin, siç thoshin, po ku ishte qeveria? Ky popull e do xhandarin të koka. Dhe jo xhandar sidokudo, po xhandar Mustafën, që gojën e kishte me dhëmbë plumbi dhe plumbat e nagantat i mbante në brez të shpërvielë si dhëmbët e gojës. Thujat e të duash, po Salepçiu xhandarmërinë e kishte të fortë. Kurrizin e shqipos e nihte mirë. Vetëm kërbaci e zbut atë. Bythëgrisurit!

Shtëpitë e fshatit, nën shi, sikur platiteshin e ngjanin më të vogla. Dëgjohej aty-këtu ndonjë e

1) Cërçilli

2) Stalini.

lehur qeni, apo pëllitje gomari. Edhe Ziushi i Milos palli poshtë në ahur. Ajo pëllitje e përmendi kryeplakun që kishte rënë në të thella. E shoqja i soli kafënë e mëngjesit dhe ai e ftoi në t'i ulej pranë. Ajo ishte një grua e gjatë, e hijshme dhe vishej përherë në të zeza. Zoti Milo e vështroi gjatë në sy, sikur po zbulonte në të diçka të re, që nuk e kishte parë deri atëherë. Po gruaja tha:

— Të janë fryrë qeskat e syve, Milo. Shumë po mendon.

— Më zien koka si kazan rakisë. Si do vejë ky halli ynë, moj grua?

Gruaja nuk u përgjigj.

— U zhvidhos vendi. Fshatarët nuk dëgjojnë e nuk duan të dinë më as kryeplak e as pari. Tërmet!

— Ku? — tha gruaja e çuditur.

Ku? Kur? Ai nuk donte ta thoshte, por s'u përmbajti dot:

— Gruaja po grua, leshgjatë e mendjeshkurtër. Ky është tërmet, gruaaa... Të rinjtë bëjnë me kokën e tyre. Sa më shumë t'i trazosh, aq më shumë harbohen. Edhe prifti i fshatit është shthurur fare. Nuk e fal më kishën, thotë. Nuk paguajnë fshatarët. Fshatarët vërtet s'apin në dhietëshe. As për kishën. Kaq e kaq foshnja nuk janë pagëzuar! «S'kemi lekë për atë Thanasin, thonë. Ne mezi po mbajmë shpirtin tonë».

— S'i ngre dot ti në këmbë qeveritë. Shiko qunën, tënde, more burrë, se malli do të zotin te koka. — tha gruaja prerë.

I shodri e kuptoi që gruaja kishte të drejtë, por ai i hodhi asai një shikim të akullt. Ashtu ishte. Milo Ndreu s'i ngrinte dot në këmbë qeveritë që binin si fiqtë e kalbur nga degët. Po të mundte, ai do të bënte gjithçka. Tani e falte edhe gjysmën

e pasurisë së vet vetëm ta sillte prapë në Tiranë Zogun. Po ç'po bëjnë të tjerët, xhanëm? Si nuk i doli për zot një burrë këtij vendi? Vetë kryeplaku kishte bërë ç'ishte e mundur që ta mbante fshatin e tij «fashitë luftës».

— S'na duhen neve ato... Jemi njerëz fukarenjë duam të rritim çiliminjtë, u thoshte ai fshatarëve.

Kryeplaku e dinte shumë mirë që, po t'i për-mëndje fshatarit «çiliminjtë», ai bëhej pulë, i urtë, i dëgjuar, i pafuqishëm, ashtu si fëmija. Po komunistët hynin në çdo shtëpi, si ato shpirtrat që bredhin e i trazojnë mendjet dhe zemrat e njerëzve.

Gruaja u ngrit.

— Bushtra e shpejtë i pjell këlyshet të verbër, Milo. I duruari, i trashëguari, — tha ajo dhe e zuri të shoqin prej dorë që ta përkëdhelte.

Burri pa nga dritarja. Shiu bënte rrëke.

— Derdh, o zot, bëje tënden... — tha ai gjithë mllef.

— O unë u çmënda, o bota u marros! — thirrri oficeri duke kthyer Luixhin që kishte rënë përmbys në mesin e udhës.

— Ky është, apo jo? — Ky është, apo jo? — Ky është, apo jo?

— Humba udhën!

— Pastaj?

— Në kënetë ka bretkosa.

— Kuj?

— Ugoja kërceu përpara.

— Në kënetë ai paka! po kaja...



Këmishëziu rëndi andej. Duke u llapashitur nëpër ligatinë, ai u largua prej atyre të dyve. Oficeri u ul pranë Luixhit. Kishte ecur pa pushuar që kur ishin nisur atë mëngjes nga kisha.

— Si e humbe udhën?

— E humba, — tha ushtari e nuk foli më.

Xhino Roveli po e mundaonte uria, një uri e eger gërryese. Atje në kishë, kur pati marrë në duar atë copë nafore, dhe kishte nisur ta ndante në pjesë të pabarabarta, e kishte ndier se si po i dridhej gjithë trupi. Atë copë bukë ai do t'ia kishte zhvatur nga goja edhe vetë shenjtit të ikonës, sikur të mos kishin qenë ato hije njerëzore, që shtrinin drejt tij duart e uritura. Sytë e tyre përpeliteshin si ato duar: «bukë». Dhe ai e ndau i qetë e me një pamje shpërfillëse. Kishte ngrënë apo jo, njësoj ishte për të.

Oficeri priti se mos këmishëziu kthehej tek ai, po Ugoja qëndronte në vend, atje mes baltovinës duke thirrur e duke i bërë shenjë... Oficeri u ngriti. Ushtari po e thërriste dhe ai kishte një uri që mund ta bënte të qante. Hyri në kënetë dhe u drejtua nga Ugoja. Këmbët sakaoq iu krodhën në baltë. Oficeri shau opingat e llastikta, që mezi shkuleshin prej fundit të ligatines.

— Zoti oficer... kerko nëpër rrenjë, të thirri këmishëziu kur Xhino Roveli iu afrua. — Një vetëm një, — tha pastaj me vete këmishëziu.

Oficeri qëndroi në këmbë në mes të baltës e qeplazit.

— Shën Meri... një, vetëm një...

Gjatë atyre ditëve Xhino Roveli e kishte mbytur si me dorë urinë. «Një, vetëm një... O shën Meri...» erdhi përsëri deri te veshët e tij lutja e Ugos. Mendimi se edhe ai, më në fund, mund të hante diçka, sikur ia fashiti atë dhimbje urie. Nisi edhe vetë të kerkonte nëpër ujë e rrënjët e zhukave.

Kalonte nga një vend në tjetrin, binte në llucë e ngrihej përsëri. Dhe gjithnjë ashtu. Gjithnjë ashtu. Këmishëziu ngriti dorën në ajër.

— Zoti oficer... — tha ai, — Dy... dy...

Oficeri rendi atje. Ushtari i zgjati dorën.

— Një ju, një unë...

Nisën të gjuanin të tjera. Shkonin nga njëri vend në tjetrin, nga njëra rrënjë zhuke te tjetra. Ugoja i mbyllte kafshët e vogla në gavetën që kishte lidhur te rripi. U ulën mbi një kaçubë zhukash. Me këmbët kredhur në baltë zunë të kapërdinin bretkosat.

— Ne do të arrijmë, besomëni mua, — tha Ugoja. — Do të arrijmë. Fashizmi nuk ka vdekur, fashizmi s'ka për të vdekur kurrë. Sa të hidhemi andej. Nuk besoni? Ju asnjëherë nuk na keni besuar deri në fund, — tha Këmishëziu. — Prandaj e pësua kështu... E lamë vetëm Musolinin...

Ai mbështeti kokën gjithë leshra, të zeza kokorithka midis grushteve dhe pa në sy Xhino Rovelin.

— Më vjen për të qarë, — tha Ugoja, — më vjen për të qarë, kur mendoj se si e braktisën Italia mezi e bëri. — Këtë shprehje ai e kishte dëgjuar nga të tjerët.

— Lëri këto fjalë tani! — i tha Këmishëziut oficieri duke tundur dorën në ajër. — Lëri!

— Ja, — tha Ugoja, — kështu jeni ju, të gjithë. Nuk besoni, prandaj ai mbeti vetëm.

— Kush, Musolini?

— Musolini ynë... Të gjithë e braktisën.

Xhino Roveli u drodh. Pa e kuptuar edhe vetë, ndjeu se po i kërcisnin nofullat. Sytë po i çapëlesheshin. Një copë herë qëndroi ashtu, i varur mbi yete.

— Po në kush na braktisi, — tha, — Musolini? Bado dioja? Italia? Italia nuk mund ta brakt

tisë vetveten, ashtu si unë, toger Xhino Roveli, nuk mund ta braktis veten time. Po kush jam unë, në fund të fundit? Flas me ty tani dhe para syve më dalin kolegët e mi oficerë... I pushkantuan gjermanët në një përrua. Ç'vdekje!... U shpëtova nëpër duar... Këtë xhaketë, këto llastika, m'i dha një fshatar shqiptar. Po ku ishte Musolini, kur ata... E ç'ta zgjas kot... Unë ikam shërbyer dhe do t'i shërbej Italisë, deri në fund... Kaq di të them... Edhe këtu, tani.

Këmishëziu i hodhi një shikim mospërfillës e i tha ftohtë:

— Ju e mohuat njeriun më të madh të kohës sonë, prandaj po e paguajmë tani. Po ne të dy duhet të rrojmë. Të kthehemi prapë e të lajmë turpin tonë. Dhe ta shohin ata andej... Vetëm të kthehem edhe një herë, — tha ai pastaj.

Këmishëziu u ngrit. Pas tij u çua edhe oficeri.

— Ne do të arrijmë, — tha përsëri rreshteri. — Unë, zoti oficer, s'kam për të vdekur këtu.

## V

1:

— Ç'të kam bërë unë ty? — pyeste kryeplaku Lefter Pavlin e hidhte shikimin mbi katundarët që pinin verë në tregtoren e fshatit. Ata dëgjonin bisedën e të dy burrave, pinin dhe qeshnin nën buzë.

— Kur kam unë, ke edhe ti, — tha kryeplaku. — Ja, ti vjen e më kërkon një gotë verë dhe unë ta jap. Po të mos kem unë, as ti nuk ke. Ç'të keqe ke parë ti, Lefter, prej meje?

— Hesape të ngatërruara këto, o Milo... Po, jeta ty, ama, vaj të ka shkuar!

— Puno, Lefter, puno. Si gjithë robtë e perëndisë.

Kryeplaku fliste pa kthyer kryet nga Lefter Pavli, që ishte ulur i vetëm në tryezën te qoshku pranë banakut. Fshatari kishte shtrirë dy këmbë

bët e z bathurë nën tryezë, kishte nxjerrë përpara gjoksin, e fryrë leshtor e rrotullonte në duar gotën e verës. Ai pinte i kënaqur.

— Të mora hyzmeqar, — tha kryeplaku, — po ti nuk doje të lëvizje as krahët, as këmbët. Vetëm dhëmbët punoje mirë.

— Ashtu është.

— Të vura bekshi të fshatit, shkove e vodhe i pari rrushin e Dimo Vllahut.

— E vodha.

— Të vura kishar, hëngre meshët dhe e rrahe atë Thanasin.

— Atë Thanasi i rka dhëmbët të kalbur. Ai mund të hajë vetëm meshë me verë, — tha xha Llambroja.

— Atë Thanasi më mësoi edhe mua, — tha Lefter Pavli. — Dhe ke parë ti që më bënte mirë ajo mesha... Po prifti s'më jepte farësendi.

— Dhe ti e rrahe, — tha Dimo Vllahu. — Hajde kokë!

— Perëndia dëshmitar në kam vënë dorë... S'di unë ç'bënte druri... Dora ime kurrë, për atë zot që është një!...

— Po sikur të të shkrepë t'i rrëmbesh ullinjtë zotit Milo? Mirëpo ky s't'i jep, se janë të tijtë... Ç'do të bësh, O Lefter? Do rrrokësh drurin! — foli sërish Llambroja.

Lefter Pavli ngriti të dyja duart lart:

— Më zure ngushtë. Për besë unë nuk dua! Po ja që këto s'më binden, i urdhëron dialli...

— Lëri ato! — tha kryeplaku i mëritur. — E kishim te prifti...

— Pse s'i thua ti, t'i hante ai mjekërcjapi meshët?

— ...Nuk e di unë atë punë. Shko e zgjidhe vetë me të... Unë ç'të bëj me ty?

— Asgjë. Ç'mund të bësh ti me mua? Ato

që thua ti janë fjalë të vërteta. Po edhe ti, Milo, nuk punon. Pastaj, edhe ti vjedh. Ato tokat belike ti i vodhe i pari.

— Ama të bëra edhe ty me vresht!

— Më bëre... thua? Një perëndi e di! Po mua nuk më shkon jeta vaj, si ty... Po, të të pyes, o Milo, a dëgjove gjë? Po vjen Mustaqja më duket...

— Cili Mustaqe, more? — pyeti kryeplaku sikur s'kuptoi.

Por tani ai u kthye dhe e pa drejt e në sy, i urtë e dashamirës, fshatarin.

— Xha Stalua,<sup>1)</sup> — bubulloi zëri i Lefter Pavlit.

Fshatarët qeshën. Qeshi edhe zoti Milo.

Lefter Pavli doli nga tregtorja duke mbajtur në dorë shatin si ndonjë kërrabë. Iu ngjit së për-pjetës dhe zuri ta rrotullonte atë kërcu shat sa andej-këndeje. Shiu kishte pushuar. Me hapa të mëdhenj, zbathur, fshatari shkelte në tokën e lagur. Ishte bujku më i fikur i fshatit. Kur kishte parë të tjerët që zaptonin tokat belike, edhe ai kishte hapur një copë vresht mu në kulm të kodrës.

Lefter Pavli nuk kishte fëmijë. Kishte vetëm gruan dhe ajo e shtyu të hante atë copë vresht. «Do ta shihni se si do ta bëjë Lefteri.» — u thoshte ai vetë fshatarëve. Po dheu ishte fare i hollë dhe hardhitë as zgjatëshin e as trasheshin.

---

1) Stalini

Lefter Pavli mendoi të shkonte nga vreshti e të pastronte ferrat e njoma që kishin hipur në ledh e po ngatërroheshin rrënjëve të hardhive. Sapo doli majë kodrës, hodhi sytë poshtë dhe pa shtëpinë e Pon Dukës. Këmbët po e çonin andej. Duke ecur, fshatari thirri që ta dëgjonin të gjithë:

— Nuk punohet sot, jooo... Nuk është ditë pune kjo...

Thirrjes së tij iu përgjigjën bujqit që ishin përhapur nëpër arat e vreshtat rreth e rrotull.

— U lodhe, Lefter, mjaft më.

— Të ranë krahët, a i zi.

— Pse e rropat veten, Lefter. ti je më i lumturi i botës, një gojë ke për të mbajtur.

— Kam edhe atë të gruas.

— Pse, kalama është ajo? — Ajo që foli ishte grua.

— Nuk punohet sot. Dafinë. — i tha Lefter Pavli gruas që ishte futur në arë zhathur. Këndhur në baltë. ajo po pastronte hendekun për të kulluar tokën.

— Mbrëmë ra shumë shi. — murruriti si me vete Dafina. — Moti është prapë i rënduar. Shiu po vjen vërdallë. A thua do të bjerë prapë, xha Lefter?

Ai heshtte i menduar.

— Misri erdhi i mirë sivjet. Shvqvr! Të hatë populli. Se populli. Dafinë, është si bagëtia, po s'pati c'të haië, ngordh.

Lefter Pavli u ul pranë saj, në tokë. Dafina nuk e la punën.

— Pse punon ti? Ngrihesh që në mëngjes e krijdesh këtu, mes ujërave dhe baltës? Që të mos ngordhësh...

— Ashtu është. — tundi kokën Dafina.

— Njeriu ngordh më keq se bagëtia, Se, në

fund të fundit, ajo një dorë bar do, kurse shpirti i njeriut është grykës... Shpirti i njeriut i do të gjitha, Dafinë, — tha Lefter Pavli.

— I do.

— Shpirti i njeriut do bukën, po do edhe verën. Verën ia zhvata sot kryeplakut. Do shpirti, Dafinë, ma do dhe një kafe të fortë, nuk do ma pjekësh?

— Ah?!

Sytë e mëdhenj e të kaltër të Dafinës u hapën gjithë dritë dhe një buzëqeshje e lehtë fluturoi nëpër buzët e saj. Ajo kokë e plakur, e mbuluar me ato leshra të thinjura e të pakrehura, ajo fytyrë e zeshkët dhe e rrudhur, ajo xhakëtë gjithë arna që gati i binte nga trupi, ato këmbë të zbatthura, të plasaritura e të ndotura me baltë, gjithnjë i kujtonin Dafinës të atin, Ndre Davidin. Lefter Pavli e Ndre Davidi patën qenë shokë fëmijërije. Dy njerëz, po një fat. Dhe fati i tyre kishte qenë i rëndë, i mjerë. Argat te njëri e te tjetri, shatin këtu e kazmën atje. Për një çopë bukë. Pas vdekjes së të shocës Ndre Davidi ishte bërë baba e nënë për të dy fëmijët jetimë. Pikëllimi e kishte thyer në mes. Dhe ishte plakur përnjëherësh. Tani Dafina shihte ato këmbë të zgjeruara të Lefter Pavlit e i kujtoheshin mbrëmjet, kur i ati vinte i lodhur e gjithë baltë nga puna dhe ajo ia lante këmbët me ujë të ngrohtë... «Kështu e ka kjo botë...» — i thoshte shpesh e si duke psherëtirë Ndre Davidi.

Tani babai kishte mbetur një kujtim, ndërsa Lefter Pavli ishte aty. Me gjithë pleqërinë e varfërinë, ai ishte ende i fuqishëm dhe Dafina i gëzohej që e shihte ashtu.

— Do ta pimë një kafe, Dafinë?



Zëri i Lefter Pavlit ishte i përvuajtur. Ai zë që një orë më parë tingëllonte i ndërkryer atje në tregtoresh e fshatit. Tani plaku ishte lëshuar, ishte mekur. Ata hynë në shtëpinë e Pon Dukës. Lefter Pavli shkoi e u ul ndanë vatrës. Dhe vetë, me dorën e tij, shkrepiti urët e ullirit.

— Më vjen për të qarë, — tha Lefter Pavli dhe sytë vërtet iu rrëmbushën me lot. — Si rron njeriu kështu? Barkun zbrazët, shalët lakurige, këmbët e zathura... Ja, shih mua. Edhe unë e shoh veten time... E shoh, kështu si më shëh ti. Dhe më këputet shpirti. Më këputet shpirti, kur e shoh në këtë ditë halli Lefter Pavlin. Pse njeri është ky? Po qe ky njeri, aherë ç'është kafsha? Kafsha s'ka gojë që të flasë, se mos ka Lefter Pavli... Më vjen për të qarë për veten... Për tët atë, Ndreun...

Ai heshti. U mendua një kohë të gjatë.

— Jetë, — tha pastaj dhe pështyu mbi zjarr.

— Jo, jetë... gërdallë!

Lefter Pavli pa nga Dafina që, me xhezven në dorë, po qante heshturazi. Lotët i pikonin nga sytë e i rridhnin nëpër faqe, deri poshtë te buzët.

— Po ty të mos të vijë keq, moj çupë! — i thirri asaj Lefter Pavli. — Të mos të vijë keq as për mua, as për tët atë. S'ka gjë. Njeriu një jetë do të ketë. Ne patëm fatin tonë. Zoti Milo pastë të tijin. Këtu do të jemi e do të shohim. Lefter Pavli do të rrojë... Edhe po s'e mbërrita atë ditë, përsëri do të shoh, moj... që andej, moj... — dhe ai ngriti dorën e djathtë dhe shënoi me gisht varrezat e fshatit. — Që andej do të shoh se

ç'bëhet në Kodërdet. Ti pandeh se Ndreu nuk sheh? Aq sheh, sa... Kështu e ka kjo botë...

Lefter Pavli rrufti lëngun e ngruhtë të kafesë. Hodhi sytë rreth e qark nëpër odë, po nuk i nguli gjëkund. Nuk i rrihej në një vend. Donde të bënte diçka, por s'dinte se çfarë. Duke bredhur shikimin ashtu, ai tha me zë të lartë:

— Nënë, moj Drashovicë! A do të kesh aq gjak sa ta mbytësh edhe nëmën?

2

Lufta e Drashovicës kishte ditë që po vazhdonte. Ajo ishte një luftë e ashpër. Komanda partizane synonte të hidhte në dorë depot e mëdha të municioneve që kishte ngritur atje ushtria fashiste italiane qysh nga Lufta Italo-Greke. Pastaj ajo donte të çlironte mijëra ushtarë italianë që nazistët i kishin mbyllur në një kamp përqendrimit, poshtë në fushë të Mavrovës. Po të merrnin Drashovicën, partizanët do ta kishin më të lehtë sulmin për të çliruar Vlorën. Ndërsa gjermanët donin t'i siguronin mirë forcat që kishin në qytet. Drashovica i lidhte me Tepelenën e Gjirokastrën. Pastaj, Drashovica ishte e para betejë e madhe e nazistëve kundër partizanëve shqiptarë. Ushtria e hekurt e Rajhut të Tretë donte t'i thyente edhe psikologjikisht partizanët.

Fronti i luftës, që niste nga Lubonja e Penkova poshtë, zgjatej deri lart në Lapardha si ndonjë gjarpër i zjarrtë, herë duke e tkurrur, herë duke e lëshuar trupin e vet. Nazisti që një natë më parë ishte ngrysur në fushën e Mavrovës gdhë-

hej të nesërmen në fushë të Xhyhërinës. Fronti i luftimeve zvarritej e lëvizte, por prapë mbetej atje, maidis grykave të atyre maleve.

### 3.

Një zjarr i egër armësh e kishte përflakur hapësirën tejmbanë. Partizanët sulmonin drejt urës së Drashovicës. Hija e saj nxinte. Xhelo Lapi e pa veten në xhade duke u sulur përpara, kur një zjarr i dendur mitralozash ia preu rrugën. Dy autoblanda gjermane sapo ishin futur në urë e po vinin drejt tyre.

— Në kanal! — urdhëroi Xhelo Lapi. — Shtrihuni në kanal!

Partizanët ranë atje përmbi njëri-tjetrin. Duke vjellë zjarr nga mitralozat, të dy autoblandat nisën të kositnin kodrat përballë. Fortinot naziste, sidomos ajo më e madhja, që ndodhej pranë urës në krah të majtë, villnin zjarr me tri gryka mitralozash njëherësh. Më keq s'kishte se si! Vetëm 6 a 7 partizanë kishin mbërritur te kanali. Të sulmoje autoblandat, ishte marrëzi. Ajrin e grinin predhat e mortajave dhe plumbat që vinin nga të gjitha anët. As që mund ta nxirrje kryet jashtë. Autoblandat venin e vinin, xhadesë që lidhte rrëzat e Kropishtit, urën, fushën e Mavrovës.

— Mos u ndieni. Këtu nuk na ha plumbi... Pushoni pak. Unë do të marr një sy gjumë...

Me të vërtetë koka e Xhelo Lapi u këput dhe ai u mbështet te buza e kanalit të udhës.

— Ç'je ti, more! More qen e bir i qenit!

Na fute në çark dhe tani na thënke se dashke të flesh... Po ti paske qenë... — Dhe ai i dha një të sharë vendçe.

Ishte një fshatar që sapo ishte bashkuar me atë grusht partizanësh. Xhelo Lapi në fillim i dëgjo copëra-copëra ato sharje, pastaj ëmbël-sia e gjumit i pushtoi kockat, gjithë trupin, gjithë qenien.

— Ai ka disa ditë e net pa gjumë, — i tha Mihali fshatarit.

— Këtu e gjetj të flerë?

Vetëm disa metra larg tyre autobлиндat gjermane përflaknin dheun.

Në gjithë frontin e Drashovicës luftohej furishëm. Nazistët mbaheshin ende qenërisht. Kompania e Xhelo Lapi ishte futur sërish në luftime. Partizanët, që mbrëmë ishin ndodhur befasisht pranë noçkave të autobлиндave gjermane. e kishin kapërcyer më në fund xhadenë dhe i ishin ngjitur përsëri së përpjetës së Përroit të Krophishtit. Një skuadër po sulmonte prapë ballë Urës dhe fortesës kryesore. Partizanët zbritën poshtë në rrëzë të kodrës dhe dolën në një lëndinëz, ku dikur ushtarët italianë loznin futboll. Dielli shndriti majat e maleve e të kodrave. Nië breshëri e papritur plumbash e thërrmoi tokën nënër këmbët e partizanëve. I kishin parë. Tani çëllonin drejt mbi ta. Duke shkuar përpara. Xhelo Lapi hyri në nië përrua. Skuadra e parë vranoi pas tij. Mitraljerët armiq përgjionin cdo lëvizje të tyre dhe kositnin më breshëri fletët e rrapeve që u binin mbi kokë. Partizanëve u doli për-

para një urë e vogël që kullonte ujërat e xhadesë. Skuadra u struk atje.

— Këtu nuk të ha plumbi.

U rrasën njëri pas tjetrit. Gulçonin rëndë. Ajrit fluturonin fishkëllimat ngjethëse të plumbave. Tanimë ishin mësuar me ato fishkëllima, por e dinin se çdonjëra prej tyre mund të ishte vdekje. Xhelo Lapi i numëroi me sy: ishin gjithsej 7 veta. Edhe një mitraljer.

— Ti do të rrish gjithnjë pranë meje, — i tha Xhelo Lapi atij.

E donte me vete. Sido që të ndodhte, një mitraloz i duhej skuadrës. Gjermanët qëllonin pa pushuar dhe ishte e pamundur të ngrije sadopak kryet. Xhelo Lapi pyeti partizanët:

— Pse kemi ardhur këtu?

Pyetja ishte fare e thjeshtë, po dikush kërkoi të gjente diçka më të thellë në atë fjalë që tha komandanti.

— Të luftojmë, — u përgjigj.

— Të luftojmë... — përsëriti Xhelo Lapi me zë të ulët. — E shihni atë fortesë gjermane atje?

Dukej që ai diçka bluante në kokë, por çfarë?

— Po morëm fortinon, kemi bërë punë.

— A i sulemi të dy?

Xhelo Lapi pa në sy Mihalin, Çezare Rokon, atë tjetrin që foli. Atë nuk e njihte. Ishte një partizan i ri. Të ishte ky që e shante mbrëmë natën nëpër errësirë, kur atë po e kaplonte lodhja e gjumit? Nuk i besohej. Partizani, veshur me një xhakëtë të hollë gri, me këpucë gjysma, dukej fare i qetë. Duhej të ishte nga qyteti. Xhelo Lapi u çua ngadalë dhe nxori pakëz kryet të shih-te. Një breshëri plumbash u përplas para tij. E mbuloi pluhuri i zajeve dhe i zhurishtës.

— E vranë!

Ai u ngjesh përsëri pas urës së vogël duke fshirë fytyrën. Ishte gërvishtur ca.

— Nuk kam gje, — tha. — Vetëm zall më hodhi fytyrës e barkut.

Në anen tjetër të lumit, dalloheshin me sy partizanet që luftonin. Dëgjoheshin zërat që i thërrisnin njëri-tjetrit. Xhelo Lapi ndjeu aty pranë Mihalin që çoç po i thoshte Cezare Rokos.

— Çfarë i thua Italianit? — pyeti.

— I them që ne luftojmë për një botë të re.

— Po ai çfarë thotë?

— Nuk beson. Është vështirë, thotë.

Xhelo Lapi buzëqeshi më vete. I erdhi mirë që italiani nuk besonte lehtë. Ëh, fshatari është skile.. — murmuriti. — S'beson lehtë...»

— Po ti a ia shkoqite se ç'do të thotë «botë e re»?

— Ia shkoqita, — tha Mihali. — Botë pa padronë. — Partizani ashtu e shqiptoi, «padron,» sepse e dinte që Xhelo Lapi i vinte mirë kur e dëgjonte atë fjalë.

— Po a ia shkoqite se ç'është padroni, more? Padron është ai që ka gjithë atë tokë dhe ti s'ke... Padron është ai që ka tufa dhensh dhe ti s'ke... Padron është ai që ka koçekët mbushur me grurë dhe ti s'ke bukë... Shkoqitja kështu si të them unë, Mihal.

Në tjetër vend Mihali do të qeshte, por jo aty. Pastaj, dreqi e merrte vesh se nga maund të rrokullisej mendja djallushe e Xhelo Lapi. Mihali po i fliste Cezare Rokos.

— Unë e di, — tha i menduar Xhelo Lapi, — kur shes një padron edhe ti atje në Itali, zemra të mbushet vrer dhe të vjen t'ia hash gurmazin... Apo s'je fshatar ti? Botë e re do të thotë t'a shkulësh nga toka padronin, ashtu si shkul gjembaçin.

— Janë shumë! — foli i ndezur Çezare Rokoja. Tani italiani, edhe pse përkthente Mihalin, bisedonte vetë me Xhelo Lapi. Ata merrnin vesh më mirë me njëri-tjetrin.

— Kush të tha se janë pak, më shumë i pa-lëpirë! Shumë janë dhe mbajnë njëri-tjetrin si gurët e ledhit. Po sikur ne, që s'kemi tokë, as pagëti, as bukë, të bashkohemi nga jemi a s'jem, ashtu si ata, të mbajmë edhe ne njëri-tjetrin, cili gardh bëhet më i madh?

Xhelo Lapi i pëlqeu mendimi i vet. Bebëzat iu ndezën dhe ai pa me bisht të syrit Mihalin, po në çast u platis. «Mos e bëra përshesh? — mendoi me vete. — Për «botën e re» këta komisarët dinë më shumë dhe flasin më bukur.» Atij iu kujtua kur e kishte dëgjuar për herë të parë atë fjalë. «Botë e re...», sesi i ishte dukur.

— Bota e re është bota jonë. Më kupton? Pa padronë., Vendçe, thuaja, Mihal. Fshatarçe. Se sado ta ketë kokën të trashë e t'ia ketë llokoçitur Duçja, ashtu të merr vesh më mirë. Ka ca gjëra që i kupton edhe filozofi, edhe gomari.

Kur Mihali i tha italianit ç'kishte për t'i thënë, Xhelo Lapi, pa u kthyer andej, e pyeti:

— Pse, o Mihal, edhe këta «padron» i thënkani?

— Kjo është fjalë e tyre... Ne nga këta e kemi marrë.

Xhelo Lapi përdrodi buzët. Nuk i erdhi mirë që fjalën «padron» e paskëshim marrë nga të huajt. Donte ta pyeste Mihalin se ç'kuptim kishin, në të vërtetë, në gjuhën e tyre ajo fjalë. Por nuk e dha veten. Fundja aq i bënte.

Duke hapur zjarr, Xhelo Lapi e kaloi skuadrën partizane drejt urës. Pas pak ata iu afruan lumit të Shushicës. Bregu ishte i mbuluar me rrape. Atje Xhelo Lapi u tha partizanëve të hidhnin lurrën e të sulmonin fortesën përballë.

— Si do të kalojmë?

— Këmbëve të urës, — tha prerë komandanti. — Lumi nuk është i thellë.

Papritmas u hodhën në sulm. Më në fund arritën te një kube dhe pastaj te çezma ndanë udhës. Por, sapo dolën atje, plumbat e mitralozëve gjermanë u dërdhën njëherësh mbi ta. Breshëria ishte e paprerë dhe partizanët gjithë sa ishin, mbroheshin vetëm pas asaj çezme të betontë.

— Dy veta, — tha Xhelo Lapi. — Po të hedhim nga një granatë brenda fortinos, vriten gjithë nazistët. Po i duhet hedhur në grykë mitralozit.

— Ashtu të bëhet!

Xhelo Lapi u shtang. As vetë nuk e kuptoi se si i erdhi në kokë mendimi: «Nuk qenkam vetëm unë... edhe këta qenkan gati të vdesin si unë...» Dhe i erdhi turp. Vështroi një hop shokët. Ata pritnin të heshtur fjalën e tij. Ai brofi në këmbë. U nis vetëm të kapërcente lumin. Uji ishte i cekët, po i shkisinin zajat nën këmbë dhe ai desh ra. Rrotull ziente lufta. Shumëkush po e ndiqte me sy atë partizan të vetëm që, me ujët deri në gju, po kalonte tani Shushicën. Xhelo Lapi doli në zallishtë dhe hyri në rrjedhën e dytë, po, sapo hodhi këtë, e shënuan. Kapa i fluturoi tutje dhe pushka në anën tjetër. U përplas përtokë.



— E vranë!

Dëgjoi si nëpër tym shokët nga bregu. Ai vu-ri dorën në kokën që i digjte. I përcëlloi lëkura dhe gishtërinjtë iu njomën me gjak. Plumbi i kishte çjerrë lëkurën e kokës.

— Shpëtova paq.

Ishte gjallë. Dhe ishte i gëzuar. Mitralozi nazist qëllonte egërsisht, po plumbat tani iknin larg. Xhelo Lapi e kuptoi se atje poshtë, shtrirë në shtrat të lumit, plumbi i fortinos nuk e hante dot. U tërhoq barkazi dhe, ashtu siç ishte, nisi të rrëmihte zallishtën. Pas një copë here kishte mbaruar punë. Tani gropa që kishte hapur e mbronte mirë. Ishte fare pranë urës. Aty pranë ishte edhe ajo çerdhe e egër e mitralozëve gjermanë. Dëgjonte sokëllimat e gjermanëve dhe të partizanëve, por vetë s'mund të pipëtinte. Do të priste natën që të dilte prej andej: ndoshta, pas muzgut të mbrëmjes, para se të dilte hëna mbi male. Atëherë do të kishte më pak dritë dhe armiku mund të mos e diktonte.

Një shpërthim i befasishtëm tundi tokën e qiellin. Në atë hop Xhelo Lapi nuk e kuptoi se ç'po ndodhte. Po predhat e dendura të topave plasnin të dy brigjeve të lumit. Ishte artilleria gjermane. Një gjëmim skëterre. Nuk dëgjohej gjë tjetër veç atij gjëmimi shurdhues.

Gjermanët e kishin sjellë artilerinë në Sherishtë.

Xhelo Lapi mbante vesh dhe krismat e mitralozave tani i dukeshin si këngë mëllenjash. E merrte me mend se ç'po ndodhte tani atje prapa, mendonte për shokët, po s'mund të bënte dot asgjë. Ishte futur i gjallë në atë gropë si varr, disa metra larg grykës së mitralozit armik.

U dëgjuan kërkëllima të rënda, pastaj gjëmime mortajash. Mbi urë po kalonin autobлиндat e tan-

ket gjermane. Pas tankeve, disa hapa larg njëri-tjetrit, vinin ushtarët nazistë.

4.

Xhelo Lapi ia kishte ngulur sytë urës mbi lumë, por tani nuk i shihte më hijet e ushtarëve nazistë që kalonin aty, mbi kokën e tij. E kishin pllakosur mendimet dhe nuk i ndiente as rrapëllimat shurdhuese të autobлиндave, as krismat e armëve.

*S'kishte kaluar ende muaji, vetëm disa ditë para se të vinin gjermanët në Shqipëri, kur fashistët italianë ishin vërsulur me tërbim kundër partizanëve... Lufta te Pylli i Pëllumbave kishte qenë e egër. Në atë luginë të ngushtë midis maleve të thepisura, pas çdo trangu lisi, ishte armiku. Që në të aguar pylli kishte gjëmuar nga pushkët, mitralozat dhe bombat e dorës. Shtigjeve, ngado të kaloje, të zinte syri të vrarë.*

*Ishte vështirë të mbaje ndërlidhjen. Papritur, aty nga mesdita, ra heshtja, e thellë, e zymtë. Tani dy skuadrat partizane lëviznin ngadalë dhe pa zhurmë nëpër pyll: nuk duhej pritur nata për të dalë nga rrethimi. Tek çapiteshin heshturazi njëri pas tjetrit, Xhelo Lapit i zuri veshi një si gulçimë të mbytur. Nja dhjetë çape para tij tre partizanë po përlesheshin trup me trup me disa italianë. Këmishëzinjtë u kishin ngritur pusi. Tani pushkët nuk vlenin më, por thikat.*

— Mbi ta! — sokëlliu sa i hante zëri Xhelo Lapit dhe u sul flakërimë. — Tërëni qentë!

*Një hop ai pa Mihalin dhe Sotirin që u der-*

dhën me klithma përpara. Pastaj, papritmas, Xhelo Lapi u shemb përdhe nën një peshë të rëndë që mend po e mbyste. Një bersalier trupmadh i ishte hedhur përsipër. Aty për aty ia mbërtheu të dyja duart bersalierit dhe, sakaq, e qëlloi, me sa fuqi kishte, mes këmbëve, me gjurin e djathtë. Pastaj e shtrëngoi fort për gryke dhe ia përplasi kryet pas një trangu lisi. Kur Xheloja tërhoqi thikën për herë të fundit, bersalieri nuk përpëlitej më.

U ngrit, por, tek matej të kapërcente të vrrarin, një shkrepimë e beftë e verboi. Ai e ndjeu se po fluturonte në erë. Duke rënë, iu bë sikur anash tij po fluturonin drurët dhe një pirq dheu i lartë.

Celi sytë e u gjend në një gropë të hapur nga predha e mortajës. Ishte i mbuluar me dhë i tërri. Peshë po ia merrte frymën. Bëri të lëvizte. Atëherë dëgjoji sipër vetes ca zëra që iu dukën të huaj.

— «E hëngre, Xhelo,» — ishte mendimi i parë që i erdhi në kokë. Mezi mblodhi gjymtyrët e u zvarrit pakëz këmbadoras. Pastaj ngriti kokën dhe vështroi përçark. Ca degë lisash, të këputura nga predhat, kishin mbuluar shtegun aty pranë. S'dëgjohej gjë veç fërfërimës së gjetheve. Po muqej. Një copë herë mbajti vesh. Asgjë. Sa kohë kishte ndenjor ashtu, brenda asaj grope? Befas ndjeu t'i dridheshin duart, pastaj i gjithë trupi. Brinjët i dhembnin fort dhe mezi mbushej me frymë. «Mos të erdhi fundi, Xhelo?» — belbëzoi me vete. Dëgjoji vrapa një zhurmë. Dikush çapitej ngadalë. Ktheu kryet dhe pa një ari të madh të murrmë, që po kalonte anës grovës duke hungëruar mbytazi. Tutje, atje kul shtegu, humbiste mes drurëve, egërstra rrokullisi me shputa trupin e një bersalieri dhe u largua. Xhelo Lapi nuk ia shqiste sytë. Ai u ngrit, u shkund dhe e ndoqi.

pas ariun. Udhët e atij pylli bisha me siguri du-  
hej t'i dinte më mirë se njeriu.

5.

— Si këmishëzinjtë tha Mihali. — Njëlloj  
si këmishëzinjtë...

— Çfarë? — pyeti partizani pranë.

— Njëlloj si këmishëzinjtë, vetëm se aherë  
ishim tek Ura e Gjormit e tani nazistët po sul-  
mojnë tek ura e Drashovicës. Aherë sulmonin  
milicët italianë, mizëri... mbulonin dheun, ulëri-  
nin, e suleshin drejt nesh... E kam para syve edhe  
tani se si u plas mbi urë kapiteni këmishëzi...

Partizani i vogël u ngrit e u rras në brinjë  
të Mihalit. Të mbrojtur nga hendeku i xhadesë  
ata qëllonin mbi gjermanët.

— Pionier, kujdes veten. Këtu nuk të ruan  
dot njeri. Ç'më ngrihesh ashtu? Mëso të ruash  
veten. I sheh nazistët se si ndahen atje të gry-  
ka e urës e nuk futen grumbull në të? Shikoji  
oficerët se si u shkojnë prapa ushtarëve me «Pa-  
rabela» në dorë. Ata i tremben urës së ngushtë.  
Këmishëzinjtë tek ura e Gjormit ulërinin e sule-  
shin përparë, ndërsa këta qenkan të heshtur e të  
ngrirë.

Partizani i vogël ngriti kryet, por dora e  
Mihalit u shtri dhe pëllëmba e tij e mbuloi ka-  
pën e pionierit.

— Ul kryet.

Fishkëllima ngjethëse e plumbave preu aj-  
rin.

— Na qëllojnë prej bunkerit matanë.

— Mua? — ia bëri pionieri.

— Ty dhe mua. Duhet të largohemi prej këndej. Tërhiqur praptazi. Ashtu, eja pas meje. I sheh? Ata vazhdojnë të shtien gjithnjë... Unë e ti do të ecim më përpara, tek ai ledhi i vogël buzë arës. Atje jemi edhe më afër urës...

Duke u zvarritur ata u mbuluan në djersë e mezi merrnin frymë.

— Edhe pak...

Mihali kapërceu përnjëherësh përtej. Ai shkoi e u fut nën ledhin prej gurësh të asaj arë të vogël ndanë lumit. Dhe nisi të qëllonte me pushkën e gjatë mbi nazistët që gjithmonë e më shumë dyndeshin te gryka e urës.

Ndjeu pranë tij frymëmarrjen si të një zogu të partizanit të vogël.

— Erdhe?

— Erdha.

Një flakë e rrumbullt përflaku shikimin e Mihalit. Një si verbim e pastaj era e athët e tymit të barutit. Një gjëimim i mabytur i një krisme gati te rrëza e veshit.

— Na verbove me atë topçiun tënd! Shëno mirë e qëllo rrallë. Dhe në trup. Këtu nazistët dallohen më mirë. Shikoji si janë dhe mës i harro kurrë. Duan të na trembin, prandaj ecin ashtu, të heshtur e të ngrirë. Tek ura e Gjormit oficerët e këmishëzinjve shkonin përpara ushtarëve dhe u jepnin zemër. Eh, kam parë edhe nga ata që i mabanin bajonetat e shkërtra ndër dhëmbë...

Një predhë topi plasi mu në mes të xhadesë, pranë tyre.

— Të tëmë... — shau kësaj radhe partizani i vogël.

Kur Mihali kishte pyetur se cili nga ata ishte kuzhinier, te 28 ushtarët e çirruar italianë, që po rrinin rreth një vidhi të shkurter me gunga, kishin ngritur duart lart.

— Kuzhinier! — kishte thirrur prapë Mihali.  
— Kush është kuzhinier?

Dhe përsëri duart e italianëve, sikur të ishin degë mollësh të etura për dritë dhe fjalët e atij partizani dielli që ato prisnin, kishin feshferitur e, njëherësh, ishin ngritur tufë drejt qrellit.

— Ju gatuat një Duçe e jo të mos zieni një kazan arapash, — pëshpëriti duke qeshur partizani.

Ai shkoi dhe hyri midis tyre e nisi t'i vërente me kujdes. U ndal para një djali të ri.

— Ti!

Italiani u ngrit në këmbë. Ishte i shkurtër, me një trup të ngjeshur dhe këmbë të harkuara si të malësorëve të Jugut. Partizani e pa gjatë, pastaj i tha ngadalë:

— Nga je?

— Nga Sicilia.

— Si të quajnë?

— Çezare...

— Si?

— Roko... Çezare Roko...

— Ti do të vish kuzhinier në kompaninë tonë.

Mihali i kishte vënë kurrizin gardhit të vreshtit, kishte nxjerrë nga çanta librin e po lexonte. Ndriste një diell i ëmbël vjeshte, po dita ish-

te e freskët dhe partizani u krodh përnjëherësh në rreshtat e librit. Ishte mësuar me plasjen e predhave dhe fluturimin e aeroplanëve gjermanë. Befas veshët i zunë një zhurmë hapash. Dikush vinte drejt tij. Ngriti kryet dhe pa. Ishte italiani. Me duar, të lëshuara poshtë, i tytrë te parruar, ai u ndal i heshtur para partizanit.

— Ç'ke, o Çezar?

— Nuk bëhet arapashi, — tha italiani.

Partizani e peshoi me sy njeriun e vogël që i rrinte përballë.

— Si nuk bëhet?

— Intendenti më dha pak miell. Këtë kemi, tha, për gjithë kompaninë. Po arapashi nuk bëhet.

— Pse?

Italiani nuk u ndie.

— Pse nuk bëhet? — tha prapë Mihali.

Italiani diç belbëzoi. Ai sikur nuk donte të fliste, po pastaj tha me një fije zëri:

— Unë nuk jam kuzhinier..

— Si nuk je kuzhinier?

— Doja të vija me ju, po nuk jam kuzhinier. Jam berber. I hodha miellit ujë që të shtohet, po ai u bë lëng...

Italiani qe pikur fare nga dëshpërimi. Me sytë gjysmë të mbyllur, ai nuk lëvizte nga vendi.

— Kam frikë nga Xhelo Lapi, — tha pastaj.

— Ti më paske gënjyer, more Çezar! Hëm, — shfryu Mihali dhe pa këmbët e shtrembra e kokën katrore me gunga të italianit... Si fshatarët tanë, mendoj me vete. «Ç'të duhej ty gënjeshtër, more Çezar...»

## VI

### 1.

«Agostiiin... Agoostiiin...» Ai po dëgjonte zërin e nënës, kur ndjeu në ajër një përplasje që e trembi. Një pulëbardhë mend e çiku me krahë. Pas asaj edhe një tjetër. Shpendët loznin në ajër, uleshin gati mbi kryet e Agostinit, pastaj ngriheshin sërish fluturim duke lënë prapa një vazhdë klithmash të bardha.

Fëmijëria. Agostinit iu kujtuan pulëbardhat e Venecies së tij. O perëndi! I njëjti det. E njëjta valë. I njëjti qiell që mban përsipër po ato pulëbardha. Një guaskë deti i mbiu përpara syve. Dhe iu bë sikur ajo guaskë e vogël, e papërfillshme, ajo hiçgjë, e futi në gjirin e saj. Papritmas guaska ishte bërë lundër që çante drejt brigjeve të Venecies.

Agostini do të shkelte mbi tokën e fëmijërisë po me atë lehtësi që çante tani këtë det. Nuk



donte asgjë tjetër, ashtu si qindra, mijëra, si miliona të tjerë, veçse të shtrihej në shtratin e vogël, në cepin e dhomës së vet dhe të merrte e të lexonte një libër. Të ëndërronte derisa t'i mbylleshin sytë e libri t'i shpëtonte vetiu nga duart. Dhe ai të flinte. Sa mirë është të flesh. Të flesh. Të flesh. Atje në shën Triadhë ai nuk flinte dot. Tani po kalonte pragun e shtëpisë, po përqafonte nënën e shkurtër topolake, po e ngrinte në qafë, duke i pëshpëritur «mos u shqetëso kurrë për mua». Dhe shkonte drejt e në shtrat. E shikonte veten me atë libër në dorë... O perëndi! Po pse kështu? Pse vetëm kështu?... Uh, kjo guaskë e vogël deti. Ai e mori, e hapi dhe rrufiti mishin, ujin, rërën e kripur. Sa gjëra të vockla, fare të vockla, i duhen njeriut. Era e ngrohtë e kuzhinës, bie fjala, që është e përzier me erën e nënës... Po edhe zëri i saj... Kush nuk e kujton nënën brenda mureve të shtëpisë? Të hapësh një dritare të dhomës. Dhe përsëri të flesh, të ndiesh nëpër gjumë librin që të rrëshqet prej duarve. O perëndi! «Agoostiiin... Agoostiiin...» — sërish zëri i nënës...

Pulëbardha u çua e, duke shtrirë krahët, fluturoi njësh me bregun. Shpendi po zvogëlohej gjithnjë e më shumë në hapësirën e vrenjtur të detit dhe s'u pa më. Humbi nëpër shkumët e valëve. Ushtari u ngrit e po qëndronte në këmbë, kur pa një pulëbardhë tjetër që u ul mbi shkëmb pranë tij. Dhe nisi të lozte me erën. Teksa Agostini po e shikonte i harruar, një krah shpendi çau ajrin mbi kryet e tij. Pulëbardha tjetër erdhi e u ul te shoqja. Tani të dyja po loznin me erën.

Agostini qeshi. Pa zë, po qeshi.

— O perëndi! Sa të bukura që janë!..

Ushtari i shkurtër kreu flokët, fërkoj fytyrën, shtriu këmbët para e nisi të fshinte këpucët me një leckë.

— Ti ke qenë në Libi? — pyeti Pietroja.

— Po.

Ushtari i vogël u përgjigj pa kthyer krahët. Ai nuk donte të bisedonte, po, derisa e pyesnin, do të përgjigjej. Që kur kishte ardhur në kishë, ai kishte zënë një vend te muri e nuk përzihej me njeri. Rrinte mënjanë, i heshtur e me sytë të pïcërruar. Si një dhelpër e trembur përgjonte jetën e asaj kishë.

— Po në Abisini ke qenë? — pyeti Pietroja.

— Jo.

— Sa vjet ke në ushtri?

— Katër.

— Ke shkuar ndonjëherë në shtëpi?

— Një herë. Para dy vjetësh.

Ushtari i vogël fshinte këpucët.

— Sa veta ke vrarë?

Ai nuk u përgjigj. As e ndërpreu punën e vet. Fshinte këpucët i qetë. «Njerëz si ky janë kriminelë të rëndomtë të kësaj lufte.» — mendoi Pietroja me vete.

— Nuk ke vrarë asnjë?

Ai tjetri shau nëpër dhëmbë dhe prapë vazhdoi të fshinte këpucët. Kishte një fytyrë të zbehtë që drita e kandilit të kishës e zverdhonte më tepër. Ballin e ngushtë ia çanin ca rrudha të thella. Herë pas herë drita e kandilit lëpihej nëpër ato rrudha.

— Eh, lufta... — psherëtiu Pietroja... Eh, lufta... — «Këta njerëz janë më të rrezikshmit, — mendonte ai. — Tek i sheh ashtu, me atë trup të

vockël, të duken fare të pafuqishëm. Thuase mund t'i shkelësh me këmbë, si milingonat. Edhe ata vetë sikur e dinë e të thonë: «Ç'ke me mua? Lermë të paktën të jetoj... derisa erdha në jetë... Ç'të bëj unë? Të jetoj të paktën...»

Ushtari i vogël sodiste fytyrëzbehtë këpucët e fshira.

— Eh, lufta... — tha përsëri nëpër dhëmbë ushtari me ngofjen e sëmure — Këta tipa, me atë qetësi që pestrojnë tani këpucët, përdorin karabinën kur ua vënë në dorë.

— Ti je sëmure? — pyeti papritur ushtari i vogël. — Keq do ta kesh...

Pietroja nuk dinte ç'ti përgjigjej. Në fund të fundit ai njeri kishte thënë të vërtetën: nga gjithë ata që ndodheshin në kishë, Pietroja e Marioja ishin më të sëmuret.

— Sa vjeç je?

— 43, — tha me zë të shtruar ushtari i vogël.

— Gruan duhet ta kesh të bukur, ëh?

Ushtari i vogël bëri sikur s'e dëgjoi, sikur ato fjalë të mos kishin arritur fare deri tek ai.

— Të bukur, ëh... Të mjerat gra... — tha ushtari i sëmure me një zë ngacmues.

Po njeriu i vogël ishte aq i ngulur në qetësinë e vet, sa Pietroja ndjeu një zemërim të brendshëm.

— Çfarë, nuk të kujtohet gruaja?

Ushtari i vogël u kthye menjëherë nga i sëmuri.

— Si s'më kujtohet? — tha ai i habitur.

— Ah, të kujtohet...

— Si nuk më kujtohet, — tha prapë ai dhe mbështolli gjunjët me krahë. Pastaj mbështeti kryet mbi ta.

— Eh, të kujtohet...

Atëherë ushtari lëshoi gjunjët, hodhi dorën në xhepin e brendshëm të xhaketës dhe nxori nga portofoli një fotografi.

— Ja, — tha...

Pietroja nuk lëvizi nga vendi.

— Nuk mundem.

— Më fal...

Ushtari i shkurtër u çua. Ai shkoi vetë te shoku i sëmurë.

— Ja, — tha, duke i zgjatur fotografinë.

Nga fotografia Pietron e shikonte një grua e re. Vështrimi i saj ishte i kthjellët e i lehtë.

— Po kjo qenka si engjëll...

Fytyra e zbehtë e njeriut të shkurtër u çel e u mbush me një dritë gëzimi. «Edhe ky njeri maund të mbakësh një copëz dielli brenda vetes,» — mendoi Pietroja.

— Atëherë ti duhet të vlesh diçka.

— S'të kuptoj...

— Ne jemi italianë e derisa një femër e tillë të do... domethënë se ti vlen diçka, — tha më tepër me vete ushtari i sëmurë duke vrenjtur vetullat e zeza mbi ballin e gjerë. — Kjo fytyrë engjëjllore më trishtuaka... — dhe Pietroja ia ktheu fotografinë.

Ushtari i shkurtër e mori dhe e kundroi një copë herë. Pastaj ngadalë e futi fotografinë në portofol. Ai u kthye në vendin e vet, mbështolli gjunjët me krahë dhe u tulat.

«Ç't'i ketë pëlqyer ajo këtij njeriu?» — tha me vete i sëmuri.

— Ç'gjë e trishtuar! — shtoi pas pak duke psherëtirë.

Dhe u habit kur dëgjoi njeriun e vogël që u përgjigj:

— Po... e trishtuar...

Këmishëziu nuk shihte asgjë, madje as oficerin. Atij kurrë s'do t'i kishte shkuar në mendje se mund t'ua priste rrugën një lumë i këtitillë.

— Nuk kemi fat.

Edhe oficeri u ul në tokë. Shikimin nuk e shqiste prej grykës së lumit, ku vorbullat gëlltisin si humnera rrëke të tëra ujërash, pastaj zhdukeshin, duke marrë me vete çdo shpresë shpëtimi të atyre njerëzve.

— Sikur të vazhdojmë drejt bregut, nga lindja?

Këmishëziu donte të thoshte se andej mund të gjenin ndonjë vah.

— Nuk ka kuptim.

— Ta provojmë njëherë.

— Nuk ka kuptim.

Zëri i oficerit ishte brejtur fare përbrenda.

— Nuk ka kuptim...

Këmishëziu klithi:

— S'duhet ta humbim toruan, zoti oficer! Në fund të fundit lumë është... diku duhet të kalo-het...

— Tani, or djalë, s'kemi asnjë shpresë...

— Djalë... — bloi nëpër dhëmbë këmishëziu.

Kryet e oficerit sikur u këput e ra mbi kraharor.

— Është e kotë, Ugo, Tani unë e kuptoj si është krijuar gjithë kjo kënetishtë... Rrëketë e lumit... Prandaj njerëzit e këtyre anëve kanë ecur vetëm nëpër udhën që na pruri deri këtu. Udhë tjetër nuk ka, të jesh i sigurt. Po të nise-mi andej nga thua ti, do të mbytemi... Më vjen për të qarë, — tha pastaj Xhino Roveli.

Edhe Luixhit i vinte për të qarë. Ai nuk u

ndie. Dëgjonte i heshtur bisedën e atyre të dyve.

Këmishëziu ecte lart e poshtë, fliste më këmbë e me dorë, thërriste, pastaj ulej përsëri para oficerit.

— Nuk dua të kthehem pas. Të shkojmë ku të shkojmë. Te gjermanët, në fund të fundit, po jo atje... në shën Triadhë... Nuk mundem. Më kupton.

— Megjithatë...

— Nuk i shoh dot ato fytyra të vdekura... si fytyra shenjtorësh... O perëndi, përse nuk i varros?

— Lëri të vdekurit, — pëshpëriti Xhino Roveli.

— Përse, i ke frikë të vdekurit?

— Është mëkat, Ugo.

— Besomë mua, zoti oficer, nuk ka gjë më të lehtë sesa të varrosësh të vdekurit. Unë e di mirë këtë.

— Edhe unë e di.

— Çfarë?

— E di që, të varrosësh një njeri, është fare e lehtë.

Tani oficeri vështronte ngultas sytë e këmishëziut.

— Të besoj, — i tha rreshterit ngadalë.

— Nuk dua të kthehem në atë kishë, — foli me zë fare të shuar Ugoja. — Ai dridhej i gjithi. — Nuk dua....

— E megjithatë...

Këmishëziu gremisi sytë në tokë. I mbylli. Dhe u ul pranë oficerit. Askush nuk dëshironte më të dinte se ç'mendonte tjetri. Ata donin të harmonin gjithçka. Ata tashmë kishin harruar gjithçka. I bëhej se jo atyre të treve, po një-rëve të tjerë u kishte dalë përpara një lumë,

që t'u priste të vetmen udhë shpëtimi. Të tjerëve... Kurse ata... Ku ishin ata? Ugoja nuk shih-te më as oficerin, as Luixhin, as lumin, as de-tin... Asgjë... Zbrazëtirë... Ai nuk ishte, nuk je-tonte më.

Atëherë ndjeu një regëtimë të largët, të mby-tur, që sa vinte afrohej e kthehej në zhurmë. Ush-tari u përmend. Sakaq zhurma u shndërrua në një uturimë gumëzhitëse që pushtoi gjithë atë gry-kë lumi. Dhe gryka thëthinte gjithçka. Ata vë-shtronin hapësirën të hutuar. As kuptonin e as arrinin të pyesnin se ç'ishte ai gjëmim.

— Aeroplan! — Këmishëziu kërceu përpjetë.  
— Aeroplan! — thirri ai.

Si një shpend i vetmuar, i largët, që, sa më shumë afrohej, aq më tepër i shtrinte krahët e tij të mëdhenj e të lodhur, aeroplani fluturonte ulët mbi valët e detit. Pastaj, i madh e i metaltë, ai fluturoi mbi ata njerëz të vegjël, që e shihnin të mahnitur atje poshtë.

Oficeri e Luixhi brofën në këmbë. Ugoja nisi të kërcente. Tundte duart në ajër. Pastaj zhve-shi xhakëtën dhe e valëviti mbi krye. Pa e kup-tuar edhe ata të tjerët zunë të bënin si ai. Thë-rrisnin sa kishin në kokë, jepnin shenja e hidhe-shin përpjetë.

Aeroplani fluturonte në drejtim të lindjes, du-ke marrë me vete uturimën. Ata vazhdonin ta ndiqnin me sy atë shpend të papritur që tani zvogëlohej, zvogëlohej... derisa humbi fare i mbështjellë me frymën e fundit të uturimës së vet.

Dhe mbetën përsëri me atë vëngim të tur-bullt e të pandalshëm të grykës së lumit. Aero-plani nuk dukej më. Të tre e ndien sesi po kri-dheshin në heshtjen e thellë, të akullt, që i ki-shte pllakosur po aq papritur sa edhe gjëmimi i mëparshëm i aeroplanit.

— Bota... — tha oficeri. — Ne e harruam fare Botën... Po ajo është atje...

Këmishëziu u kthye nga ai. Sytë i qenë shkërfitur.

— Ne e harruam, Ugo, e harruam Botën, tonë, po ajo është atje...

Togeri ngriti krahun në drejtim të perëndimit.

— Ta pata thënë, zoti oficer. Nuk ta pata thënë? Bota...

Ata e kishin harruar atë, sepse i kishte puschuar ankthi i vdekjes. Po jeta, edhe ajo, ishte aq pranë.

— Duhet, — tha oficeri nëpër dhëmbë.

— Çfarë?

— Duhet bërë diçka, Ugo.

Xhino Roveli fliste e shikonte detin thellë. Hapësirat e kaltra tani i ndillnin shpresë. Sytë e ngulur në horizont sikur preknin fundet e ulëta qiellore të mbrëmjes që po binte.

— Duhet bërë diçka.

— Po kështu... de... Mos e jep shpirtin padekur, thoshte gjithnjë xhaxhai im.

— Vëllai i babait?

— Po.

— Ku është ai tani?

— S'e di. Letrën e fundit e mora kur luftonte në Tunizi, nën komandën e gjeneralit Mese. Tani s'di gjë.

— Babai yt në Itali, është?

— Po.

Këmishëziu qeshi.

— Plaku e njeh mirë jetën, — tha ai.

Uturima e aeroplanit u dëgjua përsëri dhe, pas pak, ata e panë tek vinte në drejtim të detit. Aeroplani po kthehej andej nga kishte ardhur. Ata nisën prapë të hidheshin përpjetë e të thë-



rrisnin. Jepnin shenja aty te gryka e lumit. Por aeroplani largohej e ata e kërkonin dhe e ndiqnin me sy pikën e zezë, të vockël, që po humbte nëpër qiellin e vrugët të mbrëmjes.

— Djema, nuk jemi vetëm.

Oficeri shkundi nga krahu Luixhin, pastaj e mbërtheu Ugon për dore dhe e tërhoqi pranë vetes.

— Nuk jemi vetëm, — tha oficeri. — Ky aeroplan nuk fluturon këndeje rastësisht. Jo. Ky aeroplan është shpresa e gjallë. Të kthehemi shpejt...

— Zoti oficer, nuk mundem... — tha këmi-shëziu i përvuajtur.

— Nuk ka rrugë tjetër, Ugo! Lumi na doli përpara, po qielli... — dhe oficeri ngriti kryet lart. — Të paktën qielli... — tha ai me zë të ulët prej besimtari dhe bëri kryqin.

Mbi ta kishte rënë mbrëmja.

3:

Mihali e pa se si italiani kërcëu pak anash dhe i ra me bërryl dritares së ulët. Ajo nuk u hap. Atëherë Çezare Rokoja e goditi lehtë me qytë të pushkës. U thye xhami dhe një zë u dëgjua nga brenda:

— Kush është?

Ai zë kërcënonte. Italiani nuk u ndie.

— Kush është? — përsëdyti njeriu nga brenda.

— Hape, more, jemi partizanë... — i foli Mihali njeriut që rrinte brenda shtëpisë.

— Partizanë? Po pse nuk flisni?

Ai e hapi dritaren dhe të dy partizanët rrëshqitën nëpër të. Në terr të odës, me pushkë në dorë qëndronte para tyre një fshatar.

— Nuk hapet dot dera, — tha ai. — Po ju pse nuk bëni zë, — pyeti pastaj i zemëruar.

— Nuk di shqip ky. Është italian.

— Italian? — tha nëpër terr fshatari. — Ptu! — dhe pështyu. — Mirë ma bëre, — i tha Mihalit. — Dësh qëllova mbi italianin. Po ejani pas meje, se tani këtu mund të vijnë gjermanët.

Partizanët u nisën pas fshatarit. Ai i kaloi ata nëpër oborret e shtëpive, që vinin njëra pas tjetrës, dhe i nxori nën një përrua. Atje fshatari mori të përpjetën.

— A ka shumë gjermanë?

— Pastaj llafosemi, — tha fshatari që ecte rëndë përpara. — T'i shkoqis unë të gjitha, po të mbërrijmë njëherë në shtëpi. Fëmijët i kam çuar lart në mal, tek ime motër. Atje do të shkojmë.

Ecnin duke gulçuar nëpër errësirë. Ishin të tre burra të fuqishëm. Çezare Rokoja shikonte fshatarin që kërcente nëpër natë sa këtu-atje dhe nuk i shqitej. Italiani nuk donte të mbetej pas atij malësori vendës. Drejt tyre u lëshua një qen, po fshatari iu gërmush:

— Hyyy, dreq! Mbylle gurmazin... Korbec!

Kaluan pragu e gurtë dhe hynë brenda në shtëpi. Kur u gjendën në odën e madhe, fshatari tha:

— Tani pushoni.

Vetë shkoi poshtë te gratë. Erdhi një grua dhe u përshëndosh me partizanët. Pastaj erdhi edhe vetë fshatari.

— Si të quajnë? — e pyeti Mihali.

— Hasan. Hasani i Met Aliut jam.

— E gëzofsh! A ka shumë gjermanë në fshat?

— Sa të duash... — dhe Hasani nisi t'u tregonte partizanëve fill e për pe ç'dinte për forcat naziste. U tha që në të dy anët e Kodrës së Drizës kishin vënë mitraloza të rëndë. Në mes të fshatit kishin hapur llogore dhe në hyrje, te Luadhii i Verdhajve, kishin ngritur dy çerdhe mitralozash të rëndë. Te shtëpia e Balajve Hasani nuk e dinte se ç'kishin, po tha se do të shkonte vetë që të shihte.

Fshatari pa Çezare Rokon që ishte mbështetur mbi shilte lëshi.

— Po këtë ç'ma kishe lëshuar si viçin para lopës? — i tha Mihalit.

— Edhe viçi pjellë e lopës është, — u përgjigj Mihali.

Hasani i Met Aliut po e shikonte i heshtur dhe i harruar fytyrën zeshkane të Çezare Rokos, me atë mjekër të dendur të zezë, me ata sy të vegjël e vezullues. Edhe italiani po e shikonte shqiptarin në sy. Ata heshtnin të menduar të dy. Mihali e ndjeu dhe sikur u tërhoq mënjanë. Ai nuk ishte më aty. Fytyra e habitur e Hasanit të Met Aliut, sikur nuk i besonte pamjes që kishte përpara.

— Kështu, ëh... — tha pastaj me vetë.

Mihali nuk u përgjigj. As Hasani i Met Aliut nuk priti që të përgjigjej partizani. Duke parë italianin, ai hyri në një bisedë gati të pakuptueshme me veten. Përsëriste herë pas here «kështu, ëh...», tundte kokën dhe përsëri diç murmurishte.

Çezare Rokoja rrinte i heshtur e i ftohtë.

— Kështu, ëh... — tha më në fund Hasani i Met Aliut. — Luftë e fortë... — Tani ai u kthye nga Mihali. — Për nder, — tha, — nuk do ta kisha besuar se do të bëhej luftë kaq e fortë...

Të dy shqiptarët po bisedonin midis tyre, qeshnin, vrenjteshin dhe pastaj papritur heshtnin. Çezare Rokoja ndiqte me vëmendje dhe përpiqej të kuptonte kur flisnin për italianët e kur për gjermanët. Po gjuha që flisnin ata të dy ishte e pakuptueshme për të dhe italiani më shumë rrekej t'u zhbironte, mimikën e fytyrës dhe lëvizjet. Duke qeshur, Mihali hoqi kapën dhe shkri- fi me gishtërinjtë e gjatë leshrat e verdha. Sytë e mëdhenj e të kaltër i përshkënditeshin nën dritën e llambës me vajguri. Dhoma kumbonte nga e qeshura e partizanit. Sigurisht që Hasani i Met Aliut po i tregonte atij diçka të këndshme. Tek e shikonte ashtu, Çezare Rokos iu kujtua që edhe partizanet e shihnin me lakmi këtë parti- zan shtatlartë e të pashëm. Ai vetë e kishte pye- tur një ditë:

— Pse s'bejnë dashuri partizanët?

— Nuk është kohë për dashuri kjo...

— Çdo kohë është për dashuri.

— Kjo është kohë për të vrarë nazistët.

Hasani i Met Aliut u ngrit e shkoi nga oda e grave dhe sakaq u kthye duke sjellë me ve- të një erë të mirë e të lehtë. Çezare Rokoja pa me lakmi në dorë të tij një pjatë me vezë të fërgu- ara me gjalpë të freskët. Fshatari ja vuri për- para italianit. Pastaj ai shkoi e solli një kulaç të ngrohtë prej gruri të ri.

— Ha, se trimi e do trimin, — i tha fshatari italianit.

Partizanët po sulleshin të çlironin kampin ku nazistët kishin mbyllur mijëra italianë. Ish-te ë habitshme shpejtësia me të cilën qe rritur ai kamp përqendrimi i atyre ushtarëve të mbetur udhëve. I mblidhnin nga të gjitha anët, prej të gjitha reparteve. Ca i vrisnin, të tjerët, thoshin, i dërgonin në Gjermani për të punuar. Tani, në errësirën e natës, partizanët po sulleshin drejt atij kampi, të ngritur mes fushës së vogël të Mavrovës e të mbrojtur nga gardhet e telave me gjemba dhe grykët e mitralozave «Shars».

Mihali u ndal dhe, pa e kërkuar fare vendin, hyri në hendekun që i doli përpara. Qelloi disa herë andej ku flakëronte një mitraloz gjerman. Pastaj mbështeti shpatullat te ledhi. Nuk mund të ecte më tej. Ndiante një dëshirë të egër të çlodhej. Mbi të qëndroi Xhelo Lapi.

— U plagose gjë, Mihal?

— Jo. Më pihet një cigare.

— Ku e gjete tani... Po s'e ke keq, më jep edhe mua një.

Mitralozat gjermanë digjin errësirën e natës dhe plumbat fishkëllenin ngjethshëm. Të dy partizanët, të heshtur, thithnin thellë cigaret. Po Xhelo Lapi ishte fare i hutuar. Kurrë s'e kish-te parë Mihalin ashtu. Çkishte? Donte ta pyeste, po ndërroi mendje. Kushedi si e ka punën, mendoi. Ngriti kryet dhe pa nëpër errësirë hijet e ca partizanëve që vrapuan pesë-gjashtë hapa, pastaj ranë mbi tokë. Përsipër u kaloi shiriti i shëndritshëm i projektorit gjerman.

— Kurrë s'do ta kisha menduar...

Xhelo Lapi u kthye nga shoku. Çfarë thoshte ai?

— Çfarë thua, more, eja se s'është koha...!

— Tani ne lëmë lëkurët tona këtu... për të çliruar italianët... dhe nga kush se... nga gjermanët... Kjo kurrë s'do të më kishte shkuar ndër mend...

Xhelo Lapi hyri në hendek; i vuri edhe ai shpatullat ledhit të ftohtë. Qenë shokë të ngushtë të dy, kishin shkëlur kaq udhë lufte së bashku. Kishin kaq kujtime. Ndodhte që ndonjëherë Xhelo Lapi të shihte në ëndërr sikur vritej Mihali dhe zgjohej nga të thirrurat e veta.

— Nuk e harroj dot Hajredinin... kur e pa shë të vrarë së bashku me të tre shokët e tjerë në atë shtëpinë e vogël te kodra me ullinj në Vlorë... Fadil Dauti qante, kishte futur kokën e qethur në një zgavër ulliri dhe qante me ngashërim... Hajredini kishte rënë te pragu i derës... Në donim të afroheshim, por nuk na lejonin as milicët, as karabinierët italianë... Na shtynin me pushkë... Fadili qante... Dhe tani ne, Xhelo, çlirojmë italianët...

— Tani është tjetër... — dhe Xhelo Lapi ofshani thellë. — Ata tani i ka mbledhur nemcia si bagëtinë për t'i therur... Kasapi tani është Hitleri...

— Fadili qante e i binte tokës me grushta... — tha Mihali. — E kam parasysh si tani... S'e harroj dot... Flas me ty dhe më del përnara ai shikimi i egër i brigadierit të karabinierëve që hente fytirat tona.

— Tani është tjetër, të thashë... Po ngrehu... — dhe Xhelo Lapi papritur kërcëu jashtë, zbrazi një breshëri plumbash e u sul përnara. — Hitler, viedhës, kecash, të ormis unë ty. — thërriste Xhelo Lapi nëpër natë. — Nuk të mjaftuan qetë e Evropit, po erdhe të zhatësh edhe dhiaren time në Kropisht.

Mihali u ngrit. Vështroi para në errësirë duke kërkuar me sy Xhelo Lapin. Pastaj u sulloi edhe ai drejt barakave që nxinin në mesin e fushës.

Tani lufta kërkonte cilindo e gjithëka. S'ishite më si përpara dhe as nuk mund të ishte si përpara. Ishin vënë në lëvizje njerëzit, armët, logjika, sipas ligjeve të luftës. Por qysh në fillim, qysh në përgatitjet e para, u pa se kjo luftë nuk do të ishte si të tjerat.

Forcat partizane po sulmonin tani me një furi të pashoqe. Toka digjej. Hapësira gjëmonte nga predhat, nga sokëllimat dhe britmat. Ata zëra Mihali i nihte, i kishte dëgjuar edhe më parë. Ishin shokët.

Xhino Roveli ecte përpara duke i mëshuar fort këmbës së maite. Kishte riasurduart në xhepa, i kishte mbledhur grusht brenda e ndiente se si pesha e tyre ia tërhoqte xhakëtën poshtë. Atij i vinte mirë. Nuk mbante mend të ishte lodhur ndonjëherë si këto ditë. Po aeroplani, si një shpirt i mirë, që futur tek ai dhe tani Xhino Roveli ndiente të ngrohtë.

— Shpejtoni. — u thirri atyre të dyve që vinin pas. — Sa të kalojmë kallamishten.

Kur kishte parë ushtarët e mbledhur në kishë. Xhino Roveli kishte menduar se ishte detyra e tij si oficer, që t'i ringjalle ato copëra të thyera të ushtrisë së dikurshme. Ai duhej t'i kthente ata prapë në ushtarë. Dhe si ushtarë do t'i çonte në atdhe. Italia e kishte humbur luftën, por

për këtë nuk përgjigjej ai, Xhino Roveli, toger i batalionit të 3-të të regjimentit të 128 të divizionit «Parma». As majori i gjatë flokëkuq me të cilin kishte marshuar ditën e parë të zbarkimit në Shqipëri. Majori tani nuk ishte më. E kishin vrarë partizanët në Pezë. Kurse atij, Xhino Rovelit, askush nuk mund t'i kërkonte llogari për humbjen e Italisë fashiste. Si ushtar kishte luftuar atje ku e kishin urdhëruar. Në Shqipëri — në Shqipëri. Në Greqi — në Greqi. Kështu. E kishte kryer me ndërgjegje të plotë detyrën e oficerit të ushtrisë italiane. Dhe tani duhej të kthehej, Për t'u nisur përsëri si ushtar? Nuk i takonte atij të përgjigjej.

— Ai mbeti pas, — tha Ugoja.

Po Luixhi tha:

— Jo... këtu jam.

Ushtari ndiente një lodhje therëse nëpër gjithë kyçet e kockave. Këmbët i bindëshin me përtim. Ecte dhe habitej me rreshterin e këmishëzinjve që shkante para tij, gjithnjë i freskët e i palodhur. Ku i gjente fuqitë ky njeri?

Këmishëziu nuk donte të kthehej në Shën-Triadhë, por prapë i qepej pas oficerit me atë hapin e shkathët dhe nuk i ndahej.

— Tani aeroplani duhet të jetë ulur në tokë, — tha ai.

— Mundet... — tha me vete oficeri.

— Është ulur. Pilotët dalin prej kabine dhe hop...

Këmbët i goditën në një rrënjë shkurreje dhe Ugoja desh u rrëzua.

— Kanalia! — Shau... — Kurse ata tani kërcejnë mbi barin e butë të aerodromit... Jezui! Mjaftojnë vetëm disa çaste dhe mund të ishim

1) (Ital.) — Ah, fundërrinë!



prapë ata që kemi qenë dikur. Zoti oficer, përse fluturoi ai aeroplan këndej?

Oficeri nuk dëshironte të hynte në bisedë me këmishëziun, që i vinte pas. Tani i buisnin në kokë mendime të tjera. Lumi, aeroplani, kisha, ishulli, partizanët, gjermanët — të gjitha këto dyndeshin e sikur kapërdinin njëra-tjetrën në mendjen e tij.

— Ej, zoti toger, ç'kërkon këndej ai aeroplan?

— Mos na kërkojnë ne?

— Sigurisht. — Ai mendoi: mundet... po tha:

— Sigurisht që na kërkojnë.

Këmishëziut i duhej dhënë zemër. Edhe vetë oficeri kishte nevojë për një fjalë burri, por atij s'kishte kush t'ia jepte. Ndërsa ushtarit i duhej thënë një fjalë frymëzuese.

— Sigurisht, — tha prapë oficeri, — ne na kërkojnë.

Dhe vetë mendoi: «Vërtet, përse të mos na kërkojnë? Si mund të mos na kërkojnë? Mijëra e mijëra ushtarë të braktisur në një vend të huaj. Patjetër do na kërkojnë! Ndoshta ai aeroplan na kërkon vërtet ne, prandaj do të fluturojë edhe nesër, edhe pasnesër. Duhet të fluturojë... Ata po na kërkojnë... S'ka mundësi të mos na kërkojnë.»

— Sigurisht që yt atë të kërkon, — i tha ai këmishëziut. Oficeri si më dorë hogi mendimin nga njerëzit e tij.

— Në kohë të tjera, unë e di, plaku nuk do të më linte këtu.

— Po si edhe këndej?

— Shkova në luftë vullnetar, zoti oficer. Plaku u gëzua shumë. Na përcolli vetë, xhaxhanë më parë, pastaj edhe mua. Sot i duheni Italisë fashiste, na tha: Shkoni. Dhe ne shkuan. Unë isha në Francë.

— Në Francë?

— Po.

— Pastaj më dëgruan në Mal të Zi.

Këmishëziu heshti papritur. Ai nuk dëshironte më të fliste. Kishte luftuar në Mal të Zi, pastaj në Greqi, pastaj në Shqipëri. E ditët që po jetonte nuk i kishte shkuar kurrë nëpër mend. Dhe ishte i bindur se as i ati nuk i kishte parashikuar ato ditë. Plaku s'e kishte menduar kurrë se Musolini mund të përmbysej një ditë... Musolini... Italia mezi e kishte bërë, si munda ta braktiste tani? Vetëm këtë plaku nuk do ta kishte besuar kurrë.

Ishin futur thellë në kallamishte. Bishat e natës as dëgjoheshin e as shiheshin gjëkund! Oficeri tha me vete:

— Ç'bëhet vallë tani në Itali? — Këto fjalë ai i kishte dëgjuar për herë të parë nga kaporalin Bianki, në grykën e Vërgës, midis shkëmbinjve të egër, kur forcat italiane ishin sulmuar nga malësorët shqiptarë. Ushtarët e «Julias» po tërhiqeshin nga fronti italo-grek dhe shqiptarët mësynin mbi ta që t'u merrnin armët. Kaporalin Bianki e kishte marrë plumbi në krahëror. Më sy të çakërritur ai kishte shikuar gjatë ngultas, Xhino Rovelin që qëndronte mbi të dhe e kishte pyetur me zë të shuar: «Ç'bëhet vallë tani në Itali?»

Xhino Roveli u drodh kur dëgjoj pas krahëve këmishëziun që klithi:

— S'dua t'i dëgjoj këto gjëra tani!

Oficeri u kthye e pa nga ushtari.

— Përse më bën të çmendëm; zoti Oficer?  
E ç'më duhet mua se ç'bëhet tani në atë bordell,  
— gërthiste këmishëziu. — Mua po më luan  
tepeleku, a më dëgjon. Ata të Italisë as që e  
çajnë bythën për ne...  
O shën Mëri!... Zoti oficer, si e pësuarra kështu?

— Unë po flisja me vete, Ugo.

E kishin humbur ndjenjën e kohës. Ajo udhë  
sikur s'kishte të mbaruar. Era fërshëllente mbi  
ta; njëherësh me kallamat e egër lëkundej edhe  
terri i asaj natë me shi. Oficerit i shkoi në mend  
se dy ushtarët ecnin të heshtur e të zymtë, sep-  
se edhe ata mendonin për bishat e natës e tani  
kishin frikë. Ai donte t'u thoshte diçka të gëzue-  
shme, por nuk dinte se çfarë.

Befas Ugoja tha:

— Nuk e mendojnë ata vdekjen tonë? Dhe je-  
mi kaq afër... Kaq afër, sa, sikur t'i thërrasim,  
mund të na dëgjojnë...

— Çfarë thua? — pyeti i habitur Xhino Rove-  
li.

— Të gjithë janë kundër nesh, — tha këmi-  
shëziu, — të gjithë. Edhe ata.

— Cilët?

— Ata matanë detit. Edhe ata janë kundër nesh.  
Bijtë e bushtrave! Vetëm mos shpëtoftsha i gjallë  
prej këndeji!

\* \* \*

— Ahaa! — u dëgjua një klithmë njeriu pas  
tyre.

Ata ngrinë në vend të dy. U kthyen drejt  
njëri-tjetrit e nuk flisnin. Errësirë. Vetëm shiu  
binte pa pushim mbi gjethet e kallamave. Shiu  
dhe era.

— Oheee! — thirri oficeri. — Luixhi... —  
Asnjë përgjigje.

— Luixhiiii...

Përsëri askush nuk u përgjigj.

— Çakejtë? — pyeti oficeri këmishëziun nëpër errësirë.

— Zoti oficer...

— Eja...

Ugoja nuk po luante prej vendit.

— Eja pas meje! — urdhëroi oficeri.

— Zoti oficer!... — kësaj radhe zëri i këmishëziut paralajmëronte.

— Luixhiiii... Luixhiiii...

Oficeri dëgjonte llapashitjen e opingave të llastikta dhe gulçimën e vet. Fëshfëritja e trupit që çante kallamishten përzihej me zhurmërimën e erës.

— Luixhiiii...

Duke bredhur ashtu, Xhino Roveli gati sa nuk e shkeli me këmbë ushtarin që kishte rënë përtokë.

— Ç'ka ngjarë? Ç'ke?

— Nuk mundem më. Nuk mundem, o zot!

— Po ç'ke?

— Kam shumë ethe... nuk eci dot më.

Oficeri u përpoq ta ngrinte, por ushtari ishte tepër i rëndë.

— Ngrehu... duro, edhe pak, se arritëm.

— Nuk mundem, zoti oficer.

— Ugo!

**Gjëlkundi nuk shihej asnjë hije. Errësira e natës sikur që piksur përmbi korijen e kallamishtës.**

— Ugoooo!...

Luixhi mori të ngrihej, por këmbët iu prenë e ai ra sërish përdhe. Dhe zgjati dorën drejt oficerit.

— Ndihmomë, zoti oficer.  
— Ugoooo... — klithte nëpër natë Xhino Rovel. — Ugoooo...

Zëri i tij ishte i frikshëm. Ai vetë kurrë s'e kishte pandehur se mund të kishte një zë të atillë.

— Ugoooo...  
Atëherë ndjeu nëpër kallama një hije njerëzore që po rrëshqiste drejt tyre.

— Zoti oficer...

— Ah, derr i qelbur!

— Zoti oficer...

— Je qelbanik! Ugo! Erikacak! Kape...

oficeri u përkul dhe e mbërtheu ushtarin e sëmurë.

— Pse përse?

— Si?

Oficeri e lëshoi trupin e ushtarit që sapo e kishte ngritur.

— Përse... e gjitha kjo? Ne mezi po arrijmë vetë... Kurse ky... Si ky, atje në kishë, ka sa të duash... Dhe gjithnjë vijnë të tjerë... Këta janë të vdekur...

— Je kafshë, Ugo! Më dëgjon? Kafshë që s'e ke shokun... Mbërtheje!

Oficeri e kapi përsëri të sëmurin prej të dy këmbëve. Dora e tij preku në fillim pulpën e pastaj shputën e këmbës së Luixhit. Përnjëherësh iu kujtua ushtari i varrosur atje te kodra anës detit. «Anxhelina... — pëshpëriti me vete...

— Anxhelina...» — dhe e lëshoi ushtarin.

— Eja këndeje... — urdhëroi këmishëziun. — Ma jep mua kryet e tij.

Ma jep mua kryet e tij.

Ma jep mua kryet e tij.

Ma jep mua kryet e tij.

Ma jep mua kryet e tij.

Ma jep mua kryet e tij.

Ma jep mua kryet e tij.

Ma jep mua kryet e tij.

Ma jep mua kryet e tij.

Ma jep mua kryet e tij.

Ma jep mua kryet e tij.

Ma jep mua kryet e tij.

Ma jep mua kryet e tij.

Ma jep mua kryet e tij.

Ma jep mua kryet e tij.

Ma jep mua kryet e tij.

Ma jep mua kryet e tij.

Ma jep mua kryet e tij.

Ma jep mua kryet e tij.

Ma jep mua kryet e tij.

Ma jep mua kryet e tij.

Ma jep mua kryet e tij.

Ma jep mua kryet e tij.

Ma jep mua kryet e tij.

Ma jep mua kryet e tij.

Ma jep mua kryet e tij.

Ma jep mua kryet e tij.

Ma jep mua kryet e tij.

Ma jep mua kryet e tij.

Ma jep mua kryet e tij.

Nën atë shi të dendur vjeshte oficeri mbante mbi supë peshën e rëndë të Luixhit të sëmurë.

Përbrenda i gufonte një zemërimi egër kundër këmishëziut që vazhdonte të ecte prapa pa thënë asnjë fjalë. I sëmuri rënkoi.

— Ç'ke?

— Më dhemb gjithë trupi... Jezu!

— Kot... Këta prej kohe kanë vdekur... — u ndërthemb Ugoja. — Këta s'jvlejnë më askujt...

Luixhi e ndiente se ata të dy mezi po e ngri- nin trupin e tij të lëshuar e të shkrehur. Herë pas here gulçonin nën atë barrë. «Ai ka të drejtë... — mendoi ushtari... — Ai ka të drejtë... Unë kam vdekur...»

— Eh, pastaj? Ja do ta çojmë edhe në kishë... pastaj? — murmuriti përsëri këmishëziu me vete.

Oficeri e dëgjoi. Ai u ndal dhe e lëshoi të sëmurin në tokë. Ashtu bëri edhe tjetri.

— U lodha, — tha oficeri.

— Zoti oficer! — këmishëziu shkoi tek ai.

— Ky është italian... si ti e si unë... — i tha Xhino Roveli atij me një zë të ngrohtë e të afërt. — më kupton, si ti e si unë...

Këmishëziu e kuptoi; oficeri kishte frikë se mos Ugoja i braktiste ata të dy në atë terr të frikshëm.

— Po ai është i vdekur... Zoti oficer! Ç'i duhen Italisë këta, tani? Ç'i duhen Italisë kufomat?

— Kufomat? — oficeri i shikoi me sy të errët.

— Kufomat? — këmishëziu i shikoi me sy të errët.

— Kufomat? — këmishëziu i shikoi me sy të errët.

— Kufomat? — këmishëziu i shikoi me sy të errët.

— Kufomat? — këmishëziu i shikoi me sy të errët.

— Kufomat? — këmishëziu i shikoi me sy të errët.

— Kufomat? — këmishëziu i shikoi me sy të errët.

— Kufomat? — këmishëziu i shikoi me sy të errët.

— Kufomat? — këmishëziu i shikoi me sy të errët.

— Kufomat? — këmishëziu i shikoi me sy të errët.

— Kufomat? — këmishëziu i shikoi me sy të errët.

— Kufomat? — këmishëziu i shikoi me sy të errët.

— Kufomat? — këmishëziu i shikoi me sy të errët.

— Kufomat? — këmishëziu i shikoi me sy të errët.

## VII

1.

— Ngrije pak dritën.

Drita e kandilit e pengonte shikimin e partizanit dhe ai u largua anash. Vetëm atëherë shqoi më mirë hijet, që ishin ulur pranë tij, mbi gunga e rrënjë të ullinjve. Herë pas here nëpër errësirë fërfërinin krahët e bardhë të mandileve të grave e të çupave.

— Si jeni? — pyeti Mihali bashkëfshatarët.

Partizani kapi dorën e djaloshit që mbante kandilin dhe e ngriti lart.

— Po të shuhet... Është errët pus e unë nuk ju shquaj dot, — u tha ai fshatarëve.

— Kandili të bëjë përpara, — tha dikush.

Ajo dritë e zbehtë ndriçoi gjysmën e fytyrës së partizanit. Ai e kishte rrasur kapën me yll dërra rrëzë vetullave. Shikimi i tij i bëri njerëzit të

heshtin përnjëherësh. Një vajzë i ra me bërryl shoqes së vet:

— Shikoje... — tha ajo.

— S'kemi ç'i bëjmë, — tha Mihali. — Le të shikojmë të gjithë këtë dritë dhe atje le të takohen shikimet tona. — Ai uli në tokë qytën e pushkës së gjatë dhe u mbështet mbi të.

— Si jeni, mirë? — pyeti pastaj me një zë të ngrohtë.

— Mirë. Faleminderit, ti si je?

— Mirë qofshi! Mirë qoftë gjithë populli!... Ne komunistët prandaj luftojmë, që të gjithë popujt të jenë mirë.

Partizani fliste ngadalë. Kushdo që e dëgjonte e kuptonte se ato gjëra ai i kishte bluar prej kohe në kokë. Mihali u afrua fare pranë dritës. Tani sytë e tij po mësoheshin me atë ndriçim të paktë e të zbehtë që lëshonte kandili në fushën e hapët të asaj nate.

— Italia fashiste ra, — tha përnjëherësh Mihali.

— E dimë, — foli dikush në errësirë!

Sakaq heshti. Askush nuk dëshironte të ndërpritej ajo bisedë që kishte nisur partizani. Edhe pse Mihali ishte «djalë fshati», për ta tani ai ishte «partizan». Dhe kjo do të thoshte se ai dinte shumë gjëra, që ata nuk i dinin. Mjaft më me llafet e njërit e të tjetrit atje, te tregtorja e fshatit.

Po Mihali tha:

— E, more xha Llambro, e pe që Italia fashiste ra?

— Ah, të keqen, më njohë zërin? — Ishte fshatari që kishte folur pakëz më parë.

— Si nuk ta njoha, — tha Mihali. — Jo ti, po ca të tjerë nuk besonin se fashistët do të përfundonin ashtu. Ju vetë i keni dëgjuar kur na



thoshin neve, komunistëve: «Italia është shtet i madh; Fashizmi është i fuqishëm, Musolini di se ç'bën. Ç'do t'i bëni ju atij?» Po ja që ngordhi kali.

— Për faqe të zezë! — thirri dikush.  
— Për faqe të zezë! Mirë e the, — tha Mihali duke u drejtuar andej nga erdhën ato fjalë. Ai e nguli shikimin atje, por nuk shqoi dot njeri. — Mirë e the... Historia nuk ka mëshirë, — tha pastaj, duke e kuptuar edhe vetë se ai mendim, ndoshta, ishte i pakapshëm për ata fshatarë që po mbanin vesh. Por ai ashtu tha: «Historia nuk ka mëshirë dhe, kur themi historia, themi popujt...»

Dikush lëvizi nga vendi. Lefter Pavli iu gërmush kryeplakut që e kishte pranë.  
— Ç'dreqin ke që s'të rri bytha në një vend! Lërna të dëgjojmë!  
Në atë kohë partizani po thoshte:

— Atyrë që sot na thonë se «gjermanët nuk janë italianë», se «italianët i mundët, por me nazistët s'bëhet shaka» në u themi: Shikoni Drashovicën! — Zëri i tij u egërsua dhe, vetiu, dorë që mbante bytën e pushkës iu drodh.

— Drashovica ka kaq ditë që po lufton. U dëgjuan! të thirrura, dikush edhe rrahu shuplakat. Ndonjëri thirri: Rrofshim partizanët!  
— Unë prandaj kam ardhur këtu: Partia i bën thirrje fshatit Kodërdet që të dërgojë djem-të e tij të luftojnë në Drashovicë. Atje po lufton Shqipëria, Kodërdeti do të hiqet mënjane?

— Një copë herë nuk u ndie askush: Thua sikur të gjithëve u qe prerë frymë. Ishte një qetësi e egër dhe e rëndë.

— Të tjerët po copëtohen, po luftojnë e po vriten. Ju, ç'do të bëni ju? Do të hiqeni mënjane? Kjo është luftë e madhe, e shenjtë... e të gjithë popujve; është lufta e drejtë e të var-

fërve, e të shtypurve... Është lufta juaj... Toka që ju punoni, buka që bëni e ushqeni fëmijët, nuk kërkojnë sot vetëm djersën, por edhe gjakun tuaj... A do ta jepni atë?

— Unë do të vij me ty... — tha Niko Leli, një djalosh shtatëmbëdhjetëvjeçar. — Do vij në Drashovicë.

— Edhe unë...

Po dilnin vullnetarët e Kodërdehit. Atëherë partizani i drejtua zbrazëtirës:

— Dhe ti, zoti Milo Ndreu, mos e pengo luftën e popullit, se do ta paguash shtrenjtë.

Ishte shpërthimi i një dufi të brendshëm që u përplas në errësirë. Zëri i partizanit u egërsua. Shikimi i tij vërtitej nëpër terr e kërkonte dikë. Ai priste që dikush të përgjigjej prej errësirës. Po Milo Ndreu nuk u bë i gjallë.

— Mos mendo se ne nuk dimë gjë. Ne me popullin rrojmë dhe populli i di vetë hallet e tij.

Ajo fytyrë dhe ai zë i egërsuar po i kallte datën kryeplakut. Mihalin Zoti Milo e njihte prej vitesh, por ishte tjetër ky partizani që po i kanosej ashtu nëpër terrin e natës. Kryeplaku nxori kutinë e duhanit dhe e ndezi.

— Shkuan kohërat kur ti bëje ligjin në fshat, — i thirri Mihali përsëri errësirës.

Të gjithë ranë në heshtje. Zoti Milo pak nga pak po e mërrte veten. Bubullima e parë kishte kaluar. Kryeplaku mendoi një hop të ngrihej e t'i përgjigjej, por iu kthye mendja.

«Ai është ende i ri, — mendoi me vete. — Unë jam plak dhe jam mësuar të pres»

Ne ishim shokë fëmijërie. Nëna më thoshte që, kur unë kisha qenë foshnjë, ajo nuk kishte pasur qumësht dhe ne kishim pirë së bashku në gjirin e nënës së tij.

— Nuk të dëgjoj mirë, — tha Barba, — ngri-je pak zërin.

— Ai ishte këpucar, — tha Ugo Bensi, — dhe unë çdo mbremje kaloja nga këpucaria e tij. Njëherë ai kishte pirë shumë.

Barba u ul përpara dhe u mundua të dëgonte.

— Ai kishte pirë shumë...

— E thë këtë, — tha Barba, fare pranë tij.

— Unë nuk kisha pirë, — tha këmishëziu. — Ai më pyeti: erdhe? Erdha, i thashë. I merrej goja kur fliste e qelbte erë verë. Manifestuat sot, më tha ai. Triumfalë... Ishte një paradë me të vërtetë madhështore, i thashë unë. Po, më tha ai; Musolini e mundi Negusin.) Dhe tani italianët përtypin makaronat me fjalën «Impero»). Shumë si ti mendonin se Abisinja do të bëhej varri i Musolinit, i thashë unë, por prej atij varri Duçja krijoi një imperatori. Ku ka 8 milionë, tha ai duke iu marrë goja... Bajoneta, thashë unë, Analfabetë, tha ai... 8 milionë... e nisi të ulërinte... Më kupton, më tha, 8 milionë...

Pika e shiut hyri përsëri mes mendimeve të

1) Negus-nëgesti — mbreti i mbretërve. Kështu quhej perandori i Etiopisë. Në vitin 1935 Italia fashiste sulmoi ushtarakisht Etiopinë.

2) (ital.) — perandori.

Barbës. Po prapë ai e dëgjonte njeriun që po fliste në mugëtirë, mu pranë veshit të tij.

— Tetë milionë analfabetë, tha ai... pastaj Mateoti<sup>1)</sup> i masakruar. Lëre Mateotin, i thashë unë. E ç'ishte Mateoti? Një çërkë pështyme.. Një pellg gjaku, tha ai dhe m'u afrua ngjitur. Eh, i thashë unë, një çërkë pështyme. Një pellg gjaku, më dëgjon? Klithi ai dhe më mbërtheu prej gryke. Ia kapa dorën që i dridhej në gur-mazin tim. Pellg gjaku, tha ai, dhe Italia e nxori nga mushkëritë e veta. Veç atë Musolinin tuaj.. Lëre Musolinin mënjane, i thashë unë, dhe e përplasa tej. A e di ti se ç'ka shkruar «Nju Jork Herëlld Tribjuni»? Jo, tha ai, nuk e di..

Emri i asaj gazete e përmendi Barbën. Tashmë tërë sy e veshë ai u përkul më tepër mbi kë-mishëziun.

— Unë i thashë atij se «Nju Jork Herëlld Tribjuni» kishte shkruar se vepra e Musolinis ishte një nga mrekullitë e shekullit XX. Ai më tha: unë i bëj shurrën «Herëlld Tribjunit». Aherë unë dola jashtë e shkova drejt e në Fasho. Dhe nuk e pashë më kurrë atë.

Një copë herë askush nuk lëvizi prej vendit as Ugo Bensi e as Barba.

1) Mateoti — intelektual përpärimtar italian, depu-tet i partisë socialiste në vitin 1919, kundërshtar i ven-dosur i fashizmit. Në një fjalim që mbajti më 30 maj 1924 në Dhomën e Deputetëve, dënoi haptas dhe me for-cë regjimin fashist të Musolinis për politikën shtypë-se dhe përdorimin e dhunës policore. Dhjetë ditë më vonë agjentët e fashizmit e rrëmbyen Mateotin. Dy mu-aj pas rrëmbimit kufoma e tij u gjet në rrethinat e Romës.

3. Ushtari që po lëçiste e la gazetën dhe mbajti vesh. Oficeri e pa dhe e ndërpreu bisedën. Ai u shkëput nga ikonostasi ku ishte mbështetur dhe shkoi drejt ushtarit.

— Gazetë? — e pyeti.

— Po, gazetë.

— Ma jep pak. — Dhe pa pritur përgjigje i zgjati duart drejt fletores. Nisi të lëçiste: — Tomori. Edicione italiane. Dhe poshtë me germa të mëdha: «Proklama di Badoglio sulla cesazione delle ostilità».<sup>1)</sup>

— Ku e gjete?

— E bleva.

— Ne po kërkonim një të tillë, — tha oficeri. — Pritëm edhe të nesërmen, po gazeta s'na erdhi. — Erdhën vetëm gjermanët, deshi të thoshte pastaj, po heshti.

Ai u hodhi një sy shtyllave e titujve të asaj gazete. Një buletin, nr. 1201, i komandës së lartë. «Në frontin kalabrez repartet italo-gjermane ngadalësojnë përparimin e trupave britanike.» Nënshkruar Gjeneral Ambrosio. Më poshtë një komunikatë gjermane: «Beteja në gjirin e Donezit vazhdon me të njëjtën ashpërsi.» Pastaj kishte një thirrje për të ruajtur «qetësinë e rendit publik». «Ngjarjet janë të një rëndësie të tillë, që çdo koment është i panevojshëm.» Dhe pastaj: «Probleme të shkencës. — si u shpik dinamiti.» «Misteri i katër elementëve.» «Mbresa dhe emisio-

---

1) (ital.) Proklamata e Badoglio për ndalimin e luftimeve.

ne.» «Një sistem shkrimi me metodë elektroakustike për të verbrit.» «Mjekët e kirurgët në tetëqind...» «Reklama.» «Në qoftë se dëshiron t'i shkruash letër njeriut të dashur, dëgjo këshillën e mikes së panjohur.»

Deri tek oficeri erdhën zërat e atyre që po bisedonin rrëzë ikonostasit, po ai vazhdonte të lëqiste e mendonte se ajo ditë, ashtu siç ishte në atë gazetë, nuk kishte qenë kurrë ndonjëherë. Proklamatën Xhino Roveli po e lexonte për herë të parë. Dhe e lexonte nën kandilin e kësaj kishë të huaj.

Nga ikonostasi erdhën përsëri zëra:

— Nuk mund të na harrojnë. — thoshte dikush.

— E pse të mos na harrojnë?

— Nuk mundet, — u përgjigj prapë zëri i parë.

— A nuk na kanë harruar deri tani?

Oficeri ia dha gazetën ushtarit, u kthye e bëri drejt atyre që po bisedonin.

— Anglezët nuk mund ta lënë kështu Ballkanin.

— Ata e kanë lënë.

— E kanë lënë deri tani, po më tutje jo.

I ndërpreu një tjetër bisedë.

— Ne e kërkuam vetë. Duhej të bashkoheshim me partizanët dhe të luftonim gjermanët.

— Unë jam lodhur nga lufta, nuk e sheh si jam katandisur? E ç'jam unë tani, veçse një mbeturinë lufte...

— Partizanët janë rebelë.

— Edhe gjermanët janë armiqtë tanë.

— Gjermanët janë tjetër, sa të hidhemi matanë, po jua tregoj unë.

— Mbylle, or kafshë!

— Ç'ke, o kufomë fashiste?



— Ah! Ah! Ah! — u përhap e qeshura e sëmure, hysterike e Marios nga një skutë e errët e kishës. — Ah! Ah! Ah! Dhe ju thoni se ai aeroplani, zoti oficer... Kush ju tha juve se ai aeroplani është yni?

Ushtarët dëgjonin atë zë të fikur, të gërryer, që fliste përçart. Midis mureve të heshtura të asaj kishe çmbështitleshin valë-valë gulçet e të sëmurit.

— Eh, — thoshte Marioja, — kush ju tha juve se ai aeroplan qenka yni e nuk është gjerman? Uh! Uh! Uh! Në Sarandë ne ishim 10 000 veta. 10 000!... Erdhi aeroplani e lëshoi një mesazh nga shtabi. Na thanë që do shkojmë në Porto-Palermo, se Korfuzi ishte në duart e gjermanëve. Dhe ne u nisëm. Ç'ndodhi më vonë, ju nuk e dini. Ju dini veten tuaj. Ju nuk e dini... po aeroplani nuk kishte qenë yni. Kishte qenë aeroplan gjerman.

— Hesht, qen! — i thirri atij këmishëziu.

— Pse gërthet ti, — iu hakërrye Pietroja me zërin e rëndë.

— Badolio, Musolini... dhe Anglia! Ditë të tëra ju dëgjoj se si i pëlcisni emrat e tyre nëpër buzë... Gjermanët... Aleatët... Të mjerët ju!

Oficeri ndjeu se po i kërcisnin nofullat. Duke e dëgjuar atë zë, instiktivisht ai po ecte drejt të sëmurit.

— Përse doni të ktheheni në Itali? Përse?

— pyeste Marioja. — Çfarë po i çoni ju tani atij dheu të gjorë?

— Çfarë po çojmë ne në Itali? — e pyeti atë oficeri.

Xhino Roveli kishte qëndruar gati mbi të sëmurin. Sytë e tij po e përpinin fytyrën e shkrehur të ushtarit.

— Çfarë?

Ushtari nuk u kthye fare andej.

— Çfarë do ti që t'i shpie? — pyeti ai oficerin. — Ku na keni çuar ju gjatë këtyre vjetëve? Në luftëra, në djegie, në vrasje të njerëzve të huaj... Dhe në vdekje...

— Ne? Ne ju kemi çuar?

— Po kush?... Ah, nuk na keni çuar ju?

U dëgjuan përsëri zëra. E përsëri kanosje fashiste. Po Marioja tha:

— Nuk do të na harrojnë.. Kush nuk do të na harrojë?

— Italia... — tha oficeri nëpër dhëmbë. Zëri i tij ishte gulçues. Pa e kuptuar ai zgjati këmbët dhe preku trupin e dërgjur të të sëmurit. Ky mezi hapi sytë dhe u kthye nëpër gjysmëterr nga oficeri. Pa fytyrën e tij të mbështjellë mes avujve; pastaj ngadalë nisi të shquante ato vija të holla nollash, ata sytë menduar me rrotullime të zeza...

— Kush nuk do të na harrojë? — belbëzonte i habitur përmes avujve të etheve i sëmuri përposh.

Dhe atëhere një shqelm i ra atij në brinjë. Ugoja goditi prapë.

— Qelbanik! Qen! — gërthiste fashisti, i tërbuar. — Jua tregoj unë se ç'kërma jepi... Ç'kujton ti, se kam vdekur unë?! — Dhe i binte me sa fuqi që kishte trupit të dërgjur të Marios, nën të. — Kështu duhet të vdesësh ti... — thërriste Ugo Bensi.

Oficeri i hodhi atij një shikim të ftohtë. Dhe e shtyu tutje. Pastaj, i heshtur, shkoi e u ul mbi shtrojnë e vet. Ngriti gjunjët, mbështeti gjoksin mbi ta, mbuloi fytyrën me duar dhe, përnjëherësh, papritur, nisi të qante me ngashërime.

Në kishë dëgjohej ngashërimi i rëndë e i padurueshëm i oficerit.



— Unë do të iki, nuk rri dot më këtu.

— ...

— Unë po shkoj, ti a po vjen?

— Ku do të vemi?

— Andej nga erdhëm.

— Andej nga erdhëm?

— ...

— Andej...

— Po nga?

— ...

— Në erdhëm këtu duke shkuar gjithnjë

bregut të detit...

— Po, Bregut të detit...

— A do të vish? Unë nuk rri dot më këtu!

— Po andej janë gjermanët.

— Unë ika...

Dikush u ngrit nga fundi i kishës. Ai rrëshqiti

midis ushtarëve, hapi derën dhe u krodh jashtë

në errësirën e natës. Pas tij rrëshqiti edhe

një hije tjetër. Edhe një tjetër...

#### 4.

Leter Pavli kishte marrë hua të dyqanxhiu

një litër raki 19-gradëshe, kishte futur në shi-

shen në xhëpin e xhakëtës së vjetër, kishte va-

rur dy levrekë të mëdhenj në rripin e panta-

llonave dhe menta ishte lëshuar poshtë rrugës

së madhe. Ndihej i këndellur! Këmbët i kishte

prej ajri e kokën prej qielli të prillit. Që nga

mbledhja e madhe te kopshti me ullinj, edhe pa pirë, ai ishte i dehur.

— U bë... — i thoshte gruas.

— Ëh... — përgjigjej e shoqja, që e dinte se çdo të thoshte Lefteri me atë «u bë». — Ashtu të duket ty, — thoshte ajo.

— Ta thotë Lefteri, grua, «u bë...»!

Gruas i vinte mirë që i shoqi nuk dilte jashtë e nuk shkonte më të pihej, por rrinte brenda në shtëpi me të e, ngado që shkonte ajo, i vinte pas si një fëmijë duke i thënë vetëm «u bë». Dhe përplaste shuplakat. Ishte herë e parë që Lefteri sillej ashtu dhe kjo do të thoshte se me të vërtetë diçka e madhe kishte ndodhur në fshat. Paria kishte ngrënë një dackë që s'ë pandehte. Tani atë nuk do ta dëgjonte më askush. Rinia jo se jo. Por as fshatarët e moshuar nuk do të dëgjonin e nuk do të bindeshin më. Mihali ia ndreqi mirë samarin zotit kryeplak. Kush donte le t'i vinte gishtin kokës, kush nuk donte, më qafë veten. Ama «u bë...». Aq duhej!

Lefter Pavli tek çapitej pa një gumbull të rinjsh që po punonin së bashku në «fitenë!» e xha Llambros.

— Ashtu! Ëh, më ju lumshin krahët... — thirri Lefter Pavli. — Ohoooo, sesi më vjen mirë.

— Eja, xha Lefter! — brofi Niko Leli.

— Erdha.

Fshatari kapërceu me këmbët e zbathura gardhin prej ferre dhe u fut në vreshtë.

— Ashtu! — tha ai. — Rini... — psherëtiu pastaj.

— Merr belin, xha Lefter, — tha Pandi i Dakajve.

— E marr... rini... — murmuriti pastaj ai, i menduar. Por u ul në tokë dhe po shikonte djel-

1) ngastër toke e mbjellë me hardhi të vitit të parë.

moshat e fshatit që po punonin! — Kush ju tha juve të punoni vreshtin e fukarait?

— Vendosëm vetë.

— Aha... vetë?

— Vetë, xha Letter.

— Nuk ju tha Mihali?

— Jo. Vetë.

Letter Pavli shikonte me sy të skërfitur atë vresht të vogël, ata djem, që ai i njihte mirë, por që po i dukeshin si fare të panjohur tani.

— Ta besoj? — u tha ai.

— Pse të mos e besosh?

— Domethënë: ta besoj... — pëshpëriti me vete. — Rini... — tha pastaj. — Rininë tonë e kanë vrarë, o djema. E kanë vrarë... Si, do thoni ju? Si një pulë... ashtu ia kanë këputur këkën, tamam si një pulë... Po kush, do thoni ju... E kush jo?! Po juve... hallall... hallall ju qoftë!

Ai u ngriti. Trupi tani i ishte përthyer fare. Ai ndihej i lodhur.

— Po më tërheq toka, — tha. — Më tërheq toka poshtë... Në moshën time, s'është lehtë... Thonë që të varfrin e plakin hallët... Ashtu them dhe unë. Jo pleqëria, por varfëria është bushtër plakë që e ndjek njeriun deri në varr... Por tani u bë... Unë po shkoj deri te Dafina e Pon Dukës... «U bë»

5.

«Bekuar qoftë toka e qielli dhe bekuar qoftë drita

jote, o i madhi zot! Po ti mos e thuaj se je i vetëm dhe që s'ka tjetër veç teje. Bekuar qoftë fjala jote, se-

pse përpara të gjithëve ishte fjala, po ti mos e thuaj më se kudo nderet vetëm pushteti yt i shenjtë. Shkreptimat e tua rënçin mbi kryet e armiqve, por çfarë nuk ka parë syri i njeriut? Dhe të gjitha ato që i pa syri i robit tënd, nuk i pa edhe ti, o fuqimadh?

Osmanët e rrafshuan kishën e madhe të shën Vasilit.

«Çjemi ne vdekatarët, përpara amshimit tënd, o perëndia ime?! Ne që këndojmë: bekuar qoftë shpirti i njeriut që fluturon si një zog ere! Po si nuk i mbajti dot dhimbja jonë ato themele të kishës së shën Vasilit?

Mos e thuaj më, o i plotfuqishëm; po ti vetë, që sundon në qiell, si nuk u shembe atëherë e të bije e të bëheshe pluhur; siç u bë pluhur kupola e bukur e asaj kishe?

Bekuar qoftë fryma që na jep jetë, po ti na braktise, o perëndi! E braktise veten tënde. Mbi themelet e vjetra dhe me ata gurë të latuar të kishës, të pafetë ngritën xhaminë e tyre. Se vakëfi mbi vakëf ngrihet o zot.

Në fillim qe fjala dhe ajo qoftë bekuar, po ti, o meshirëmadh, e braktise veten tënde, Kurse ne, vdekatarët e mjerë, si mund ta braktisim ne veten tonë. Ne jemi si ata gurët e themelit atje nën dhe. Mbi ta u ngritën kisha e xhami, mbi ta perënditë shartuakan njëra-tjetrën. Po deri kur kështu, o zot?»

Barba e mbylli radhuan e vjetër. Ai kishte dëgjuar se kishat qenë kthyer në xhami, por ajo që po dëgjonte tani, prej atyre murgjve orientale të harruar, ishte tjetër. Nuk ishte historia e fesë, apo e artit fetar. Ishte historia e jetës, më mirë vetë jeta që fliste për veten e saj.

«Si u shartuakan perënditë, o zot?» — pëshpëriti ai padashur fjalët që sapo kishte lëçitur në atë radhua të vjetër.

Hija e mbledhur kruspull në gjysmëterrën e kishës nuk lëvizi. Njeriu qëndroi ca kohë i heshtur e Barba nuk u ndie. Ata nuk e shquanin mirë fytyrën e njëri-tjetrit. Gjysmerrësira binte si një perde, mes atyre dy qenieve njerëzore.

— Nuk e kuptoj se si ndodhi. Edhe tani, kur e mendoj, nuk e kuptoj... — tha Ushtari.

— Çfarë nuk kupton? — pyeti Barba.

— Ne nuk kishim asnjë urdhër, — tha ushtari.

— Për çfarë?

— Na kishin thënë të vazhdonim udhën e të përgjigjeshim me zjarr vetëm po të na qëllonin. Ne ishim pararoja e divizionit. Fshatarët nuk na qëlluan.

Ishte një çopë jetë e zakonshme e atyre njerëzve. Barba dëgjonte rrëfimin e atij ushtari të panjohur dhe e ndiente se si midis fjalëve hyn-te pluskimi i pikës së shiut, që kishte nisur të rridhte prej çatisë. Deri atëherë Barba e kishte vështruar me një sy të vogël atë pikë shiu, ndërsa tani gjerba e saj po i bëhej e padurueshme. Barba nguli sytë mbi pellgun e vogël, ku, nëpër feksjen e dritës së kandilit, shkënditnin fluskat e ujit.

— Ne hëngrëm e pimë e pashaj rëvumë zjarrin gjithë fshatit. — thoshte ushtari. — Digjnim gjithëcka që gjenim përparë: shtëpi, kësulle, mullarë... Pse?

— Ushtarë...

— Po përse?

Xhenieri iu afrua Pietros.

— Si do vejë halli ynë? — pyeti ai i përkulur mbi tjetrin.

— Ruaj skeletin tënd, që të paktën të çosh diçka.

— Po a është skelet ky?

Zëri që pyeti sikur u çua më dysh.

— Skelet i thua ti këtij? — tha përsëri xhenieri.

Pietroja e vështroi atë njeri të shkurtër pa çorape, me këpucë të rënda ushtari, me këmishën e hapët, që mbante në mes të gjoksit leshtor një talisman. Pastaj ajo mjekër e gjatë, e thinjur, atë flokë të pakrehur, sytë e vegjël që i xixëllonin.

— Mjafton edhe ai, — tha Pietroja

— Mjafton?

— Po.

— Si do të vejë halli ynë?

— Shko e pyet atë, oficerin. Edhe këtu ai e njeri prapë ushtrinë e tij, nuk e pe? S'mund të rrijë dot ai pa ushtri. Sot i nisi ushtarët të vigjiloinë bregdetit. Edhe ti do të dalësh të bësh rojë?

— Po.

— E sheh? Ai skeleti yt hyka në punë ende.

— Ej! — Xhenieri bëri një çap prapa, pastaj iu afrua Pietros sërish... — Kemi njerëz andej.

— tha.

— Nga?

— Andej... matanë.

— Harroi ata.

— Si?

— Harroi. Do të bëjnë si do të bëjnë edhe pa ty. Për të paguar, paguajmë ne këtu. Dikush duhet të paguajë. Paguajmë ne... Ja i sheh ata të dy atje? — Pietroja tregoi me gisht dy ushtarë që po bisedonin me zë të ulët. — Unë e di, ata tani po i tregojnë njëri-tjetrit barceletat.

— A thua?

— Ta them unë... Ne italianët jetojmë brenda barceletave: «Starace<sup>1)</sup> fle me dekoratat ngjitur në pizhame dhe në gjumë murmurin se duhet të punojnë të gjitha organet e partisë fashiste, edhe organet e saj gjenitale...» Ne jetojmë brenda barceletave dhe brenda tyre vdesim.

Kryeulur e i menduar, xhenieri u largua prej andej, Sytë e Pietros shkuan tek ushtari i vogël. Përherë i heshtur, i qetë, gati i padukshëm, ai njeri sikur i fshihej edhe vetes. Pietroja shikonte këmbët e shkurtra, fytyrën e verdhë, vetullat kaqe nën atë ballë të vogël e katror dhe të gjitha dukeshin si të ngjitura me dorë. Ishte e çuditshme se si qe sajuar ashtu ai njeri.

Pietroja ndiente zemërim të brendshëm ndaj ushtarit të shkurtër. Heshtja fshehurake e tij e fyente deri në dhimbje.

— Ajo të dashuroi ty vërtet? — pyeti ai.

— Cila?

— Ajo... gruaja në fotografikë: të dashuroi vërtet?

— Oh! — ushtari i vogël vuri buzën në gaz.

— Ta rrëfeva një herë, — tha ai. — Ne u dashuruam në shkollë.

— Edhe ajo?

— Edhe ajo? — ushtari i vogël vuri buzën në gaz.

1) Starace ishte një nga krerët e partisë fashiste italiane.

— Edhe ajo...  
Çfarë mund të ketë dashuruar ajo grua këtë njeriu? Në fotografi ajo ishte një femër me sy të mëdhenj e si të etur. Çfarë mund t'i ketë pëlqyer ajo këtë xhuxhi, që edhe këtu bën jetën e hijes?

Me shikim të menduar Pietroja gjykonte çdo tipar të njeriut të shkurtër.

— Ajo s'mund të të dashurojë ty... Jo, s'mund të të dashurojë.

— Ushtari i vogël ngriti supet. Ai nuk u përgjigj.

Pas rrapëllimave shurdhuese të ditëve të luftës, më në fund, midis atyre shkëmbinjve, Xhino, Roveli u gjend fare vetëm me veten e tij. Dhe e kuptoi se kishte qëndruar mu në zgrip të fatit të vet.

Ajo që pati ndodhur nuk ishte thjesht mynxyrë e një ushtrie të tërë. Ishte edhe mynxypë e jetës së secilit.

Mijëra njerëz pa urdhër, pa komandë, mijëra njerëz që nuk dinin se nga të shkonin dhe pastaj, vetëm që të venin diku, ecnin drejt vdekjes së tyre.

Dhe i bëhej se kjo mynxvrë ishte shembur mbi atë, toger Xhino Rovelin. Tani ai po rrokullisej në fundin e greminës dhe, tek binte, shihte përmasat e llahtarshme të saj. Jo, kjo nuk mund të ndodhte vetëm se dikush kishte harruar diçka, se nuk ishte dhënë një urdhër. Ç'ndodhi atëherë? Ç'ndodhi? — pyeti oficeri përsëri veten. — Mund ta fitosh luftën, po edhe mund ta humbësh, gjithçka mund të ngjasë. Fundja? edhe herë të tjera ka ngjarë kështu!... Janë përmbys-



sur shtete e përsëri janë ngritur në këmbë. Ndër oficerët kishte nga ata që mendonin se Italia fashiste do ta fitonte luftën, ashtu siç kishte edhe nga ata që mendonin se kjo luftë prej kohe ishte e humbur. Por asnjërit nuk do t'i kishite shkuar ndër mend ajo që kishte ndodhur në ato ditë shtatori të vitit 1943. Askush nuk do të kishte guxuar të shihte me sytë e mendjes atë thertore të frikshme, te dyert e së cilës, pa pritur e pa kujtuar, ishin gjendur të gjithë.

Oficeri nguli shikimin thellë hapësirave të detit dhe pëshpëriti! «Ç'bëhet tani atje? A thua nuk e dëgjojnë kujën e vdekjes sonë këndeje? A thua janë shurdhuar?»

Këmishëziu po vinte drejt tij duke rrufitur një gaforre.

— Eh? — pyeti oficerin.

— Asgjë. Nuk shihet gjë prej gjëje.

— Të paktën këtu mund të zëmë gaforre.

Oficeri, me sytë që gërryenin horizontin, tha më tepër me vete:

— Italia... të mundja... vetëm sa ta shihja, si është tani ajo?

## VIII

1.

Mihali shtyu derën e drunjte të shën Triadhës, kanati u hap e, duke kërcitur, u kthye prapa. Partizani i ra përsëri me këmbë dhe hyri brenda. Po mbeti disa hapa larg pragut, sepse sytë iu errën në atë gjysmëterr të lagësht e erërëndë dhe nuk shihte dot. Ato fytyra të shkrehura që e vërenin në mugëtirën e piksur të kishës, ishin diçka e pakuptueshme, jashtë çfarëdo përfytyrimi njerëzor. Mihali kurrë s'do ta kishte besuar se njeriu mund të shpërfytyrohej ashtu. Ca sy të skërfitur po e shikonin me tmerr, thuse papritur u ishte shfaqur një përbindësh. «I zuri e drejta e fukarasë,» — iu kujtua Mihalit e thëna e një plaku, por ai e hodhi përnjëherësh tutje atë mendim. Pamja që kishte përpara ishte e llahtarshme.

— Mos kini frikë, unë jam partizan.

Askush nuk lëvizi prej vendit e askush nuk u përgjigj. Tmerri i vdekjes i kishte ngrirë ata njerëz, u kishte akulluar mendjen e shpirtin. Nuk besonin më në asgjë. Ndoshta, edhe shfaqja e papritur e atij partizani atje, ishte fare e pabesueshme për ta.

— Unë jam partizan, — tha Mihali, — a ke ni armë?

— E ku t'i gjejmë?

Më në fund regëtiu një zë në atë heshtje funddheu. Po ishte një zë njeriu e partizani ndjeu një çlirim të brendshëm të kraharorit. Ai mori frymë thellë.

— Po patët armë, na i jepni. Na duhen të luftojmë kundër nazistëve. — Pastaj ai tha: Kush të dojë, mund të vijë edhe vetë...

Pa e kuptuar ai po ecte nëpër kishë, shikonte të çdonjëri prej tyre, i shikonte me vëmendje, diçka u thoshte. Po ata kishin frikë prej tij. Partizani drejtoi trupin, ngriti kryet dhe pa rreth e rrotull. Ai nuk e mbante mend kështu shën Triadhën. Kur kishte qenë i vogël, kishte ardhur vetëm një herë këtu me Ndre Davidin, të atin. Po s'mbante mend asgjë nga këto mure të ftohta e të zhveshura, nga këto ikona të zverdhëlleme të shenjtorëve. Kisha i dukej tani tmerrësisht e vogël dhe e ulët.

— Ç'do të bëni ju këtu? Ç'kërkoni të bëni? — pyeti ushtarin që rrinte ndanë murit.

— Duam të shkojmë në Itali. Na kanë thënë se këndeje kanë ikur dy varka me ushtarë.

— Si ke ardhur ti këtu? — pyeti tjetrin.

Ushtari nuk foli. Shikonte partizanin nga poshtë-lart me dy sy të vegjël, të zinj, që diç donin të thoshin, por s'guxonin.

— Si ke ardhur këtu?!

— Gabova...

Zëri i ushtarit tingëlloi si në të qarë...

— Pse gabove?

— Unë jam nga ata të Drashovicës. Partizanët na çliruan prej gjermanëve, po ne s'qëndruam më ta...

— Si?!

Tani Mihali ë kuptonte së atij vetë po i shqy-heshin sytë për të parë më mirë botën.

— Dreqi e mori! Ç'bëhet kështu?... Po si dre-qin erdhe deri këtu? Unë nga Drashovica po vij. Ne atje luftojmë kundër nazistëve... — Atij iu kujtua Çezare Rokoja dhe pyeti: — A njih ndonjëri prej jush Çezare Rokon, është nga Si-cilia.

Vetëm tani ata njerëz zunë të luanin prej vendit, të ngriheshin e t'i mblidheshin përreth. Ato hije skelete dilnin nga fundet e errësirës ku ishin strukur dhe i vinin pranë; dëshironin ta shihnin, ta dëgjonin kur fliste, donin të bise-donin me të. Tani ata zunë të flisnin me dorë e me këmbë, duke ndërprerë njëri-tjetrin.

— Duam të shkojmë në Itali. Atje është atdheu ynë. Atje i kemi njerëzit tanë...

— Ç'faj kemi ne? Ne jemi ushtarë të thjeshtë...

— Si të quajnë ty?

— Karlo... Karlo Alfonsi.

— Ç'kërkon ti kënde, në këto vende të huaja, — i tha Mihali atij. — Kush të ka dërguar? Atdheu... Po ç'është ky atdhe që e dërgon Karlo Alfonsin të vrasë njerëz e të shtypë lirinë e të tjerëve?

— Unë jam ushtar i thjeshtë, — tha prapë italianin.

— E pastaj? A nuk duhet të mendojë edhe

ushtari i thjeshtë? Apo vetëm duhet të bindet? Vetëm të ecë, të marshojë, të vrasë?

— Po unë jam ushtar i thjeshtë! Porçà Madona!) — klithi kësaj here italiani. — Këto thuarja të atyre që na durdhërojnë...

— Përpiqu, — i tha Mihali atij, — përpiqu të më kuptosh. Ti je njeri, apo jo? Po te ti e kanë vrarë njeriun. E kanë vrarë mendimin tënd. Ti s'guxon të mendosh. Ti s'guxon të mbrosh Karlo Alfonsin... Ti mbron «ushtarin e thjeshtë»... E pse s'qëndrove në vendin tënd, të luftoje fashizmin... të ndërtoje atje një atdhe tjetër, të lirë e të drejtë? Si e ke katandisur ti këtë Karlo Alfonsin tënd? — dhe Mihali shënoi me gisht në kraharorin e ushtarit. — Kush përgjigjet për të?

Karlo Alfonsi mbylli sytë dhe ushtari i nimitur e i gurtë, qëndronte në këmbë para atij partizani që i fliste italisht. I bëhej sikur partizani po e peshonte me ata sytë e mëdhenjë të kaltër.

— Të paktën, dili zot tani Karlo Alfonsit... Përgjigju vetë para historisë... Pse nuk vjen me ne partizanët të luftosh nazistët?

Mihali buzëqeshi, hoqi kapën nga kryet, shpupuriti me gishtërinjtë e gjatë leshrat e verdha dhe i futi përsëri nën kapë. Duke qeshur, ai e pa Karlo Alfonsin në sy.

— Më kupton? — e pyeti.

— Si nuk të kuptojmë! — klithi një ushtar tjetër aty pranë.

— Duhet të më kuptoni... Sado e vështirë të jetë, duhet të më kuptoni, se ka momente në jetën e popujve, kur këta e kuptojnë që duhet të bëjnë kthesë dhe atëherë çlirojnë veten. Gjithë ai pisllek fashist në ndërgjegjen e njeriut, që të ngjall ndot, mund të pastrohet vetëm me luftë... Dhe gjithë popujt po luftojnë, edhe populli italian...

1) (ital.) — Ta marrë djalli!

Të rinj e të ndershëm, popujt po rilindin nga gja-ku i vet... Nazistët ju vrasin; ata i shfarosin italianët kudo që i gjejnë... Dhe ju jeni tmerruar prej tyre... Keni ardhur këtu, te kjo kishë e vdekur, për të vdekur. Po si nuk e kuptoni se, kur barbarisë i kundërvihet një popull i ndërgjegjshëm për luftën e vet, ai e mposht atë dhe fiton.

Kryeulur, me sytë në tokë, ata rrinin rreth atij partizani në atë kishë të vogël dhe as flisnin, as përgjigjeshin, vetëm dëgjonin dhe heshtnin. Ishin të vrarë në shpirt, të vrarë në trup. Nuk shihnin asnjë shpresë të re jete.

— Ky këtu është një vendthi i humbur, — u tha Mihali. — Mos shpresoni kot se mund të hidheni që këndeje në Itali. Këndeje edhe fshatarët nuk ju ndihmojnë dot. Kthehuni po në atë rrugë nga keni ardhur deri këtu, duke shkuar prapë anës së detit... Shkoni në Vlorë, nëpër fshatrat që luftojnë. Andej ka plot njerëz që do t'ju ndihmojnë. Bashkohuni me partizanët.

— Bukë... — erdhi nga pas një zë.

Partizani u kthye andej.

— Ku ta gjej bukën këtu?... Po pse nuk ngrihesh?

— Jam i sëmurë.

— Nuk çohesh dot?

— Jo.

Kandili e ikona ishin bërë njësh me atë fytyrë njerëzore të shkrehur e të hutuar. Sytë e të sëmurit kishin vënë cipë; ai kishte zjarrmi.

— Merre këtë, — i tha Mihali Sotirit, partizanit që kishte ardhur me të nga Drashovica. — Po ta lëmë këtu, do të vdesë. Lundra është fare e vogël, por do të bëjmë si do të bëjmë...

Sotiri qëndronte mëdyshas mbi ushtarin e sëmurë.



— Lundra është fare e vogël dhe është furtunë... — tha ai.

— Mos ki frikë se nuk mbytemi... — buzëqeshi Mihali.

Ai doli jashtë. Ndjeu ajrin e pastër, të detit që i mbushi mushkëritë dhe, me hapa të shpejtë, shkoi te lundra. Pas tij, me Luixhin mbi kurriz, vinte Sotiri. Duke shkelur nëpër zhuka, ai e lëshoi italianin te plori i lundrës. Edhe Mihali u fut brenda, vuri pushkën e gjatë midis gjunjëve e u mbështoll me kapotë. Sotiri shkuli plorin prej vendit dhe lundra e lehtë rrëshqiti mbi ujë.

## 2.

Lefter Pavli lëshoi nga supet, e veta te këmbët e Dafinës gjysmë thesi me miell dhe mori frymë thellë.

— Këtu e ke të gjithë, — tha ai, pastaj fshiu mustaqet me kurrizin e dorës. — Ma dhanë gratë e lagjes së Poshtme. Asnjë grusht nuk mbajta për vete... Të më besosh, Dafinë!... Se më vret zoti... Është për Drashovicën ky miell, është bukë e saj... Asnjë grusht s'kam fshehur për vete...

— Të besoj xhja Lefter, — murmuriti Dafinë duke e parë me dhembje. Por plaku hapi krahët dhe e vështroi i mallëngjyer në dritë të syrit.

— Për këtë kryq, Dafinë, në kam mbajtur gjë për vete, — dhe ai këputi kryet mbi kraharorin e gjerë e leshtor. — Lefter Pavli nuk e vjehd dot veten, moj bijë, — tha pastaj me zë të shuar.

— Nuk të dha gjë?

— Jo, — tha Piloja buzëvarur.

— Ti i kërrove dhe ai nuk të dha?

— Nuk më dha.

Maria e Gjakajve ktheu kryet nga dera. Kryetari i Këshillit qëndronte te pragu dhe nuk hynte brenda. Fytyra e zeshkët i që mpirë dhe zëri i fërgëllonte.

— Edhe dy pushkë më duhen, — tha Piloja, — dhe i armatos të pesë djemtë.

— E, moj Dafinë, a s'të kam thënë unë? Nuk ka burrë më kurnac se Zoi im. As ethet s'të fal Zoi.

Dafina kishte ulur deri poshtë mbi vetulla shaminë e ballit, kishte shpërvjelë mëngët e po mbrunte brumin në magje. Me djemtë fshati do t'u dërgonte edhe bukë partizanëve të Drashovicës. Dafina e dëgjoji se ç'tha Maria për të shoqin, vuri buzën në gaz, por nuk iu përgjigj. Kur ngriti kokën, ndeshi sytë e mëdhenj të nuses së Zoi Gjakës.

— Unë e di, se ç'mendon ti, Dafinë, po mua aq më bën... — Maria hodhi vandakun e xinave të thata në grykë të furrës dhe zuri të vërtitej nëpër odë si e xhindosur. — Më ka gjetur mua Zoi, pa të ishte grua tjetër, s'do ta bënte javën me të.

Maria ishte një grua e gjatë, flokëzezë, me sy të hirtë që lëviznin gjithnjë sikur kërkonin diçka. Në kokë mbante një shami me lule të kaltra, përparësja e qëndisur i mbulonte gjunjët.

— Vërtet nuk të dha? — e pyeti përsëri Pilon.



— Po mbase nuk ka, — rrudhi supet ai.

— Se ç'ka Zoi, e di unë, — tha me duf Maria. — Unë e ndaj me të shtratin... Poshko e kërkoi prapë... Thuaji: Zoi, më jep një pushkë sot, pa ne do ta kthejmë. Kështu thuaji: «do ta kthejmë». Se pa kthim s'të jep gjë Zoi. Unë e di se ç'kurnac i lig është ai dhe e ëma që i ka bërë kokën.

— Mjaft de! Se kush të dëgjon... — tha Dafina.

Për Marien e Gjokajve thoshin se gjithnjë grindej me të vjehrrën dhe të shoqin.

— Ashtu, moj shën Mëri? Ta mbyll gojën thua? Se do thonë bota që jam gojëçorape. Ashtu ë?... E po dëgjo, more Pilo!.. Shko drejt e në shtëpinë tonë. Merr shkallët e zbrit brenda në pus. Dëgjon ç'të them? Atje kërkto se do të gjesh pushkë... Dhe jo një...

— Në pus? — çakërriti sytë Piloja. — Po atje ka ujë...

— Ka dhe s'ka. Atë e di Zoi... A do armë për partizanët ti? Atje i ke, ku të thashë unë. Pastaj të më njihni edhe mua, edhe Zoin...

Maria e Gjokajve tundi me përcimim përparësen e qëndisur, iu afrua furrës dhe zuri t'i hidhte xina. Ata heshtnin të tre. Maria ua kish-te ngulur vështrimin flakëve dhe mëndohej.

— Shiko, Pilo, të keqen motra, — tha pas pak ajo me zë fare të zbutur. — Se mos i thua Zoit që të rrëfeva unë. Se ta dish, më vrau sonte... Pa druri, edhe po s'te the gjë ti, prapë ka për të kërcitur mbi kurrizin tim...

Dhoksia pa kokën e thinjur të të shoqit tek u përkul mbi derën e drunjtë. Ai zgjati dorën dhe hoqi mandallin. Gruaja pandehu se Jani do të ngjitej lart tek oda e miqve, siç bënte shpesh mbrëmjeve, prandaj priti te dritarja. Por burri qëndroi një hop në mes të oborrit, pastaj u kthye nga e djathta e nisi të zbriste shkallaret e gurta. Jani ecte ngadalë, si i përthyer mbi vete, drejt kasolles së qeve.

Mbi fshat po nderej muzgu. Brenda në kasolle errësira ishte më e dendur. Jani Leli shkeli mbi shtresën e trashë të kashtës së thatë dhe ndjeu grahmën e ngrohtë të plehut. Si me hamendje çapiti te qoshku e shtriu dorën mbi vithen e tultë të Larashit. Kau përtopej më këmbë.

— Të vjen mirë, ë? — Dhe nisi të kruante me gishtërinjtë e fortë lëkurën e kafshës. — Eh, kujt nuk i pëlqen, vëllaçko, ta kruajnë e ta kashasin? — Ai mendoi një herë të merrte kashainë te shtylla e dytë e kasolles. Po nuk shkoi atje, se nuk kishte ardhur për atë punë. Të tjera gjëra i buçitnin tani në kokë. E ndiente ende në vesh zërin e zotit Milo, që e kishte takuar atë pasdite në udhë e sipër.

— Ah, Jani, Jani... Po të shkon djali i vetëm, o lumëmadh, — i kishte thënë kryeplaku.

Janit i ishte dredhur zemra. Si? Po i shkonte djali?

Befas i kishte kërcyer gjaku në kokë. Ishte matur t'i zbrazej mirë kryeplakut, po, sakaq ishte stepur.

— Me shokë... zoti Milo.

Zëri i Janit ishte i zvergur. Kishte dashur ta

pështynte atë plak fytyrërreshkur që e zhbironte me ata sytë e vegjël xixëllues.

— Plot djem dolën nga fshati ynë për në Drashovicë... E pse jo edhe Nikoja im...

— Po është jetë, more Jani... — i kishte thënë Milo Ndreu.

Jani ia kishte mbërthyer sytë kryeplakut:

— Po prandaj, more zoti Milo, se është jetë...

Prandaj...

Dhe ishte larguar prej tij. Sapo kishte hedhur tri-katër çape, ishte penduar. «Po të shkon djali...» kishte murmuritur me vete. Si drejtin i qenë lidhur atij. Jani Lelit, duart e gjuha? Ndryshe duhej të kishte folur me Milon.

Jani u ul poshtë barkut të Larashit dhe nisi të gërmonte me duar shtresën e kashtës e të plehut. Ai rrëmihu një copë herë derisa më në fund e gjeti atë që kërkonte. Ashtu në të errët nxori një këllëf të madh të meshintë, të lidhur mirë. Aty kishte fshehur një pushkë të gjatë italiane dhe nëntë krehra fishekë.

E ngriti këllëfin me kujdes dhe e la te qoshku i kasolles. Teksa mbyllte derën, vuri re se kishte dalë hëna. Ai ngjiti ngadalë shkallaret e gurta dhe u drejtua nga shtëpia. Kur kaloi pragun e odës, Dhoksia po ndizte mbi tryezë llambën e vaigurit. Jani iu afrua i heshtur. Gruaja ndezi llambën dhe mori ta varte në mur mbi oxhak.

— Lëre këtu dhe më sill shishen e rakisë!

Zëri i tij ishte i lodhur. Gruaja hapi dollapin dhe nxori prej andej shishen dhe një gotë. Ajo e lëshoi gotën mbi tryezë, por i shoqi ia hoqi nga dora shishen dhe nisi të pinte.

— Ç'bën kështu?

Ai piu prapë.

— Prit të të jap ca meze, pak diathë...

E shkurtër e topolake, gruaja pa se si u për-

thye mbi tryezë hija e gjatë, thatime e të shoqit. Ajo kryqëzoi duart mbi bark dhe u tërhoq prapa.

— Të ziej një vezë?

— Jo.

Jani ktheu sërish shishen. Pastaj e shtyu mënjane, e afroi llambën dhe shtriu drejt saj pëllëmbët e hapura.

— Kur të vijë Nikoja, thuaji që e ka pushkën te koka e Larashit... Ai Piloja i gjorë po kërkonte armë nëpër fshat për të pesë djemtë. Nikoja nuk ka nevojë, ka timen. Në kasolle e ka. Atë të marrë djali...

Nuk donte të pinte më, po prapë e ktheu shishen. Dhe prapë e shtyu tutje.

— Grua, — tha ngadalë, — eja këtu!

Dhoksia iu avit pranë.

— Ulu, mos rri në këmbë... Na pi. — Ai e mbushi vetë gotën e ia dha së shoqes. — Dëgjo, — i tha ngadalë e me zë të butë. — Tani, çfarëdo që të ndodhë, ti do të durosh... Më kupton?

Gruaja nuk iu përgjigj. Edhe ai heshti një copë herë.

— Do të vësh një gur në vend të zemrës, por do qëndrosh... Se tani... je nënë partizani... Më kupton?

Ai nuk po ia ndante sytë së shoqes.

— Të kuptoj... — tha ajo me një zë të dridhshëm.

Atëherë Jani Leli u përkul përpara dhe sërish nisi të ngrohte duart në dritën e llambës.

Niko Leli e rrëmbeu për krahësh, pastaj për mesi dhe, pasi e ngriti lart, e futi atë në lundër. Gjena e Bleta jve u hepua e lëshoi një si klithmë. Duke u mbajtur me duar, ajo shkoi e u ul te plori. Zuri të shtrydhte fustanin e hollë, pastaj me të mbuloi këmbët. Mori frymë thellë e tha:

— Erdha...

Niko Leli rrinte para saj i heshtur e i ngrirë.

— Erdha... — tha ajo. — E sheh që erdha? Ti nuk më prisje?

— Unë kam këtu që në perëndim të ditës.

— Ranë të gjithë të fienë... edhe babai... Unë u çova t'i hidhja lëpushka kaut... Nesër do të niseni për në Drashovicë?

— Nesër.

— Edhe Pandi i Dakajve do të vijë?

— Do të vijë.

— Mbrëmë, ai vëllai im i dytë, Çimi, u zu keq me babanë. Çimi do që të dalë partizan, por babai thotë: martohu njëherë, lëmë mua në shtëpi një djalë e pastaj shko në mal.

Niko Leli i dha fushtagës dhe lundra e vogël rrëshqiti mbi valë. Ra heshtja. Vetëm fushtaga priste ujin e liqenit.

— Si u dukkan ullinjtë prej këndejl!... Asnjëherë s'i kam parë kështu...

— Ka rënë drita e hënës mbi ullinj...

Vajza ngriti kryet lart. Në një çip qielli shndriste hëna e plotë.

— Si qenka kështu!...

— Si është?

— Nata qenka shumë e madhe, — tha më shumë me vete Gjena e Bletajve.

Nuk folën më. Plori i mprehtë i lundrës shkiste mbi valë. Kaluan ca kallamishte dhe hynë më thellë në liqen. Gjena e Bletajve mendonte se gjithçka: liqeni, qielli, nata vetë, ishin shumë të mëdha...

Lundra u ndal. Vetëm atëherë vajza u kujtua se Niko Leli nuk po i jepte më fushtagës. Ai ishte ulur në bisht të lundrës, shikonte nga ajo dhe heshte.

— Pse nuk vjen këtu, shiko sa larg jemi. — Vajza zgjati dorën e bëri që ta zinte.

Ajo ishte një lundër e vogël, e hollë, e shtruar poshtë me kashtë të thatë. Niko Leli u ul pranë Gjenës në plor. Një copë herë ndenjën të heshtur, por vendi ishte shumë i ngushtë dhe vetiu djali u ul brenda në lundër e u mbështet te gjunjët e saj. Sytë e tij fëmijërorë u hapën. Ai pa mbi vete se si ngrihej shtatorja e brishtë e vajzës dhe shtangu.

— Unë erdha... — tha përsëri ajo.

Dhe ia mori kryet e mbuluar me leshra të butë të verdhë e ia vuri midis gjunjëve. Ai nuk lëshoi asnjë fjalë. Ishte fare i hutuar. Vazhët e shtynin lundrën gjithnjë nga veriu dhe Niko Lelit i kundërmoi nëpër ajër era ftonj të pjekur. Nuk po kuptonte gjë. Përse nata kundërmon-te atë erë ftonjsh të pjekur?

— Të gjitha vajzat e fshatit tonë dashurohen... Ti nuk e di... po të gjitha kanë djalin e tyre... Edhe Vasilika...

— Ti mban erë ftonjsh të pjekur?

— Unë? Jo... — dhe ajo qeshi — ... Është hëna, — tha pastaj.

Dhe të dy panë, lart, tek ai cip i qiellit ku nëpër tisin e reve rrëshqiste topthi i vogël i hë-

nës. Vajza zgjidhi shaminë dhe bashka e flokëve të zinj i ra nëpër supe. Ajo nisi t'i shkripte.

— Sa e bukur që je!

Ajo qeshi.

— Ti je fare fëmijë, — tha Gjena dhe u fut edhe vetë në lundër pranë tij. Ishin shtrirë mbi kashtë të dy.

Po rrinin ashtu kur vajza thirri:

— Uaaa! — ishte një klithmë habie fëmijërore. — Uaaa! Qielli... — E shtrirë në lundër, ajo shikonte qiellin që lëkundej e hepohej mbi të... dhe hëna ecte brenda asaj lundre qiellore... Gjena mori ndër duar kokën e Niko Lelit dhe e puthi.

— Sa të dua! Të dua shumë... shumë... — Pastaj si një shushurimë: — Unë s'kam puthur njeri tjetër...

— As unë...

Pranë lundrës u duk një pelikan i vetmuar. Si një njollë e bardhë, ai notonte plogëtas nëpër natën e liqentë. Gjena mbështeti bërrylat, tek ana e lundrës dhe ndenji e soditi e trishtuar pelikanin.

— Është i vetëm... — tha me zë të lartë. — Niko, pa ty, unë jam si ky shpend i bardhë që kërkon shokun natën. Ti do të ikësh, por, po më harronve...

Ai e rrëmbeu atë në krahët e vet dhe e shtrëngoi fort. Sakaq i tha se kudo që të ishte nuk do ta harronte kurrë.

— Më beson?

— Të besoj. — Pastaj: — Pse të mos të besoj? Unë vetëm ty të dua.

— Edhe unë.

Ajo zgjati dorën që të mos e linte të fliste, por ashtu rrokullisi një shishe.

— Çfarë, ti paske marrë verë?

Niko Leli i dha asaj shishen e verës. Gjena mezi piu një gllënjke. Edhe ai piu. Dhe ajo e pushtoi kokën e tij në kraharorin e saj.

— Niko, ruaj veten... Më degjon? — murmuriti ajo te veshi i tij.

Zeri i saj ishte i trembur.

— 'Ia dish, po të ndodhi gjë... Unë nuk jetoj dot pa ty... — Një afsh ngashërimi u këput nga kraharori i Gjenës. Ajo nisi t'i puthte sytë dhe ai ndjeu nëpër faqe, pastaj nëpër buzë se si rridhte currili i ngrohtë e i kripur i lotëve të saj.

— M'u ngron trupi, — psherëtiu ajo. — Kjo është hera e parë, unë vetëm ty të kam puthur...

Niko Leli pa i habitur përsëri atë hënë të plotë. Edhe pse kishte pirë verë, fryma e Gjenës i kundërmonte atij erë ftonjsh të pjekur.

— Uh, sa të dua! — tha ai dhe iu këput zëri.

## 5.

Mbrëmja zbriti e ftohtë dhe e lagësht, por andej nga deti u hap një copëz qielli. Pas pak shiu do të reshtte. Mihali dhe vullnetarët që do të niseshin për në Drashovicë u ngritën.

— Italianin nuk e marrim dot me vete, — i tha ai Dafinës. — Është i sëmurë. Le të qëndrojë këtu sa të shërohet. Të marrë ca veten, pastaj vijnë shokët dhe e nxjerrin në mal. Ai do të bëhet partizan.

Mihalit iu kujtua Çezare Rokoja dhe ndjeu mall për të.

— Ç'të të them tjetër, — i tha së motrës. — Ti je e zonja e i kupton vetë gjërat.



Motër e vëlla u përqafuan. Mihali puthi Lekën dhe, tek kapërcente pragun e derës, u kthye për njëherësh e iu afrua Luixhit.

— Ne po nisemi... më kupton? Shërohu shpejt, se do vijmë partizanët të të marrin. — Pastaj seç i tha edhe diçka tjetër dhe italiani më në fund qeshi.

Ishte hera e parë që ai njeri po qeshte.

— E shihni, — u tha partizani shokëve, — nuk është dhe aq vështirë që të qeshë njeriu.

Dafina me të birin i përcollën deri jashtë fshatit. Kur ata humbën nëpër muzgùn e trashë, Dafina zuri të çapitej drejt shtëpisë. Nga pragu i derës, e heshtur dhe e menduar, gruaja e peshoi me sy italianin. Ky e ndjeu shikimin e ftohtë të saj. Italiani ishte njeri i huaj dhe nuk mund të flinte aty. Dafina po mendonte se ku do ta vendoste, ku do ta fshihte. Asnjë vend tjetër nuk kishte, veçse në kasolle, te goshku i mbuluar me bar të thatë.

Atë ditë, kur nuk e priste askush, në Kodërdet u dëgjua buçitja e një tricikli. Motoçikleta që vinte bregut të detit u ndal mu në rrëzë të kodrës. Fshatarët nëpër vreshtat e ara e shihnin tek ecte si një qerre e vogël, por e sigurt, përmes kaçubave të zhukave e të marinave. Njerëzit lanë punën dhe me duart strehë në ballë ndiqnin rrëshqitjen e atij brumbulli të hekurt mbi ranishten kënetore.

Dy ushtarë të huaj kërcyen në tokë. Qën-

druan ashtu një copë herë, soditën liqenin dhe, kur ndien se këmbët iu shpinë, morën të përpjetën. Në fillim qentë e pastaj fëmijët e fshatit iu afruan ushtarëve të huaj, që flisnin në gjuhë të vet si ca zogj shtegtarë me zëra të ngjirur. Kur panë tregtoresh, ata u kthyen atje.

— Schnaps<sup>1)</sup> — i thirri njëri prej tyre dyqanxhiut.

Ishin gjermanë.

Fshatarët mbetën gojëhapur si qefujt mbi ujë. Ishin mësuar me ngathtësinë e ushtrisë italiane. Por gjermanët, pa shumë fjalë, të heshtur shkallmuan vreshtat e ullishtat, gërmuan gropa të thella dhe ngritën ca topa të mëdhenj, që të kallnin datën.

— Qen i punës, nemeja...

Barakat i sollën të gatshme dhe i futën si kutiza mishi në dhe. Në vreshtin e Lefter Pavlit ngritën mitralozin e rëndë kundërajror.

— Gjithë horrat që kur është zënë kjo botë, në kockat e fukarait i kanë bërë strofkat e tyre, — thoshte Lefter Pavli.

Lefter Pavlit i ndodhi edhe një fatkeqësi tjetër: e kafshoi në shpatull të majtë Ziushi i kryeplakut. Një pasdreke, Lefteri e mori kafshën që t'i jepte ujë në çezmë. Udhës gomari i kishte bërë veshët pipëz e kishte pallur. I ishte përgjigjur asaj pëllitjeje gomarica e Teno Çobanit, që ishte ngjaturar te plepi ndanë udhës. Gomari mori të shkonte te gomarica, por Lefter Pavli nuk e la.

1) (gjermanisht) — raki.

— Harroje atë huq, — i tha ai Ziushit e i dha gomange turçkave.

Gomari kishte pallura përsëri e përsëri atij ishte përgjigjur gomarica e Teno Çobanit. Kësaj radhe edhe Lefter Pavili e kishte shtruar mirë dorën dhe e kishte qëlluar kafshën nën bark, midis shalëve të pasme. Vetëm atëherë Ziushi ishte tulatur, kishte ulur kokën e, i zbutur, ishte nisur pas Lefter Pavlit që e tërhiqte prej kapistalli. Por s'kishin bërë as një copë udhë, kur gomari papritmas e kishte mbërthyer Lefter Pavlin me dhëmbë midis shpatullës së majtë sikur të ishte qen e jo njëthundrak. Lefter Pavlin mezi e shpëtuan fshatarët nga dhëmbët e kafshës.

— Edhe kjo s'kishte ndodhur ndonjëherë... As na e kanë parë sytë e as na e kanë dëgjuar veshët, — thoshin më pleqtë.

— Kanë ndryshuar kohët, — u përgjigjej Lefter Pavli. — Tani jo vetëm zotërinjtë, por edhe gomarët e tyre hanë mish njeriu.

7.

Kur dielli po perëndonte e rrezet e ftohta shuheshin mbi gjethet e figjeve, dy ushtarë nazistë u ndalën para derës së gurtë harkore të shtëpisë së kryeplakut. Milo Ndreu e dëgjoj vetë i pari goditjen e dorëzës së hekurt.

— Dikush na ka ardhur, — i tha së shoqës, duke zbritur shkallarët e duke hedhur krahëve xhaketën e kadifenjtë.

Fshatarët nuk godisnin me dorezë, ata thërrisnin që jashtë. Madje thërrisnin pa u afruar pranë shtëpisë. Ishte dorë tjetër kjo që qëllonte sonte në derë. Kryeplaku kaloi oborrin e shtruar me gurëz, të bardhë e, duke hapur derën, pyeti:

— Kush është?

Para tij qëndronin dy ushtarakë nazistë. Njëri prej tyre mbante të varur në gjoks një si qostek që e habiti kryeplakun. Sytë e tij u picërruan dhe ai iu afrua fare pranë të huajve. Në zinzhir ishte varur një pafkë dhe në të që shtypur një kafkë njeriu.

— Zoti Milo Ndreu?

— Unë jam, — tha kryeplaku. — Urdhëroni brenda.

Ai që mbante varur pafkën nxori prej xhepit të vogël të xhaketës një pusullë e ia dha kryeplakut në dorë. Ishte një kartëz, që ia dërgonte krushku i tij, tregtar në Vlorë. Ai i shkruante kryeplakut se «ky graduat gjerman është miku im dhe po ë dërgoj vetë te ti». Krushku i thoshte që të kishte besim se gjermanët i rregullojnë shpejt e mirë punët dhe e lajmëronte se «këto ditë do të formohej qeveria e re në Tiranë. Ashtu, duar-duar, ca nga Balli, ca prej të tjerëve. Ama, ne do të kemi prapë qeverinë tonë».

Kryeplakut iu bë zemra me krahë.

— Urdhëroni... — u tha gjermanëve dhe u priu vetë përmes oborrit të gjerë, lart nëpër shkallë, derisa u hapi derën e odës së pritjes. — Jeni si në shtëpinë tuaj, — pëshpëriti një thënie popullore, por nuk e njohu dot zërin e vet. Iu duk sikur po ligjëronte.

Oda e madhe, e gjerë, e lyer me gëlqere të bardhë të freskët, ishte një gëzim për syrin e miqve. Në atë shtëpi mbretëronte qetësia. Të dy gjermanët mbetën në këmbë në mesin e

dhomës, duke soditur qilimin e trashë me motive të vendit dhe përkresat e qëndisura në nime.

— Si në shtëpinë tuaj, — thoshte kryeplaku, duke hapur me gëzim të dy krahët.

Nazistët u çliruan nga armët që kishin me vetë dhe ia lëshuan në duar. Erdhi edhe e shoqja. Të huajt u përkulën para saj. Kryeplaku tha me zë të ulët: «Këta njohkan me themel zakonet tona.» Por e shoqja, duke parë fytyrën fare të bardhë të gjermanit, atë gjoks të madh me kokë të vdekuri në mes, i tha të shoqit:

— Ky të kallka krupën.

Kryeplaku zbriti poshtë në ahur e mbushi kabashin me musht rrushi të porsashtrydhur. Ai i gostiti miqtë. Ata pinë dhe ë lavdëruan shumë verën. Gjermani ngriti kupën e, duke qeshur, i tha kryeplakut:

— Ju po na dehni me diellin e jugut.

Dhe, ai e gëlltiti mushtin të tërë përnjëherësh. Kupat u mbushën përsëri dhe gjermanët donin përsëri të pinin, po Milo Ndreu zgjati dorën drejt tyre:

— Mos u shpejtoni. Këtu jeni në shtëpinë tuaj.

E shoqja e kryeplakut shtroi para miqve pjatat me meze. Era e peshkut të freskët u përhap nëpër dhomë. Kryeplaku i ftoi miqtë ta shijonin.

— Me atë që na dha zoti, — tha ai dhe me zërin e dytë lavdëroi gruan, që kishte shërbyer aq shpejt.

Gjermani që mbante kafkën në gjoks shijoi i pari mezen. Ai diçka i tha shokut të vet. Edhe ky provoi e diçka foli. Ata po bisedonin midis tyre.

— Mëlçi levreku dhe qefulli të Adriatikut të

fërguarë, — tha kryeplaku, që e kishte kuptuar përsë bisëdonin ashtu miqtë.

Ajo meze ishte fare e papritur për të huajt. Ata nisën të pinin mushtin e ri të shoqëruar me ato mëlçi të freskëta qefulli. Një mabrëmje si kjo, ata nuk e kishin shpresuar. Mushti bënte të vetën. Shpejt njëri prej miqve u shtri mbi nimin prej leshi. Atëherë në thembrat e çizmeve të tij diçka rrëzëlleu. Sytë e Milo Ndreut u zmadhuan aq shumë, sa gjermani pyeti i shqetësuar:

— Ç'ka ngjarë?

Me kupën e mushtit në dorë kryeplaku u afërua te këmbët e gjermanit.

— Potkonj? — pyeti ai dhe me gisht nisi t'i prekte ata. — Potkonj?

Gjermani e pa se habia e kryeplakut për potkonjtë e çizmeve ishte më e madhe se atje te porta, kur ai kishte parë kafkën e të vdekurit në gjoksin e tij. Dhe sëç i murmuriti shokut.

Milo Ndreu, tashmë hijerëndë, i tha së shpejtë që rrinte si e ngurosur:

— Kjo qenka qeveri! Kjo i mbathka edhe njerëzit me potkonj. Duçja nuk vlente një dhjetësh.

8.

— Nuk më kujtohet... — erdhi dëri te Domeniko Barba një zë tjetër. — Nuk më kujtohet... — Ai ushtari i Peruxhias, sykaltri, Agostini...

— Nuk më kujtohet...

— Bredh shkëmbinjve i çmendur.

Ishin xhenierët, që bisedonin midis tyre. Barba mbylli fletoren dhe bëri kryq.

— Vetëm këtë jo, Jezu shpëtimtar, — murruriti në vete. — Këtë jo...

Hodhi shikimin përreth dhe nuk shqoi asgjë. Kisha, muret, njerëzit ishin zhdukur dhe ai, i vetëm, qëndronte jashtë në mes të shiut. «Këtë jo, Jezu,» — dhe bëri përsëri kryqin.

Ishte hera e parë që lutej për veten. Deri atëherë falja kishte qenë për të një detyrë. Ai ishte «shërbëtor i zotit» dhe u shërbente njerëzve të tjerë. Kurse vetë donte të harronte gjithcka. Madje ai kishte harruar një pjesë të mirë të jetës së vet.

— Vetëm këtë jo... — pëshpëriti buzëdhundur Barba.

Andej nga fundi i kishës përsëri zhuzhuritnin zërat e ushtarëve. Ai mbajti vesh. Bisedonin prapë për të çmendurin. Barba dëgjonte e mendonte se nga të gjitha ngjarjet që kishte lëcitur në atë radhua të vjetër të shkruar nga murgjit, ajo e ushtarit të çmendur në tokë të huaj ishte më e hidhura.

9.

Dimo Villahu e peshoi gjatë me sy kryeplakun, kur ky kapërcëu derën e jashtme e u ndal në mes të oborrit. Qeni, i lidhur me zinxhir, lehu, po kryeplaku nuk e ktheu kryet andej. Ia mbërtheu sytë ahurit të bagëtisë të Dimo Villa-

hut dhe sikur u përumb. Diçka belbëzonte me vete.

Dimo Vllahu nuk shpejtoi. Ai zbriti shkallët ngadalë e u ndal te pragu. Dhe sërish e mati me sy Milo Ndreun. Por ky, pa e kthyer kryet nga i zoti i shtëpisë, i tha:

— Plot ahuri, Dimo vëllai, plot... Të ka lezet shpirti... Ahuri i zbrazët është si shtëpia pa njerëz. Ke ftohtë të hysh në të.

— Ashtu është, Milo... Po dëgjo... Do të më japësh pak atë Ziushin tënd, se kam një pelë që kërkon të hiqet... Dhe mua, ç'është e vërteta, më duhet një mushk i mirë.

— Tani e do Ziushin, në këtë kohë?

— Tani e dua. Drejo pelë, tani kërkon kalë...

— Sa do të më paguash për Ziushin? — buzëqeshi kryeplaku.

Ata po ngjitnin shkallët.

— S'prishemi për atë, — tha buzagaz Dimo Vllahu, teksa bluante me vete: Ç'e kishte shtyrë Milo Ndreun t'i vinte papritur në shtëpi?

Së shoqes, që po u vinte përpara gotat me raki, Dimoja i tha:

— Sillna shishen... Ky Miloja s'para vjen shpesh.

— Rrallë vij, por këtu te ti ndihem si në shtëpinë time.

— Në shtëpinë tënde je, o Milo.

— Ashtu qoftë! Tani e tutje, ndoshta, na e bën mbarrë zoti!... Po sa ditë e bukur! — tha përnjëherësh kryeplaku duke vështruar përtej dritares.

Dimo Vllahu pa përjashta qiellin e ngarkuar me re.

— I pe gjermanët, o Dimo? I ngritën bateritë. Po ç'topa, more! Kala, jo topa...



— Vërtet! U bëra kaq e nuk më kanë zënë sytë topa të tillë. Tundet dheu kur qëllojnë.

— Topat e Duçes paskan qenë lodra! — u hodh kryeplaku. — Gjermanët, more vëlla, qenkan qeveri! Po ku ta dinim ne? Ne kujtonim se ai Buzëviçi<sup>1)</sup> ishte bota. Kurse bota na qenka tjetër-kush... Tani të shikojnë këta leckamanët tanë, këta partizanët e Mihalit, se çdo të thotë luftë! Me gjermanin s'ka shaka, Dimo.

— Të lumtë goja, vëlla, ashtu... Domethënë, ti thua se do ta hedhim edhe kësaj radhe?

— Do ta hedhim thua? Hidh, mbushma gotën. Më erdhën në shtëpi gjermanët, e more vesh besoj... Fola gjatë me ta... Çfarë dite! Asnjëherë s'kam qenë kështu, i ngopur si sot. Po t'i lëmë këto... Unë Ziushin tim do ta jap. Kam menduar e kam menduar dhe e ndava mendjen...

Kryeplaku fliste për Ziushin, por nënkuptonte djalin e dytë, që donte ta martonte me të bijën e Dimo Vllahut, Helenën. Ata e kishin rrahur edhe herë të tjera këtë punë, por nuk ishin marrë vesh për pajën.

— Do të më japësh Kodrën e Vogël, — i tha kryeplaku Dimo Vllahut duke e parë drejt në sy.

— Kodrën e Vogël...

— Edhe 50 rrënjë ullinj në Arën e Harapajve...

— 50 rrënjë, — belbëzoi Dimo Vllahu.

— Bashkë, unë e ti, do të blejmë tregtoren e fshatit. Do t'ia japim pajë çiftit të ri. Dhëndri yt e djali im të punojë aty... Më kupton?

Dimo Vllahu lëvizi nga vendi. Ky dreq Milo po e rripte të gjithin... Po edhe më tej s'kishte pse ta zgjaste këtë punën e vajzës. Rast më të

---

1) Musolini

mirë se djali i Milos nuk gjente... Pastaj, kështu  
si po vinin kohërat, ku i dihej... Fundja, ullish-  
tën dhe tregtoresh dhëndrit do t'ia jepte, s'po ia  
falte botës.

— Të kuptoj, — i tha Dimoja kryeplakut.

— Tani e tutje, ne të dy, do të jemi një shtë-  
pi...

## IX

1.

U dëgjua një gjëzim i thellë. Toka u tund dhe sikur kërcitën muret e kishës. Kandili u shua.

— Nëna ime — ulëriu një zë i tmerruar.

Befas shkrepiti dhe përsëri një buçitje e fuqishme tundi dheun.

— Ç'është?

— Qetësi, djema.

Gjëmime të mbytura nisën të ndiqnin njëri-tjetrin.

— Qetësi, djema, bombardim...

— Bombardim?

Bombardim detar! — thirri oficeri nëpër errësirë. Ai brofi te dera e kishës, por atje, nëpër terr, u përplas me trupat e ushtarëve të tjerë, që kërkonin të dilnin jashtë.

— Betejë detare.

Duke shtyrë e sharë njëri-tjetrin, ushtarët suleshin përjashta e shihnin të habitur atë përflakje të detit e të qiellit. Një hop gjithçka shkëlqente, nata ndizej e, sakaq, përhapej ajo uturimë e thellë që perlante hapësirën. Të gjithë e ndienin vetën fare të vogël para atyre gjëmimeve. Sytë e tyre gërmonin fundet e qiellit ku dikush, si me një urë në dorë, rendte e ndizte thëngjijtë e asaj nate të mbushur me shpërthime. Pastaj gjithçka shuhej. Errësira binte sërish, e ftohtë dhe e shurdhët. Vetëm larg ajo shtynte atë ushtimë gulçuese të rëndë, që zvargej nëpër qiellin e ulët të bregdetit.

— Bombardim detar.

— Pas ishullit, — tha dikush.

— Imbecile!) Ashtu të duket.

— Pas ishullit.

— Mbylle!

Thellë horizonti vetëtiu përsëri dhe ata panë fytyrat e njëri-tjetrit.

— Zoti oficer, ç'është kjo betejë?

— Nuk besoj të jenë anijet tona.

— Mund të jetë betejë detare, ose ndoshta bombardim.

— Ka të ngjarë.

— S'është e mundur. Nuk e dëgjon? Ndihen goditje e kundërgoditje.

— Ç'goditje, more!

— Nuk i dëgjon? Imbecile! Mbaj vesh...

Një hije rrëshqiti nëpër terr.

— Ding! Ding! Ding!

Dikush u kthye pas.

— Është ai i Peruxhias, i çmenduri, — tha.

---

1) (ital.) — (sharje) hajvan.



— Të shkojmë në kodër.

— Shkojmë.

— Andej shikohet më mirë.

U nisën. Në fillim nxitonin, pastaj zunë të vraponin drejt kodrës. Tani sikur jetonin atje ku zhvillohej ajo betejë. Sikur e prisnin shpëtimin prej saj. Brenda disa çasteve ata ishin kthyer përsëri udhëve të luftës, ku patën ecur me vite, derisa kishin arritur aty, në atë kishë të braktisur.

\* \* \*

Syprina e zezë e detit u ndez. Ishulli i errët nxiu, i madh e kanosës.

— Është betejë e vërtetë detare.

— Bijtë e bushtrave, — thirri Ugoja. — Luftojnë, kurse ne nuk kapërcejmë dot as këtë govatë uji që kemi përpara. — Dhe ai ndezi një tufë letrash. Nisi të vërvitte zjarrin nga njëra dorë në tjetrën. Flaka ndriçoi përnjëherësh atë lëndinëz kodrinore. Hijet e shpërfytyruara të ushtarëve ngrinë në vend. Gjuhët e dritës u lëpiheshin nëpër fytyra.

— C'është ai zjarr? — thirri oficeri i tërbuar. — Shuaje atë zjarr! Shuaje, kafshë!

— Le të shohin... Ne jemi të gjallë... Ne jemi këtu, — ulërinte këmishëziu, duke kaluar flakën nga njëra dorë në tjetrën.

— Shuaje! — Oficeri u sul drejt tij.

Këmishëziu rendi poshtë nga bregu i detit.

— Ne jemi të gjallë. Ata, bijtë e bushtrave duhet ta dinë që këtu ka njerëz.

— Shuaje zjarrin!

Oficeri ngarendte pas tij. Ugoja fugonte me flakadan në dorë duke klithur:

— Nuk dua të vdes, qelbësira, dëgjoni? Nuk dua të vdes këtu. Le të shohin gjermanët, anglezët, amerikanët... Kush të dojë, le të shohë... Nuk dua të vdes këtu...

Ai u zhduk midis shkëmbinjve me flakë në dorë.

— Karonja!<sup>1)</sup> — Oficeri pështyu tokën — Karonja!

Drita e largët dhe e ftohtë e artilerisë detare përflaku sërish horizontin.

— Karonja...

I vetëm, toger Xhino Roveli u ul mbi shkëmbin buzë detit e mori kryet në duar.

— Njëlloj është, zoti oficer, — tha dikush pranë tij.

Këtë zë ai e dëgjonte për herë të parë.

## 2.

Kur nata trettej e agimi po vinte prapë i ngarkuar me re e shi, nëpër mjegullën e detit, rrëshqiti një varkë. Lehtas ajo hyri në gjirin e vogël duke lundruar midis shkëmbinjve të thepët. Njëri pas tjetrit pesë ushtarë nazistë kërcyen në tokë. Prej andej ata i hodhën një sy bregut, shkëmbinjve të zhveshur, pastaj kodrës së lartë. Këqyrnin vendet përreth e flisnin midis tyre.

— Ç'është ajo?

I pari shkoi vetë përpara. Ai shkeli ngadalë mbi lëndinën e vogël, më tepër i habitur, sesa i frikësuar. Tek i afrohej, nazisti nuk arrinte dot të

---

1) (ital.) — (sharje) Kërmë!

kuptonte se çfarë po bënte ashtu ai njeri i vetmuar. Te buza e humnerës Agostini hapte e mbyllte krahët, sikur të ishte pulëbardhë. Vetëm kur ndjeu se dikush iu afrua pranë, i çmenduri ktheu kryet. Sytë e tij u shqyen prej llahtarit, kur pa ushtarët nazistë.

— Ding! Ding! Ding! Bëërrr... — dhe u lëshua nëpër lëndinë. I çmenduri gati sa nuk e shtyu me trup gjermanin që i preu udhën.

— Italian.

Me automatikët krahaqafë, nazistët ndiqnin më sy atë leckaman që po fugonte para tyre. I vetëm, ai sulej turravrap nëpër tatëpjetën e kodrës dhe as ndalonte, as kthente kryet pas. Ku po vente ashtu?

— Shkojmë.

Të pesë u vunë prapë në rresht. Tani atyre dikush u printe përpara. Agostini rendte nëpër tatëpjetën e kodrës. Tëka ishte e njomë, ai shkiste, pengohej e përsëri ia kryste vrapit. I çmenduri shkonte në kishën e shën Triadhës. Me këpucët ushtarake të palidhura, me pantallona të lëshuara, ai sikur donte të arrinte sa më parë atje. Një hop u mbështet të t'fungu i vjetër i qiparisit dhe ndjeu se si i hovte kraharori prej lodhjes. Pastaj ngriti sytë e pa në qiell një re të vogël që po fluturonte. Në atë agim të ditës ajo re rrëshqiste e mbetej gjithnjë mbi majën e gjelbër të qiparisit, si një pikë e ngulur në qiell.

Në udhë tej u duk nazisti i parë. I çmenduri e pa dhe kërceu përpara. Ai donte të fshihej prapa kishës. Nazisti e la të bënte disa hapa, pastaj e qëlloi.

Kërr...

Agostini deshi të hapte edhe një herë krahët, po s'mundi.  
Breshërima e automatikut e preu nga pas:

me krahët gjysmëhapët ai u përkul, lëshoi këmbët e buta dhe me kryet goditi dheun.

Ata që ishin në kishë nuk patën kohë as të përmendeshin. Nazisti i parë i dha shqelm derës së drunjtë e hyri brenda. Pas tij hynë edhe të tjerët.

Në fillim sytë e gjermanëve nuk panë asgjë. Pastaj, nëpër gjysmëterr, ata nisën të dallonin lëmshet e trupave dhe fytyrat e heshtura.

— Italianë?

Askush nuk u përgjigj.

— Italianë? — pyeti prapë nazisti e, duke mbërthyer automatikun në gjoks, thirri: — Marsh në këmbë!

— E viva Hitler! E viva Musolini!

Drejt tyre brofi këmishëziu.

— Unë jam fashist, — thërriste ai dhe u bënë shenjë me duar e këmbë gjermanëve. — E viva Hitler! Mbrëmë, unë... zjarrë... zjarrë... zjarrë... unë jam «Kamicijanera»<sup>1)</sup>. «Kamarata», Shenja... Zjarre... Mbrëmë... në breg... nga ishulli... Zjarrë. Kamarata!

Nazisti i parë e la atë dhe nisi të çapitej nëpër kishë. Çizmja e tij u krodh në baltën e pellgut.

— Të gjithë jashtë, — urdhëroi.

Të heshtur, të frikësuar, ushtarët po ngriheshin nga vendet e tyre. Merrnin gavetat, kapotat, çantat dhe drejtoheshin nga dera e kishës.

— Jashtë! Jashtë! — ishin të tjetër që thërrisnin.

Filluan t'i shtynin, t'i godisnin. Pietroja kërkonte të ngrinte Marion.

— Gjermanët, — i tha ai.

---

1) (ital.) — këmishëzi, anëtar i partisë fashiste



— Gjermanët?

— Po, ngrehu... duhet të dalim.

Ushtari me ngofjen e sëmurë u përkul të ngrinte shokun, po i dhembti gjithë trupi, fytyra iu shëmtua e nofulla e poshtme iu hap.

— Nuk ngrihesh dot?

— Përsë?

Në atë kohë nazisti erdhi prapëloj.

— Marsh!

— Është i sëmurë, — tha Pietroja.

— Marsh!

— Nuk mundet dot... — Pietroja e kapi shokun me të dyja duart. — Ngrehu, — i tha.

— Nuk ka kuptim.

— Ngrehu, kafshë...

— Alles Hinaus!)

Njëri pas tjetrit italianët dilnin prej kishe. Dikush bëri kryq e nisi të falej. Edhe Barba nisi të falej. Pranë ajodhimës, përbrenda derës, dikush flaku çantën e vet.

Italianët i grumbulluan rreth qiparisit. Nazisti i parë dëqka foli në gjuhën e vet dhe ushtarët morën automatikët në duar.

— Unë fashist...

Përsëri Ugoja qëndroi para gjermanit të parë.

— Mos më vrisni, — thoshtë ai. — Nuk dua të vdes këtu, më kuptoni? Nuk dua të vdes këtu!

Nazisti e shtyu dhe nuk tha më asnjë fjalë. Pietroja pa pranë oficerin. Shikimet e tyre u kryqëzuan. Ishte fundi.

— Ç'duan të na bëjnë ata? — pyeti dikush aty pranë Xhino Rovelit.

Ky ndjeu mbi vete sytë e atij ushtari trupmadh që, i heshtur e i palëvizur, mbështetur mbi

(1) (gjerm.) — Të gjithë jashtë.

shkopin e vet, vazhdonte të shihte vetëm atë, Xhino Rovelin. Ata sy të mëdhenj e të zez po i flisnin. Vetëm tani oficeri pa se si midis dy vetullave të Pietros kalonte një rrudhë e thellë që i lëshohej poshtë, përmes ballit. Nazistët u qasën më pranë e Xhino Roveli ndjeu se këmbët po i zbuteshin. Diç i mungonte, nuk kishte më ajër.

— Ç'bëjnë kështu?

— Po na vrasin.

Ato fjalë u thanë si me frikë, sakaq të gjithë u mekën. Një copë herë pas atyre fjalëve: «po na vrasin», pllakosi heshtja.

— Po përse?

— Përse?!

— Përse?!

Dikush shkoi drejt gjermanëve. E shtynë. Dhe ai humbi përsëri midis shokëve. Ishin të pambrojtur. Ishin të pafuqishëm.

— Djema, mbahuni!

— Po ky është fundi.

— Si fundi?

— Fundi.

— Po përse, o zoti im! — tha prapë ai që tani vetëm çirrej. Ai kapi Barbën prej krahu.

— Nuk mundet, — tha, — këtu jo...

— Falju zotit.

— Jo! — thirri ai tjetri. — Nuk dua të vdes këtu.

— Mjerë ne!

— Nëna ime!

— Nuk bën kështu, djema.

— Këta janë bisha.

Xhino Rovelin kishte ngulur shikimin andej nga deti. Andej ishte gjithë jeta e tij, fëmijëria, kujtimet.

— Po na vrasin!...

Italianët u shtrënguan rreth njëri-tjetrit. Ta-

shmë nuk ishin një grusht njerëzish, por një njeri i vetëm. Dhe sytë e atij njeriu nuk shikonin më, veshët nuk dëgjonin, goja nuk fliste. Ai njeri-grumbull, ajo qenie e përbashkët ishte mpirë. Tani ajo nuk kuptonte se ç'po ndodhte me të.

— Po është jeeetë... — psherëtiu një zë... —  
Po përse... përse...

Oficeri ndjeu se trupi iu bë fare i lehtë. Këmbët i ishin qullur nga djersa. Ktheu kryet e pa trupin e lartë të Barbës. Sytë e ushtarit, të futur thellë në gropëza, të mbuluar me një cipë, po e vështronin ngultas. Oficerit iu bë sikur dikush tjetër ra e humbi diku brenda tij, si një gur i rëndë që bie nëpër grykën e një pusi të thellë. Dëgjoi zhurmën e atij trupi që u mbyt nëpër të. Dhe asgjë. Nuk ishte më as shën Triadha, as qiparisi, as ushtarët. As ai vetë nuk ishte më.

— Oh!

Dikush e mbërtheu prej mæsi. Pastaj më pohtë, te kofshët, te gjunjët.

— Oh, edhe unë jam oficer...

Ai i hodhi sytë atje: te këmbët e tij kishte rënë ushtari i vogël.

**Fytyra e njeriut, që ishte gjunjëzuar, mban-  
te gjithnjë dritën e kandilit të kishës.**

— Unë jam oficer...

E dija... — ishte Pietroja ai që foli.

Ata zëra u mbuluan nga breshëritë e automatikëve. Flakërimat e copëtuarë verdhë-mavi ia venbuan shikimin Xhino Rovelit. Ai kërcëu përpara. Befas ndjeu një të prerë në trup. U përkul, pastaj u ngrit sërish e duke u kalamen-  
dan, eci me opingat bregase në këmbë drejt  
trungut të qiparisit, hapi krahët, e pushtoi dhe  
ashu ra përdhe.



nuk kishte pasur dhe Dafina i kishte kërkuar Lefter Pavlit një palë opinga të vjetra. Lefter Pavli kishte sjellë «më të reja», por ato ishin trokëre tepër të gjera. Me sytë e mëdhenj e të kaltër, grudja e hetoi gjatë italianin dhe nuk u bind. Kushdo që ta shihte Luixhin e kuptonte se ai ishte i huaj. Sido që ta vishje. Ai kishte një fytyrë fare të vogël, nofulla të imëta, buzë të holla dhe ca sy të vegjël e të druajtur. Italiani thoshte se ishte fshatar, por Dafina nuk e besonte. Duarte e tij ishin të lehta e të njoma si të një vashë. Dafina s'kishte ç'të bënte. Tërë natën kishte bluar me vete dhe më në fund e vendosi që ta mbante mbyllur. Nuk do ta nxirrte gjëkund italianin, derisa ky të shërohej mirë. Pastaj do ta dërgonte në mal. Kështu i kishte thënë edhe Mihali.

— Këtu, — tha ajo duke treguar strofkën e barit. — Ti do të fësh këtu.

Luixhi u bind si një fëmijë i druajtur. Ai e kishte frikë këtë grua shtatlartë e të fuqishme, që i fliste atij vetëm shqip dhe vetëm një herë. Ajo ishte e bindur që italianin e kuptonte. Nga strofka e barit, Luixhi pa kësollen që shtrihej si një qyngë gjatë, murin e murrmë prej lesash, derën që e kishin lënë hapur. Pranë derës, lidhur me zinxhir, ishte një qen i zi me një balë të bardhë midis ballit. Qeni hungëronte, shtrinte këmbët e para në tokë e tundte bishtin në ajër. Sigurisht që i përgëzohej së zönjës, Luixhi i hodhi sytë te Dafina. Një pësh i lehtë i artë mbulonte faqet e saj. Italiani hapi gojën, diçkë deshi të thoshtë, kur pa rreth atyre buzëve një zinxhir të imët djersë. Një hop sytë i rabetën te sytë e saj të mëdhenj të kaltër, pastaj te shamia e zezë në kokë dhe krelat e verdha mbi tëmtha. Dafina ishte një grua e bukur, por ajo e kishte nxjerrë atë nga

shtëpia që natën e parë, me të ikur Mihali. Luixhi mbuloi fytyrën me duar.

— Ky po qan, — murmuriti Dafina me vetë. Ajo shkoi, zgjidhi qenin dhe, duke e mbajtur prej zinxhiri, u kthye përsëri te fundi i kasolles.

— Merri erë ta njohësh, — i tha Korbecit, duke i treguar italianin.

Ndonjë supë e hollë me mish zoge, ndonjë vezë e freskët, që Leka ia jepte sapo e pillte pula në furrik, ndonjë kupë musht i porsashtrydhur po ia kthenin shpirtin në vend Luixhit. Në mëngjes e në mbrëmje Leka i çonte atij që ta mëndte vetë, si ndonjë sheleg, kërrutën e bardhë. Dafina nuk e milte më atë dele.

Një ditë, kur gjëkund i s'ishihej frymë e gjallë, Luixhi u ngrit prej strogës së vet. Bagëtia kishte dalë dhe një qetësi e thellë mbulonte vendin. I bëhej sikur dikush tjetër merrte frymë aty pranë. Ai ndenji një copë herë në këmbë, bëri të ecte, po iu morën mendtë e ra në tokë.

— Nëna ime! — pëshpëriti me vetë. Pa me kujdes rreth e qark. Gjithçka ishte në vendin e mëparshëm: edhe dera e hapur, edhe thuprat e varura ku flinin në mbrëmje pulat e dëbit, edhe fundi i mbushur me bar të thatë... Gjithçka ishte atje ku kishte qenë, por atij i shungullonte koka. Shikimi iu vagëllua. Ndenji ashtu shtrirë mbi dhe, derisa bota nisi prapë të agonte përreth tij. Atëherë, ngadalë, nisi të çohet në këmbë. Iu duk se nuk po ngrinte trupin e vet, por një skelet, skeletin e një tjetri. Ai dëgjoi edhe kërkëllitjen e eshtrave të atij skeleti. Ashtu ato eshtra të shkrehura po shkonin në vend.

Befas, pa e kuptuar përse, ai nisi të thoshte me vete fjalët shqip që ia mësonte Leka: bukë, dele, qumësht, pulë, qeni, veza...

Ditën tjetër Luixhi mezi çapiti deri te dera e kasolles. Ajo botë që pa përjashta iu duk e largët. Qenë larguar lëndina, korija e gjelbër e dafinave, varreza e vogël e bardhë e fshatit, kisha, ullinjë. Edhe dita sikur po largohej e po humbiste tutje.

U ul aty, te pragu i derës, dhe e mbështeti kokën te lesa prej thuprash të njoma. Përnjëherësh e mori gjumi.

Dafina e gjeti të shtrirë në tokë si ndonjë këlysh që shullëhet dhe ia ka kthyer barkun diellit. Ajo i kishte nxjerrë të kullofnin që në mëngjes herët pulat e detit. Kishte menduar t'i bridhte nëpër çep plaz e ranishte deri në të thyer të ditës. Por, në rrugë e sipër, kishte takuar kryeplakun. Një zot e di se si e qysh Milo Ndreu ishte gjendur në ranishte në atë orë.

— Po i kullot pulat, Dafinë?

— Po i kullo, — ishte përgjigjur gruaja, që e kishte ndier se ai takim nuk ishte për të marrë. — Po ju, pse këndej? — e kishte pyetur ajo.

Sytë e kryeplakut ishin përskuqur, ai sikur ishte rrëguar.

— Pse, mos duhet t'i marr leje ndonjërit? Kujt? — kishte pyetur zoti Milo me ligësi. — Kryeplak jam unë këtu, unë jam qeveria dhe shkoj ku të dua...

Nuk ishte më ai i asaj mbrëmjeje kur ata ktheheshin të dy nga qyteti. Zëri i tij nuk ishte

më i butë, njerëzor, Ai plak tani dukej si qen i ndërsyer. Gjithë fshati kishte mësuar për miqësinë e tij me gjermanët. I kishte dëgjuar ato fjalë edhe Dafina.

— Ku është tani ai? — kishte pyetur befaz zoti Milo.

— Kush?

— Ai...! — kryeplaku nuk donte ta përmendte emrin e Mihalit. — Yt vëlla... — kishte thënë pastaj — ...partizani...

Dafina ishte dredhur e tëra. Kishte ndier gjakun që po i zbriste te thembrat e këmbëve. Por atij i kishte thënë:

— Zotrote e di mirë se ku është ai.

— Si janë partizanët?

— Cilët partizanë?

— Partizanët, që kishe parmbremë në shtëpi. Ç'pandeh ti, moj kunadhe, se gjermanët hanë bar? Apo ha bar Milo Ndreu? Shokët e guerilës, që fjetën te ti e hynë pastaj në qytet, nuk të thanë ata se ku është yt vëlla? Po italianin si e ke, moj Dafinë? Apo edhe atë nuk e di? Deri tani të kam ruajtur, moj nusja e Pon Dukës. Po qysh asaj nate, në atë mbledhje të fshatit, i thashë vetes: «Tuhaf paske qenë, Milo, tuhaf! Dhe më hiqesh burrë me një barrë mend në kokë, kurse ti më paske qenë fyçkë e shkuar fyçkës. Si e ke mbajtur kaq vjet gjarprin në gji?»

— Ç'ke me mua, zotrote?

— Ç'kam me ty? O, moj keçe e babait... Tuhaf paske qenë, Milo... — tha kësaj here me vete kryeplaku duke e parë gruan me sytë gjak.

Sytë e atij plakushi nuk mund të durohehin.

— Bëje tënden, zoti Milo! Po mos harro se dy



duar për një kokë janë! — i kishte thirrur Dafina në turinj.

— Bushtëri!

— Mbjaj gojën se vijnë prapë ditë dhe e kafshon atë gjuhë!

Gruaja kishte mbledhur tufën e pulave të detit dhe i kishte vënë përpara. U binte me shufër kraheve, sa shpendët fluturonin. Edhe ajo mend turrej pas tyre. Ashtu, me një frymë, kishte mbërritur në shtëpi. Dhe e kishte gjetur Luixhin që flinte nën ato rreze dielli te pragu i kasolles.

Ajo pa fytyrën e bardhë të vogël dhe gjoksin e ngushtë të atij njeriu të shtrirë në tokë, te këmbët e saj. Ai ishte fare i pafuqishëm, i pambrojtur dhe nuk e dinte se ç'rrezik i kanosej tani. Ajo qenie e vogël njerëzore po i gëzohej diellit, kur vdekja. Gruaja e hoqi mendimin prej andej, por në fshat të gjithë e kishin mësuar se ç'kishte ndodhur me italianët e Shën-Triadhës. Dafina ndjeu një të ftohtë t'i derdhej nëpër trup.

— Ngrehu, — dhe ajo e shtyu me këmbë Luixhin.

2.

Dafina po ndizte zjarrin në vatër, kur iu bë se dikush erdhi te dera. U kthye andej e pa një këmbë të zbathur, njeriu, që kapërceu prapun. Ishte Lefter, Rayli. Me gjoksin e shkopsitur, me fanellën e leshtë bërë këllirë nga djersët, me mustaqet e pakrehura, fshatari qëndronte ngulur te pragu i derës. As hynte brenda e as luante

prej andej. Dafinës i mbeçi zemra në kraharor.  
Ajo e kuptoi se Lefteri sillte lajme të këqija.

— E gjora ti, këtu e paske këtë? — tha Lefter Pavli duke hedhur sytë mbi Luixhin, që rrinte ulur mbi dysheme të dhomës. — Po vij drejt e nga kushëriri i gruas. Atij ia bástisën shtëpinë gjermanët... Nesër gjermanët i ke këtu.

— Ç'duan ata nga unë? — tha e habitur grua-ja.

— Italianin...

— Po të mos e jap?

Sytë e rrudhur të Lefter Pavlit u mbyllën më shumë. Ai tundi kokën.

— Unë nuk të them t'ua japësh.

— Po ç'të bëj aherë? A e merr ti?

— E ku ta shpie unë? Fshati, ti e di, është si një fole zogu në duart e gjermanëve. Ku ta çoj unë këtë? Sos është zog ere që të fluturojë!

— Shpjerja kryeplakut drejt e në shtëpi. Thuaj na, në dorën tënde, nga partizanët! Po e gjeti gjë, ke të bësh me ta!

— Tani jo, — tha Lefter Pavli. Ai erdhi e u ul në qoshe të vatrës. Ka marrë shumë forë ndyri rësira, — tha pastaj. — Që kur erdhën gjermanët në fshat, nuk përmbahet më. Turfullon si kalë i harbuar. Më përpara, të mos më thoshin Lefter Pavli, mor le të më dhisnin mustaqet, po të mos ia bëja ashtu, siç më thua ti. Po tani jo...

Dafina qëndroi një grimë mëdyshas. Sytë e saj të menduar po përpinin zjarrin e vatrës.

— E dëgjove se ç'bënë gjermanët me italianët andej nga Shën-Triadha? Ky nuk duhet të vdesë... — Ajo grua nuk donte ta kthente kryet nga Luixhi. Kishte frikë mos e tradhtonin sytë. Nuk donte që ai ta kuptonte se asaj i vinte këq!

— Dafinë, dëgjoje Lefterin. Në mos sot, nesër, gjermanët i ke këtu.

— Pije kafën. Dhe dëgjomë mua... Do shkosh te kryeplaku, Milo Ndreu, e do t'i thuash që Dafina e përzuri italianin, qysh dje, kur ai më takoi tek kullësja pulat e detit... Se më foli edhe për këtë... Unë, sapo erdha në shtëpi, e përzura italianin. E përzura, më kupton?

Lefter Pavliu u çua.

— Do të bëhet s'inthua ti, — tha ai dhe doli jashtë.

### 3.

Ishin vetëm, ajo dhe djali. Ishin fare të pafuqishëm. Dafina po rrinte në mes të oborrit të shtëpisë si një qenie e trullësuar, që dikush e ka goditur në kokë e i është errur shikimi. Zgjati dorën dhe u mbajt te Leka. Pulat e detit e delet ishin futur në kasolle. Edhe Luixhi ishte shtrukur në strofkën e vet. Hijet e natës u ndërën mbi fshat e në qiellin e afërm u zgjat silueta e qiparisit të varrezës së vogël ndanë kishës.

— Nënë, mos je gjë sëmure?

Zëri i djalit ishte trembur. Por ai zë e përmendi Dafinën. Duhej të mendonte për Lekën. Sikur nazistët ta gjenin tek ajo italianin, mund ta pësonte edhe Leka. Mos vallë do ta humbiste djalin? Gruaja u drodh, thuase po i rridhte në trup ftohtësia e asaj nate. Hijsa e ftohtë e qiparisit i ngriu në bebëza. Dhe vetiu murmuriti: «Hapu, varr!» Ato fjalë sikur i kishte thënë një tjetër aty pranë. Dafina mbajti vesh dhe u duk se dëgjoi po atë fjalë: «Hapu, varr!»

— Hapu, varr! — murmuriti përsëri ajo. Dhe

atëherë e kapi mendimin që i vinte nga thellësi e shpirtit. Ia shtrëngoi djalit krahun. — Lekë, — i tha, — ndoshta na ndihmon babai... babai ynë... Por befaz ndjeu një frikë që s'e kishte provuar kurrë ndonjëherë. Bëri kryqin, — O zot! — ofshëtiu me një zë që iu shua në buzë. — Më fal, o perëndi, se po hyj në hisen tënde... — Psherëtiu gjatë dhe i pëshpëriti të birit: — Më sill kazmën.

Djali nuk e dëgjoi fare atë zë të nënës. Ai tani mezi e shquante Dafinën në errësi. Një hop ndjeu frymëmarrjen e saj të rëndë dhe u tremb. — Të thashë, shko e merr kazmën!

Leka u kthye pas e, duke rendur, shkoi në kasolle. Dafina mbeti e vetme. Hijet e asaj mbrëmjeje po bëheshin edhe më të zeza. Ullinjtë ngriheshin të mëdhenj e të trishtuar në atë qiell të vetmuar fshati. Gruaja e ndiente veten fare të vogël, të pafuqishme. Ajo nuk guxonte të bënte as edhe një çap drejt varrezave. Leka e gietti të ngurosur atje ku e la. Ai solli kazmën. Dafina nuk e mori. Ndoshta nuk u besonte më duarve të veta. Por prapë u nis. Ngadalë, e heshtur, i bëhej sikur po shkelte mbi eshtra të vdekurish.

— Të keqen nëna, unë nuk mundem, po dil ti edhe një herë rreth e rrotull, shiko mos ka njeri.

Dafinës i ishin errur sytë, por veshët i dëgjonin shumë. Ajo i druhej çdo fëshfërimë gietheie dhe ligjërimit të zogive të natës. Si në ëndërr hvri në varreza dhe eci drejt varrit të të atit. Dicka deshi t'i thoshte atij, po nuk mundi. E trembte ajo pllaka e madhe e gurtë e varrit. Gruaja e preku atë me dorë. Ftohtësia ia ngjethi trupin, por e solli në vete. Po kthjellohej. Vuri dorën

për të parë në mund ta ngrinte dot pllakën, por e kuptoi se ajo vetë po mbahej atje.

Fuqitë iu prenë.

— Nuk ka njeri, — tha Leka që erdhi aty. Ai u kishte rënë përqark trojeve dhe nuk kishte pikasur gjë.

Dafina zgjati dorën dhe e afroi pranë vetes të birin.

— Këtu, — tha ajo duke i pëshpëritur. — Këtu do ta fshehim italianin... Në varr të babait... Po unë nuk kam fuqi fare... Provoje, njëherë ti, o bir, se mos e ngre dot pllakën.

Ajo pëshpërimë gulçuese e nënës, e pushtoi edhe Lekën. Pa kuptuar se ç'bënte, ai po rrekej ta ngrinte pllakën lart, por s'po mundej dot. Provuan të dy bashkë, nënë e bir. Dhe përsëri nuk e lëvizën prej vendit. Ai varr nuk donte të hapei. Dafina u shtang. I ati nuk pranonte të tjerë atie poshtë... Ajo bëri krycin.

— Ne do të shqim pak dhe, fare pak, sa të futet luixhi. — murmuriste me vete gruaja. — Ata nuk do ta vrasin... Nuk do ta vrasin dot...

— Mirë, — tha Leka.

Vetëm tani djali e kuptoi mendimin e nënës. Duke i ardhur përqark varrit, ai futi gjuhën e kazmës nën rrasë dhe peshoi i tëri mbi të. Pllaka lëshoi një gërvimë. Leka e futi përsëri buzën e kazmës dhe e tërhoqi anash. Pllaka lëvizi pak. Dafina rrinte në këmbë, shihte të birin që punonte dhe e kuptonte se vetë nuk mund ta ndihmonte. E megjithatë ajo tha:

— Natën kazma dëgjohej... Lehtas... lehtas...

Kërcëllima e shurdhër, e kazmës i bëhej asai si një gulçim i rëndë. Ajo pa Lekën që u përkul pranë dhe, duke dihatur, u bë njësh me varrin. Zemra e nënës u drodh. Djali sikur po kërkonte shpëtim nën atë rrasë. Vërtet, po sikur nazistët

ta gjenin në shtëpi të tyre Luixhin? Kushedi se ç'e keqe mund t'i ndodhte edhe Lekës. Ky mendim që s'po i shqitej e përmbloodhi Dafinën. Luixhi duhej shpëtuar medoemos, që të shpëtonin edhe ata, që të shpëtonte edhe Leka. Tani fati i atij njeriu ishte edhe fati i tyre.

— Prit, — i tha ajo të birit. — Zëre fort, rëndo i tëri. — Dhe vetë mbërtheu fort me duar buzën e pllakës.

Dafina mbështeti dy gjunjët te guri i varrit, shtrëngoi nofullat e u dha krahëve. Rrasa u ngrit. Ngadalë ata e mënjanuan pa e lënë të binte në tokë.

— Kujdes... ashtu... ashtu...

Gruaja nuk shikonte dot brenda. Ajo qëndronte me duart mbërthyer në atë rrasë e nuk guxonte të hidhte sytë nën të. Ai varr ishte hapur. E kishte hapur vetë ajo, Dafina, e bija e Ndre Davidit. Midis gjetheve të gjera të dafinave, ajo pa yjtë e qiellit. Ishin ca yj të vegjël e të largët. Qielli nuk i qe dukur asnjëherë aq i thellë dhe i ftohtë. Dhe aq pa kuptim.

— Ky qenka i thellë...

— Vetëm kur dëgjoji zërin e Lekës, zemra e Dafinës u drodh. Ngadalë ajo lëshoi sytë poshtë. Leka kishte futur brenda krahun e vet.

— Është i thellë, nënë.

Edhe Dafina futi krahun e saj. Toka, e butë, e thatë ishte ngjeshur në atë varr të madh sikur ishte ulur vetë më poshtë, që të pranonte atë tjetrin, Dafina ofshani, këmbët iu prehë e, duke u ulur në tokë, mbështeti ballin te varri i babait. Dhe qau pa zë.

Kryeplaku ishte i sigurt se italiani strukej aty. Ai ishte qeveria e fshatit dhe qeveria, domos, ka veshë e sy të mëdhenj. Italiani ishte aty e s'kishtë se ku të shkonte. Gjermanët do ta gjenin, pa një pa dy, madje pa u ngutur. Kur dielli kishte dalë mbi majë të kodrës, Dafina dëgjoi Lefter Pavlin që thërriste:

— Ku ta ngjatoj gomarin, o Milo?!

Atij nuk iu përgjigj njeri. Atëherë gërthiti së rish.

— Ku ta ngjatoj gomarin, o kryeplak?

Ushtarët nazistë po zbrisnin poshtë! Kryeplaku ecte në këmbë ndanë tyre. Dafina thirri Lekën e të dy vrapuan drejt kasolles.

— Shpejt, i tha Luixhit. — Ngrehu shpejt!

E ngritën dhe, duke rendur, e tërhoqën atë prapa shtëpive, u futën në arën e misrit e dolën te varrezat. Italiani nuk kuptonte asgjë. Ai qëndronte i shastisur para varrit. Dafina kapi rrasën e gurtë:

— Gjermanët.

Ai varr po hapej për atë, Luixhin.

— Ndhimomë, — i tha Dafina atij. — ndhimomë.

Dhe italiani u afrua. Po nuk i punonin duart. Ata dhanë e morën një copë herë, derisa më në fund e luajtën pllakën e rëndë. Dafina i tregoi Luixhit varrin e hapur.

— Fufu brenda.

— Dio mio!... — klithi i tmërruar italiani. Por s'pati kohë, se vetëtimthi duart e fuqishme të

1) (ital.) — O perëndi.

gruas e mbërthyen në zverk dhe e palosën poshtë. Ashtu, Leka e Dafina i mblodhën atij këmbët dhe ia rrasën në zbrazëtirën e varrit.

— A je mirë?... Tani ti ke vdekur... — murmuriti si ndër ethe Dafina.

Italiani nuk pipëtinte. Me tërë fuqinë e trupit e të shpirtit ata e ngritën rrasën dhe e plasën përsëri në vend. Rrasa u puthis. Varri u mbyll prapë.

## 5.

— Merr deliet e ik që këndeje, — i tha Dafina të birit. Vetë ajo zbriti në kasolle, prishi strofkën ku flinte Luixhi, shkryfi barin dhe, me govatën në krahë, shkoi te pusi. Zuri të lante lëveret e ndotura. Ashtu e gjetën nazistët.

Kryeplaku i thirri:

— Eja këtu.

Gruaja la teshat, po nuk shkoi tek ata. Ca tingui fjalësh të huaja fluturuan nëpër arin e vrenitur të asaj dite vjeshte. Leka me dhentë po këthehej prapa, ushtarët nuk e kishin lënë të largohej. Dafina pa të birin midis dy nazistëve.

— C'doni? — i tha ajo kryeplakut.

— Oficeri gjerman urdhëron të vish këtu.

Gruaja capiti ngadalë drejt tyre. Por u ndal larg. Oficeri nazist ishte trupvogël, zeshkan, me një kapë të thjeshtë në kokë. Ai as që i hodhi sytë mbi atë grua. Vetëm se shëtiste shikimin mbi shtëpinë e Pon Dukës, kasollen, kishën, va-



rrezat pranë, liqenin që hapej tütje. Siç dukej diç bluante me vete.

Gruaja bëri përpara e iu afrua atyre.

— A ke partizanë brenda? — pyeti kryeplaku.

— Unë nuk kam pasur kurrë partizanë, — tha gruaja.

— E di, — tha kryeplaku.

— Kur e ditke, përse pyet zotrote?

— Pyet gjermani, — tha kryeplaku, jo unë. Po italianin ku e ke?

— Ti e dëbove.

— Unë?

— Ti. A nuk bëre urdhër zotrote që ta përzë?

— Mos e merr veten më qafë, — tha kryeplaku.

Dafina u kthye nga shtëpia dhe pa se ushtarët po kontrollonin. Ata hynin në kësollë, në shtëpi, bridhnin nëpër oborr. Ça po shkonin nga ara e misrit, të tjerë ngjiteshin te varrezat lart. Leka erdhi pranë s'emës.

— Italiani?!

Kësaj radhe pyeti vetë oficeri nazist. Eytyra e tij ishte kaq shpërfillëse, sa e bëri akull gruan.

— E përzura... Kryeplaku më urdhëroi...

Po me atë shpërfillje oficeri gjerman pa kryeplakun. Dicka u foli ushtarëve të vet. Filluan prapë kontrollat nga lëmpara. Trualli përqark shtëpisë ishte fare i vogël, fare i ngushtë. Qëlluan brëshëri në pus. Në breg të kënetës, ngadalë e i qetë, po ulei një pelikan i bardhë. Oficeri nazist thirri një ushtar, i mori atij karabinën dhe shënoi. Qëlloi tri herë. Një ushtar u fut brenda në kënetë dhe e solli pelikanin e vrarë. Dafinës i rabetën sytë te koka e varur e

atij shpendi të bardhë, të gjakosur. Oficeri i hapi shpendit krahët e mëdhenj dhe u sigurua se të tre plumbat kishin goditur në shenjë. Ai kaloi pëllëmbën nëpër pendët e buta të pelikanit. Dhe përsëri diçka foli në gjuhën e vet.

Kuisja e shkurtër e qenit, pasoi një krismë të mbytur. Dafina u tmerrua. Kurrë s'e kishte dëgjuar atë zë të Korbecit. Sytë e gruas u akulluan. Ajo kafshoi buzën e poshtme dhe thithi gjakun e saj. Mendoi të shtrinte dorën e të pushtonte Lekën, por u tremb. Ashtu, ndoshta, mund t'ua shtinte ndër mend. E mbajti veten. Dhe vendosi të shihte e heshtur atë që po ndodhte.

Ushtarët po vrisnin pulat e detit.

— Ku është italianii? — pyeti prapë oficeri. Dhe fare i qetë uli sytë mbi këllëfin, e meshintë të revolverit që mbante në brez. E hapi dhe nxori prej andej «Valterin» e shndritshëm. Pastaj ngadalë ia drejtoi Lekës në ballë.

Nënë e bir ngrinë para atij njeriu të huaj e të zymtë.

— Italianin...

— Nuk e kam... — Dafina rrëmbeu në gjirin e saj kryet e të birit. — Qëllomë mua!

Ajo grua shtatlartë leshverdhë, me ata sy të mëdhenj të kaltër u kthye e tëra përballë oficerit nazist.

— Qëllomëni mua, por jo djalin... Burra!... Iu derdh ajo me përçmim kryeplakut. — Me gratë e fëmijët merreni... Po dëshmitarë toka e qielli... Dhe ata që janë shtrirë atje... — Dafina tregoi me dorë nga varrezat...

— Mbylle gojën, shkrofëtiu Milo Ndreu dhe, sakaq, nxitoi të arrinte oficerin që po dilte në rrugë.

Nëpër oborr ushtarët nazistë po mbledhnin

pulat e vrara. Të tjerë kishin vënë përpara de-  
let dhe po i çonin lart drejt baterive të topave.

— Dëshmitarë toka e qielli dhe këto varre...  
— klithi gruaja. Duke tërhequr të birin pas, Da-  
fina lëshoi një thirrje të egër, hoqi mënjanë sha-  
minë dhe, kryezbuluar, u nis për te varri i Ndre  
Davidit. Ajo nëmte, ulërinte, shkulte flokët e që-  
llonte me pëllëmbë mbi atë rrasë të rëndë e  
të heshtur varri.

Nën të përgjonte një njeri i gjallë.